Banka e Shqipërisë

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2011

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë, sheshi "Avni Rustemi", nr.24, Tiranë
Tel: 355 4 2419301/2/3
Faks: + 355 4 2419409/10/11
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 900 kopje
Shtypur në shtypshkronjën AdelPrint

P Ë R M B A J T J A

HYRJE		7
SQARIME		8
DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2012		9
1.	ZHVILLIMET NË MJEDISIN MAKROEKONOMIK BOTËROR	18
1.1	Zhvillimet e përgjithshme ekonomike në botë	18
1.2	Zhvillimet kryesore në tregjet financiare	22
2.	ZHVILLIMET NË MJEDISIN MAKROEKONOMIK NË VEND	29
2.1	Sektori i ekonomisë reale	29
2.2	Tregu i banesave	31
2.3	Gjendja financiare dhe huamarrja e individëve	34
2.4	Gjendja financiare dhe huamarrja e bizneseve	40
3.	TREGJET FINANCIARE	47
3.1	Tregu ndërbankar	47
3.2	Tregu primar i titujve	47
3.3	Tregu sekondar i titujve	49
3.4	Tregu i këmbimeve valutore	49
3.5	Ndryshimi midis normave të interesit të kredive dhe depozitave të reja	49
4.	ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE GJATË GJASHTËMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2011	51
4.1	Ecuria dhe eficienca e sistemeve të pagesave	51
4.2	Zhvillimet në instrumentet e pagesave	52
5.	ZHVILLIME TË SISTEMIT FINANCIAR	53
6.	SEKTORI BANKAR	57
6.1	Ecuria e aktiv-pasiveve dhe përbërja e tyre	57
6.2	Pozicioni i sektorit bankar ndaj jorezidentëve	59
6.3	Teprica e kredisë	60
6.4	Depozitat dhe ecuria e tyre	64
6.5	Kapitali	66
6.6	Rezultati financiar dhe eficienca e burimeve	66
6.7	Përmirësime ligjore dhe rregullative	68
VII.	MONITORIMI I RREZIQEVE NDAJ TË CILËVE EKSPOZOHET SEKTORI BANKAR	70
7.1	Rreziqet e tregut	70
7.2	Rreziku i kreditit	72
7.3	Rreziku i likuiditetit	75
7.4	Kapitalizimi i veprimtarisë	76
7.5	Prova e rezistencës	79
ANEKS		82
Shtojcë 1:	Indeksi i Fortësisë Financiare	82
Shtojcë 2:	Treguesit e shëndetit financiar për sektorin bankar	85

H A P Ë S I R A I N F O R M U E S E

Hapësirë Informuese 1.	*Marrëveshja për zgjidhjen e borxhit sovran të Greqisë.*	*21*
Hapësirë informuese 2.	*Masat kryesore të qeverive në Itali dhe Spanjë, për konsolidimin fiskal dhe rigjallërimin e rritjes ekonomike.*	*23*
Hapësirë informuese 3.	*Rezultatet e stress-test-it për grupet kryesore të bankave evropiane, sipas Autoritetit Bankar Evropian.*	*26*
Hapësirë informuese 4.	*Lidhja midis çmimit të banesave dhe kredisë për pasuri të paluajtshme.*	*33*
Hapësirë informuese 5.	*Sektori financiar jobankar.*	*54*
Hapësirë Informuese 6.	*Kredia e re.*	*62*
Hapësirë informuese 7.	*Depozitat e reja.*	*65*
Hapësirë informuese 8.	*Indeksi i modifikuar i mospërputhjeve valutore.*	*71*
Hapësirë informuese 9.	*Indeksi i Rrezikut Sistemik Financiar për Shqipërinë.*	*78*

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

1. Zhvillimet në mjedisin makroekonomik botëror

Tabelë 1.1. Disa tregues kryesorë makroekonomikë për SHBA-në dhe Eurozonën. *19*
Tabelë 1.2. Disa tregues kryesorë makroekonomikë për Evropën Juglindore. *20*
Tabelë 1.3. Nevojat për rritjen e kapitalit të grupeve bankare sipas shteteve. *26*
Tabelë 1.4. Nevojat për rritjen e kapitalit të grupeve bankare që operojnë në Shqipëri. *26*
Tabelë 1.5. Të dhëna financiare mbi grupet e huaja bankare të pranishme në Shqipëri. *28*

4. Zhvillimet në sistemet e pagesave gjatë gjysmës së dytë të vitit 2011

Tabelë 4.1. Numri dhe vlera totale e pagesave të procesuara në sistemet AIPS/AECH. *51*

5. Zhvillime të sistemit financiar

Tabelë 5.1. Ecuria e disa treguesve të aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre. *55*

6. Sektori bankar

Tabelë 6.1. Pesha e zërave të aktiveve (dhjetor '05 – dhjetor '11). *57*
Tabelë 6.2. Pesha e zërave të detyrimeve/pasiveve (dhjetor '06 – dhjetor '11). *58*
Tabelë 6.3. Norma e rritjes së depozitave. *64*

7. Monitorimi i rreziqeve ndaj të cilëve ekspozohet sektori bankar

Tabelë 7.1. Supozimet për ndërtimin e provës së rezistencës. *80*
Tabelë 7.2. Rezultatet e stress-test-it në terma të kapitalizimit të sektorit bankar. *81*
Tabelë 7.3. Rezultatet e stress-test-it në terma të kapitalizimit të sektorit bankar. *81*

Aneks

Tabelë 8.1. Treguesit e shëndetit financiar për sektorin bankar. *85*
Tabelë 8.2. Treguesit e shëndetit financiar sipas grupeve bankare. *86*
Tabelë 8.3. Treguesit e shëndetit financiar të bankave sipas origjinës. *87*

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

I. Zhvillimet në mjedisin makroekonomik botëror

Grafik 1.1. Struktura e borxhit kombëtar grek para dhe pas ristrukturimit. 21
Grafik 1.2. Normat e interesit dhe ecuria e monedhës euro në tregjet ndërkombëtare. 23

II. Zhvillimet në mjedisin makroekonomik në vend

Grafik 2.1. Kohëzgjatja mesatare e ditëve deri në maturim, për borxhin e emetuar në letra me vlerë. 29
Grafik 2.2. Ecuria e llogarisë korrente dhe asaj kapitale dhe financiare sipas përbërësve përkatës. 30
Grafik 2.3. Ecuria e indekseve të çmimit të banesave dhe qirasë si dhe kredisë për blerje të pasurive të paluajtshme. 32
Grafik 2.4. Ecuria e kredisë për pasuri të paluajtshme dhe e çmimit të banesave sipas dy skenarëve. 34
Grafik 2.5. Burimi dhe qëllimi i marrjes së borxhit. 35
Grafik 2.6. Pozicioni financiar i individëve ndaj sistemit financiar. 36
Grafik 2.7. Ecuria e kredisë për individët. 37
Grafik 2.8. Ekspozimi i individëve ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit. 38
Grafik 2.9. Cilësia e portofolit të kredisë në valutë për individët. 39
Grafik 2.10. Vlera mesatare e kredisë në valutë për individët. 39
Grafik 2.11. Ekspozimi i individëve ndaj rrezikut të tërthortë të normës së interesit. 39
Grafik 2.12. Shpërndarja e bizneseve sipas qëllimit të përdorimit të huasë. 41
Grafik 2.13. Pozicioni financiar i bizneseve. 42
Grafik 2.14. Ecuria e kredisë dhe cilësisë së portofolit të kredisë për bizneset. 43
Grafik 2.15. Ekspozimi i bizneseve ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. 44
Grafik 2.16. Cilësia e portofolit të kredisë për bizneset. 44
Grafik 2.17. Vlera mesatare e kredisë në valutë për bizneset. 45
Grafik 2.18. Ekspozimi i bizneseve ndaj rrezikut të tërthortë të normës së interesit. 46

III. Tregjet financiare

Grafik 3.1. Vëllimi dhe normat e interesit në tregun ndërbankar. 47
Grafik 3.2. Ecuria e normës mesatare të interesit të borxhit të emetuar në letra me vlerë. 47
Grafik 3.3. Vëllimi dhe normat e kthimit të bonove në tregun primar. 48
Grafik 3.4. Ecuria e ankandeve të obligacioneve. 48
Grafik 3.5. Kurba e normave të kthimit. 48
Grafik 3.6. Vëllimi i tregtimit të bonove në tregun sekondar. 49
Grafik 3.7. Ecuria e kursit të këmbimit për tre monedhat kryesore. 49
Grafik 3.8. Treguesit e kursit nominal efektiv (NEER) dhe të kursit real efektiv (REER). 49
Grafik 3.9. Ecuria e ndryshimit të normave të kredive dhe depozitave me afat, në përqindje. 50

V. Zhvillime të sistemit

Grafik 5.1. Ndryshimi vjetor i aktiveve të segmenteve individuale të sistemit financiar, në përqindje. 53
Grafik 5.2. Pesha e subjekteve të sistemit financiar në totalin e aktivit. 54
Grafik 5.3. Ecuria e aktiveve dhe e portofolit të kredisë për institucionet financiare jobanka. 54
Grafik 5.4. Ecuria e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe raportit të huave me probleme, në përqindje. 55
Grafik 5.5. Pesha e zërave të aktiveve të shoqërive të sigurimit. 56

VI. Sektori Bankar

Grafik 6.1. Ecuria e zërave të aktivit. 58
Grafik 6.2. Pesha e grupeve të bankave në totalin e aktiveve. 59
Grafik 6.3. Pozicioni i sektorit bankar ndaj jorezidentëve. 59
Grafik 6.4. Detyrimet ndaj jorezidentëve mbi totalin e detyrimeve, sipas grupeve. 59
Grafik 6.5. Totali i pasiveve jorezidente ndaj totalit të pasiveve në valutë. 60
Grafik 6.6. Shpërndarja e normës së rritjes së kredisë. 60
Grafik 6.7. Ecuria e rritjes vjetore të kredisë. 61
Grafik 6.8. Shpërndarja e tepricës së kredisë për biznesin dhe individët sipas qëllimit të përdorimit. 61
Grafik 6.9. Ecuria e rritjes vjetore të kredisë për sektorin e bujqësisë dhe të ndërtimit. 62
Grafik 6.10 Kredia e re dhe përdorimi i kredisë. 62
Grafik 6.11. Shpërndarja e peshave të kredisë së re për sektorin e biznesit dhe për individët sipas qëllimit të përdorimit, në përqindje. 63
Grafik 6.12. Shpërndarja e kredisë së re sipas sektorëve të ekonomisë. 63
Grafik 6.13. Ecuria e normës së interesave për kreditë e reja në lekë dhe valutë. 64
Grafik 6.14. Struktura e depozitave të sektorit bankar sipas maturimit. 65
Grafik 6.15 Ecuria e depozitave të reja dhe e normave të interesit. 66
Grafik 6.16. Komponentët kryesorë të të ardhurave operative. 67
Grafik 6.17. Ecuria e kthimit nga aktivet (RoA) dhe kthimit nga kapitali (RoE) për sektorin bankar. 67
Grafik 6.18. Ecuria e kthimit nga aktivet (RoA) dhe kthimit nga kapitali (RoE) për grupet sipas madhësisë së kapitalit. 68

VII. Monitorimi i rreziqeve ndaj të cilëve ekspozohet sektori bankar

Grafik 7.1. Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar, në përqindje (dhjetor '05 – dhjetor '11). 70
Grafik 7.2. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për sektorin bankar dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit. 70
Grafik 7.3 Indeksi i mospërputhjes valutore. 71
Grafik 7.4. Diferenca midis aktiveve-pasiveve sipas periudhave të riçmimit (në mln lekë). 71
Grafik 7.5. Ecuria e aktiveve me rrezik. 72
Grafik 7.6. Ecuria e aktiveve me rrezik sipas grupeve të bankave. 73
Grafik 7.7. Ecuria e huave me probleme. 73
Grafik 7.8. Ecuria e provigjoneve (majtas) dhe raportit të mbulimit të huave me probleme (djathtas). 73
Grafik 7.9. Cilësia e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, në përqindje. 74
Grafik 7.10. Kategoritë e kredisë të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme në përqindje. 75
Grafik 7.11. Maturimi mesatar i mbetur i aktiveve dhe detyrimeve, në muaj. 75
Grafik 7.12. Maturimi mesatar i mbetur i depozitave dhe kredive, në muaj. 76
Grafik 7.13. Ecuria e aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve, në përqindje. 76
Grafik 7.14. Ecuria e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar dhe grupet e bankave, në përqindje. 77
Grafik 7.15. Indeksi i rrezikut sistemik financiar. 78
Grafik 7.16 Indeksi i rrezikut sistemik financiar pa përfshirjen e nënindeksit të tregut të banesave. 79
Grafik 7.17. Shpërndarja e dendurive të vlerave të raportit të kredive me probleme për tremujorin e fundit të vitit 2012 dhe vitit 2013 të simuluara me metodën Monte Carlo sipas skenarit bazë dhe skenarëve të rënduar 80

Aneks

Grafik 8.1. Ecuria e Indeksit të Fortësisë Financiare (IFF). 84
Grafik 8.2. Ecuria e nënindekseve të fortësisë financiare. 84
Grafik 8.3. Harta e fortësisë financiare të sektorit bankar. 84

HYRJE

Ky është numri i shtatë i Raportit të Stabilitetit Financiar, një dokument i Bankës së Shqipërisë që publikohet dy herë në vit. Qëllimi i raportit është identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve me të cilat ndeshet sistemi financiar dhe infrastruktura e tij, për t'i dhënë autoriteteve publike mundësinë që të identifikojnë masat përkatëse për korrigjimet e nevojshme. Në hyrje të dokumentit është vendosur Deklarata e Stabilitetit Financiar, publikimi i së cilës çdo gjashtë muaj është një kërkesë ligjore.

Për hartimin e raportit, janë shfrytëzuar të dhëna që disponohen në Bankën e Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritete të tjera që mbikëqyrin veprimtarinë e tregut financiar, si edhe janë shfrytëzuar informacione dhe analiza të institucioneve të vendit dhe të atyre financiare ndërkombëtare, publike dhe private. Të dhënat dhe analizat e paraqitura përfshijnë kryesisht zhvillimet gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në raport, pritjet për zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe financiare shtrihen përgjithësisht deri në fund të vitit 2012.

Qëndrueshmëria e sistemit financiar është vlerësuar në bazë të ecurisë dhe rreziqeve që krijohen nga ndërveprimi i tij me mjedisin e përgjithshëm ekonomik, të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe nga vetë veprimtaria e tij. Për të vlerësuar rreziqet që vijnë për shkak të ndërveprimit me mjedisin rrethues, janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonomitë e zhvilluara e ato të rajonit, si dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Ndër treguesit e brendshëm, janë vlerësuar zhvillimet e përgjithshme dhe pritshmëritë për rritjen ekonomike, bilancin tregtar, nivelin e përgjithshëm të çmimeve, kursin e këmbimit dhe treguesit fiskalë. Analiza është përqendruar në vlerësimin e gjendjes, ecurisë dhe rreziqeve të sektorit bankar, si segmenti i cili mbizotëron dukshëm në sistemin financiar në vend. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punëzënies dhe të ecurisë së të ardhurave, është vlerësuar gjendja financiare e bizneseve dhe e individëve, si dhe ndikimi mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar.

SQARIME

Në fund të muajit dhjetor 2011, bankat e sektorit bankar shqiptar ndahen sipas madhësisë së aktivitetit të tyre në:

a) banka të Grupit 1 (secila nga 0-2% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Veneto Banka, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka e Parë e Investimeve, Banka e Kreditit të Shqipërisë;

b) banka të Grupit 2 (secila nga 2-7% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka Procredit, Banka Emporiki, Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë, Banka Societe Generale - Albania, Banka Alfa – Shqipëri, Banka Union;

c) banka të Grupit 3 (secila mbi 7% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka Raiffeisen, Banka Credins, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Intesa Sanpaolo –Shqipëri, Banka Tirana.

Në fund të muajit dhjetor 2011, sipas origjinës së kapitalit[1], bankat e sektorit bankar shqiptar ishin:

a) me kapital austriak: Banka Raiffeisen;

b) me kapital italian: Banka Intesa Sanpaolo – Shqipëri, Veneto Banka;

c) me kapital grek: Banka Alfa-Shqipëri, Banka Tirana, Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë;

d) me kapital francez: Banka Societe Generale, Banka Emporiki;

e) me kapital shqiptar: Banka Credins, Banka Union.

Në fund të muajit dhjetor 2011, sipas formës së themelimit, degët[2] e bankave të sektorit bankar shqiptar ishin: Banka Alfa-Shqipëri, Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë. Gjithashtu, shtrirje të rrjetit të degëve jashtë vendit evidenton Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Intesa Sanpaolo – Shqipëri, përkatësisht në Prizren, Kosovë dhe Athinë, Greqi.

---

[1] *Sipas origjinës së kapitalit, kur kapitali i huaj përbën më shumë se 50% të madhësisë së kapitalit të paguar të bankës.*

[2] *Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012, do të përfundojë procesi i shndërrimit të degëve në filiale të bankave të huaja.*

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2011

Në mbështetje të kërkesës së nenit 69 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9962, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të informuar Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave, si edhe për të tërhequr vëmendjen e institucioneve financiare dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij, Banka e Shqipërisë publikon këtë deklaratë periodike. Kjo deklaratë është pjesë përbërëse e Raportit të Stabilitetit Financiar për të njëjtën periudhë.

Banka e Shqipërisë vlerëson se gjendja dhe ecuria e sistemit financiar dhe e sektorit bankar mbetet e stabilizuar. Treguesit e kapitalizimit dhe të likuiditetit të veprimtarisë së sektorit bankar paraqiten në nivele të mira, por aftësia e tij për të gjeneruar të ardhura të mjaftueshme vijon të mbetet e përqendruar në banka të veçanta. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të drejtpërdrejta të tregut paraqitet në nivele të ulëta, ndërkohë që rreziku i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i kreditit përfaqëson sfidën kryesore për veprimtarinë e sektorit bankar. Zhvillimet në mjedisin ekonomik rrethues të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe gjendja financiare e familjeve dhe bizneseve, vlerësohen të ngjashme me ecurinë e tyre afatmesme. Më konkretisht, ndërveprimi i sistemit financiar me mjedisin ekonomik dhe ekspozimi ndaj rreziqeve të ndryshme, vlerësohen në vijim.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2011, u shënua ulje e ritmeve të rritjes së ekonomisë botërore, e ndikuar veçanërisht nga ecuria e ekonomisë së vendeve të zhvilluara. Pasiguritë u shtuan për shkak të ashpërsimit të krizës së borxhit sovran në Eurozonë. Mesatarisht, rritja e aktivitetit ekonomik botëror gjatë vitit 2011 u ngadalësua në 3.8%, krahasuar me 5.2% në vitin 2010. Vendet e zhvilluara u rritën me 1.6%, në vijim të paqëndrueshmërisë së Eurozonës, ngadalësimit të kreditimit të ekonomisë reale nga bankat dhe efektit frenues mbi rritjen ekonomike të procesit të konsolidimit fiskal. Rritja ekonomike e vendeve në zhvillim u vlerësua 6.2%, sërish më e ulët se në vitin 2010. Për vitin 2012, parashikohet një ngadalësim i mëtejshëm i rritjes ekonomike botërore, ku vendet e zhvilluara pritet të rriten në masën 1.2%, ndërsa vendet në zhvillim pritet të rriten në masën 5.4%.

Në Eurozonë, aktiviteti ekonomik u ngadalësua si rezultat i rënies së shpenzimeve të konsumatorëve dhe dobësimit të kërkesës së brendshme në vendet e mëdha të bllokut. Norma e papunësisë u ngjit në 10.4% në fund të vitit ndërsa presionet inflacioniste u zbehën duke ardhur në rënie. Konsolidimi fiskal vazhdon të mbetet sfida kryesore e vendeve të Eurozonës, ndaj shumë

prej tyre si Italia, Spanja, Franca etj., kanë deklaruar masat për të pakësuar më tej borxhet e larta të akumuluara dhe për të nxitur rritjen ekonomike.

Aktiviteti ekonomik në rajonin e Evropës Qendrore e Lindore është gjallëruar gjatë gjysmës së dytë të vitit, por me ritme të ndryshme midis vendeve. Në vende si Bullgaria, Republika Çeke dhe Sllovakia, ritmi i rritjes ekonomike u ngadalësua në tremujorin e tretë krahasuar me periudhat e mëparshme, kryesisht për shkak të rënies së kërkesës së jashtme dhe dobësimit të investimeve. Ndërsa vende si Polonia dhe Rumania vazhduan të kenë rritje të mirë ekonomike të mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme. Në rajonin e Ballkanit, Turqia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë kanë regjistruar ritme më të larta të rritjes ekonomike.

Nga ana tjetër, Shtetet e Bashkuara të Amerikës provuan një përshpejtim të rritjes ekonomike në gjysmën e dytë të vitit 2011 duke u mbështetur nga përmirësimi në investimet private, shpenzimet konsumatore dhe eksportet neto. Sidoqoftë, në terma vjetorë, rritja është ngadalësuar në 1.7% në vitin 2011, nga 3% në vitin 2010. Ecuria e tregut të pasurive të paluajtshme ka vazhduar të jetë e dobët, ndërsa norma e papunësisë shënoi rënie në tre muajt e fundit të vitit, duke u stabilizuar në vlerën 8.5% në fund të vitit.

Gjatë periudhës, ecuria e tregjeve financiare ndërkombëtare reflektoi vështirësitë e ekonomisë botërore dhe të agjentëve ekonomikë. Në Eurozonë, tregjet e parasë u karakterizuan nga luhatshmëri e ndjeshme dhe norma interesi në rritje. Për të zbutur tensionet, Banka Qendrore Evropiane përdori instrumente të ndryshme financimi për të rritur likuiditetin në treg, si dhe realizoi dy ulje të normës bazë të interesit me nga 25 pikë bazë, respektivisht në nëntor dhe në dhjetor, duke e zbritur normën bazë të interesit në nivelin 1%. Pavarësisht këtyre masave, në tremujorin e fundit të vitit, vëllimet e tregtimit në tregun ndërbankar mbetën përgjithësisht të ulëta dhe primet e rrezikut u rritën më shumë se në tregjet e tjera, duke reflektuar rritjen e rrezikut të kundërpartisë midis institucioneve financiare dhe midis bankave. Në tregjet e titujve shtetërorë të borxhit, presionet për rritjen e normave të kthimit (*yield*-eve) ishin të ndjeshme veçanërisht për vendet me nivele të larta të borxhit, si Italia, Spanja dhe Franca. Në tregjet e kapitalit, vijoi hezitimi i investitorëve për blerje të aksioneve dhe obligacioneve të firmave. Si rezultat, kostoja e financimit përmes tyre u rrit dhe ecuria e çmimeve në tregjet kryesore të aksioneve ishte e paqëndrueshme. Në tregjet e këmbimit të monedhave, investitorët u drejtuan drejt atyre të konsideruara si më të sigurta, si jeni japonez dhe franga zvicerane. Në këto kushte, monedha euro ka qenë përgjithësisht e paqëndrueshme ndaj valutave të tjera kryesore gjatë gjithë gjysmës së dytë të vitit. Në tregjet e lëndëve të para, çmimet kanë qenë përgjithësisht në rënie si rezultat i dobësimit të kërkesës globale. Gjithsesi, çmimet e naftës kanë pësuar rritje gjatë fundit të vitit, kryesisht për shkak të zhvillimeve në kahun e ofertës dhe të rritjes së rrezikut gjeopolitik në vendet prodhuese.

Treguesit e përfitueshmërisë për grupet e mëdha e komplekse bankare globale, ishin relativisht të qëndrueshëm. Normat e ulëta të interesit dhe zgjerimi i dobët i kredisë, u reflektuan në një rënie të ndjeshme të të ardhurave

nga interesat në disa prej bankave. Përsa i përket grupeve bankare në Eurozonë, performanca financiare është përkeqësuar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2011, kryesisht për shkak të rritjes së rezervave për mbrojtjen nga rreziku i kreditit (provigjoneve) dhe rënies së theksuar të të ardhurave nga aktiviteti i tregtimit. Autoriteti Bankar Evropian kreu në tetor 2011, ushtrimin e provës së rezistencës, i cili evidentoi nevojën për rritjen e kapitalit në këto banka në masën 114.7 miliardë euro. Për periudhën në vazhdim, pasiguria rreth zhvillimeve të ardhshme në tregjet e titujve shtetërorë në Eurozonë, do të vazhdojë të mbetet e lartë, dhe rreziku i përhapjes së krizës në vende të tjera të Eurozonës me nivele të larta të borxhit publik, mbetet i pranishëm. Nga ana tjetër, sektori bankar evropian përballet me nevojën për rritjen e kapitalit të cilësisë së lartë dhe rrezikun e rifinancimit të detyrimeve. Gjithashtu, burim të vazhdueshëm rreziku përbën edhe përkeqësimi i cilësisë së kredisë për sektorin privat, ndonëse nivelet e përkeqësimit janë të ndryshme në vende dhe institucione të ndryshme. Ecuria financiare e këtyre grupeve bankare, do të ndikohet pozitivisht nëse autoritetet evropiane zbatojnë disa masa të parashikuara për uljen e rrezikut sistemik në disa vende të Eurozonës.

Ekonomia shqiptare është rritur mesatarisht me 3.1% gjatë vitit 2011. Pas një ngadalësimi të normës së rritjes në tremujorin e dytë, ekonomia shënoi përmirësim të aktivitetit të saj gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit. Sektorët e tregtisë dhe transportit vijojnë të mbështesin në mënyrë të qëndrueshme zgjerimin e aktivitetit ekonomik. Ecuria e sektorit të industrisë ka shënuar luhatje gjatë vitit 2011 ndërkohë që sektori i ndërtimit ka shfaqur një përmirësim të lehtë të aktivitetit të tij gjatë gjashtëmujorit të dytë 2011. Treguesit e tërthortë sugjerojnë se kontributi i konsumit dhe investimeve private në rritjen ekonomike gjatë vitit 2011 ka qenë i kufizuar. Edhe zhvillimet në përbërësin e shpenzimeve qeveritare dhe të tregtisë me jashtë reflektojnë ngadalësim të kontributit të tyre. Në fund të vitit 2011, norma e papunësisë shënoi vlerën 13.29% kundrejt 13.49% në fund të vitit 2010. Ky përmirësim ka qenë i pamjaftueshëm për të mbështetur më tej konsumin dhe për të kthyer prirjen për kursim të familjeve, në kushtet e një pasigurie për zhvillimet ekonomike të ardhshme. Inflacioni mesatar vjetor në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011 rezultoi 2.9%, rreth 1.1 pikë përqindje më pak se në gjashtëmujorin e parë të vitit. Në kushtet e presioneve të kontrolluara inflacioniste, Banka e Shqipërisë uli normën bazë të interesit në muajt shtator dhe nëntor, respektivisht me nga 0.25 pikë përqindje, në nivelin 4.75%, duke ofruar kushte monetare më të favorshme për nxitjen e aktivitetit ekonomik në vend. Deficiti buxhetor në fund të vitit 2011, vlerësohet në masën 3.5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Pas rishikimit të buxhetit nga Qeveria në mes të vitit, gjashtëmujori i dytë u karakterizua nga ulje e të ardhurave dhe të shpenzimeve në një vlerë të konsiderueshme. Financimi i deficitit është kryer në pjesën më të madhe me burime të brendshme. Niveli i borxhit publik vlerësohet në masën 58.5% të PBB-së. Pas një rritjeje në gjashtëmujorin e parë të vitit, kohëzgjatja mesatare e borxhit ka thelluar prirjen rënëse duke shënuar në gjashtëmujorin e dytë nivelin më të ulët pas vitit 2008. Në fund të vitit 2011, deficiti i llogarisë korrente rezultoi 12% e PBB-së, duke shënuar një rritje të lehtë në krahasim me fundin e vitit 2010. Deficiti tregtar rezultoi 22% e PBB-së, duke u ngushtuar me 1.5 pikë përqindje në krahasim me fundin e vitit 2010. Në fund të vitit

2011, eksportet mbulonin 29.6% të importeve, krahasuar me një mesatare vjetore prej 36%. Llogaria kapitale dhe financiare është zgjeruar me 5.6% në terma vjetorë, duke financuar 80% të deficitit të llogarisë korrente. Në tregun e pasurive të paluajtshme, indeksi i çmimeve të banesave për Tiranën shënoi rritje me një ritëm më të ngadalësuar ndërsa indeksi i qirasë vijoi rënien. Nga ana tjetër, kreditimi për pasuri të paluajtshme është zgjeruar me 7.2% në terma vjetorë.

Në gjysmën e dytë të vitit 2011, gjendja financiare e individëve/familjeve dhe bizneseve, shfaqi të njëjtat prirje si në periudhën e mëparshme. Më konkretisht, individët kanë zgjeruar më tej pozicionin e tyre kreditor ndaj sistemit financiar, në vijim të rritjes së konsiderueshme të depozitave në krahasim me kreditë e përfituara. Pozicioni kreditor në valutë është zgjeruar më shpejt se ai në monedhën vendase. Ndërsa pozicioni i bizneseve vijon të mbetet thellësisht debitor dhe në pjesën dërrmuese të tij është në valutë. Kreditimi i sektorit të biznesit gjatë vitit 2011 ishte ndjeshëm më i lartë se ai i individëve. Ndërkohë, cilësia e kredisë për individët dhe bizneset ka rënë, por kjo rënie ka qenë më e lartë për bizneset.

Tregjet financiare në vend, kanë qenë të stabilizuara. Në gjashtëmujorin e dytë të vitit, tregu ndërbankar ka njohur rritje të vlerave monetare të shkëmbyera në krahasim me periudhën e mëparshme. Sidoqoftë, në nivel vjetor ndryshimi ka qenë i papërfillshëm. Normat e interesit në treg kanë reflektuar nivelin e normës bazë të interesit të përcaktuar nga politika monetare, strukturën përkatëse të maturimit të transaksionit, si edhe luhatjet në kërkesën për likuiditet afatshkurtër të bankave. Gjatë periudhës, vëllimi i tregut primar të letrave me vlerë të borxhit të Qeverisë është zvogëluar kundrejt gjashtëmujorit të parë, duke reflektuar uljen e kërkesës për huamarrje nga ana e Qeverisë në gjysmën e dytë të vitit. Përbërja e borxhit të emetuar në tregun primar është dominuar nga letrat me vlerë të borxhit deri në 12 muaj, megjithëse rënia e emetimeve ka përfshirë si bonot e thesarit ashtu edhe notat/obligacionet. Norma mesatare e interesit për letrat me vlerë të borxhit të emetuara në gjashtëmujorin e dytë të vitit ka mbetur pranë niveleve të një viti më parë. Në krahasim me një vit më parë, norma mesatare e interesit ka shënuar rënie për bonot e thesarit dhe një rritje për notat/obligacionet. Tregu i tregtimit të letrave me vlerë të borxhit pas emetimit të tyre ka shënuar rritje por baza e krahasimit mbetet ende mjaft e ulët. Peshën më të madhe në stokun e letrave me vlerë të tregtuara në tregun sekondar e zënë bonot e thesarit me afat maturimi 12 muaj. Në tregun e këmbimeve valutore, leku është shfaqur i qëndrueshëm duke u nënçmuar lehtë ndaj euros dhe duke u mbiçmuar lehtë ndaj dollarit amerikan. Gjithashtu, luhatshmëria në tregtim ka qenë e ulët. Kursi i këmbimit të lekut ndaj valutave kryesore, ka reflektuar ndryshimet në kërkesë/ofertë si edhe zhvillimet në tregun ndërkombëtar të këmbimit të valutave. Në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit, diferenca mes normave të interesit për kreditë dhe depozitat për lekun, euron dhe dollarin amerikan, është ngushtuar duke reflektuar më tepër rënien e normës së interesit të kredisë në secilën monedhë.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, sistemi financiar zgjeroi më tej veprimtarinë e tij, duke vepruar në përputhje me treguesit kryesorë që përcakton kuadri mbikëqyrës. Aktivet e sektorit bankar shënuan një rritje vjetore prej 13.7%, duke u ngjitur në nivelin 1,120.17 miliardë lekë. Kreditë janë rritur me 15.5% në terma vjetorë, duke zënë rreth 50% të aktiveve të totalit të bilancit të sektorit bankar. Depozitat janë rritur me 13.2%, duke zënë 81.4% të totalit të bilancit të sektorit bankar. Kreditë në valutë zënë rreth 68% të portofolit të kredive, ndërsa për depozitat ndarja është pothuaj e barabartë. Kohëzgjatja mesatare e kredisë ka rënë lehtë, ndërsa kohëzgjatja mesatare e depozitave është rritur. Në sajë të rritjes së kapitalit nga disa banka, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit u përmirësua në fund të periudhës duke u ngjitur në nivelin 15.6%. Vijimi i rritjes së depozitave me ritme të mira dhe zgjerimi i vlerës së aktiveve likuide në zbatim të kërkesave të kuadrit mbikëqyrës, tregojnë një situatë të kënaqshme të likuiditetit. Sidoqoftë, madhësia e rezultatit financiar pozitiv ka pësuar rënie të ndjeshme në fund të vitit, duke bërë që treguesit e kthimit mbi aktivet dhe mbi kapitalin të bien në krahasim me fundin e gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 dhe fundin e vitit 2010. Nivelet e ulëta të kthimit nga investimet në tregjet ndërkombëtare, ngadalësimi i ritmeve të kreditimit, si edhe rritja e kostove operative, kanë qenë faktorë që kanë ndikuar në rënien e rezultatit financiar. Sidoqoftë, kontributin kryesor në këtë drejtim e ka dhënë rritja e fondeve rezervë për mbrojtjen nga rreziku i kreditit. Në fakt, cilësia e kredisë ka shënuar rënie, pothuaj në të gjitha kategoritë e saj. Raporti i kredisë me probleme ndaj totalit të kredisë shënoi vlerën 18.8% në fund të vitit. Gjatë vitit 2011, rritja e raportit të kredive me probleme ka qenë më e ngadaltë krahasuar me vitin 2010, por kjo i atribuohet kryesisht rritjes më të shpejtë të nivelit të përgjithshëm të kredisë.

Ecuria e sektorit bankar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, vlerësohet edhe nëpërmjet Indeksit të Fortësisë Financiare. Vlera e indeksit është rritur me 3.2 njësi krahasuar me një gjashtëmujor më parë, por ka rënë lehtë në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritja e vlerës së indeksit reflekton rritje të nënindeksit të likuiditetit, të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe atij të ekspozimit ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Në ecurinë e indeksit kanë dhënë kontribut negativ nënindeksi i cilësisë së aktiveve, i përfitueshmërisë dhe ai i ekspozimit ndaj luhatjeve të normës së interesit.

Në muajin nëntor 2011, u finalizuan me miratimin në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, disa ndryshime dhe plotësime në ligjin nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" të përgatitura nga Banka e Shqipërisë. Krahas disa plotësimeve në kuadër të një përcaktimi më të qartë të veprimtarisë me paranë elektronike dhe të institucioneve financiare përkatëse, në kuadër të një përafrimi më të mirë me direktivën përkatëse evropiane, ndryshimet synonin përcaktimin e rrezikut sistemik dhe fuqizimin e instrumenteve të Bankës së Shqipërisë për trajtimin e tij.

Rreziqet për sistemin financiar burojnë prej ndërveprimit të tij me mjedisin ekonomik rrethues dhe prej vetë veprimtarisë së tij.

Në lidhje me ndikimin prej zhvillimeve makroekonomike, vlerësohet se stimuli fiskal dhe kontributi i kërkesës së huaj në rritjen ekonomike do të vijojnë të zvogëlohen. Politika fiskale është e nevojshme të vijojë procesin e konsolidimit, duke synuar mbajtjen e deficitit buxhetor në nivele të ulëta dhe uljen graduale të nivelit të borxhit publik. Gjithashtu, kërkesat për huamarrje duhet të konsiderojnë më mirë objektivin për rritjen e kohëzgjatjes mesatare të borxhit për të siguruar kushte më të përshtatshme të rifinancimit, duke përfshirë edhe një rishpërndarje më të mirë mes investitorëve institucionalë dhe individëve. Një vëmendje e posaçme i duhet kushtuar edhe ecurisë në kohë të detyrimeve në valutë, të cilat kërkojnë paraprakisht krijimin dhe administrimin e kujdesshëm të burimeve në valutë. Këta faktorë mund të theksojnë pritshmëritë e operatorëve ekonomikë për ngadalësimin e rritjes ekonomike dhe mund të shtojnë mundësitë për pakësim të investimeve private dhe për konsum. Diferencat në ritmin e rritjes ekonomike dhe në normat reale të interesit mes vendit tonë dhe vendeve partnere në tregtinë me jashtë, do të kenë ndikim mbi ecurinë e deficitit tregtar dhe të llogarisë korrente, por kahu dhe masa e këtij ndikimi varen edhe nga faktorë të tjerë dhe mbetet e paqartë. Sidoqoftë, niveli i deficitit tregtar është i lartë dhe përbën një rrezik potencial për zhvillimet makroekonomike në vend. Ulja e tij mund të jetë e qëndrueshme vetëm nëse mbështetet me politika konsistente dhe afatgjata që stimulojnë prodhimin vendas dhe përmirësojnë konkurrueshmërinë e tij. Në afat të parashikueshëm, presionet inflacioniste mund të vijojnë të mbeten të dobëta, duke i dhënë më shumë mundësi autoritetit monetar të ruajë kushtet monetare akomoduese. Kushtet monetare akomoduese janë reflektuar në ecurinë e normës mesatare të interesit për depozitat në banka, por shkalla e përfitimit të operatorëve ekonomikë në treg nga ofrimi i kushteve më të favorshme monetare do të varej edhe nga gjendja e tyre financiare, si edhe nga sasia e kreditimit të sektorit bankar e niveli përkatës i normës së interesit.

Individët dhe bizneset janë të ekspozuar ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit, por madhësia e ekspozimit është e ndryshme për shkak të gjendjes së tyre financiare. Për individët, ekspozimi ndaj lëvizjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit, buron kryesisht prej kredisë në valutë të marrë për blerje banese. Ndërsa ekspozimi ndaj lëvizjeve të pafavorshme në normën e interesit, vlerësohet se është ulur gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, për shkak të rënies së peshës së kredisë me normë të ndryshueshme interesi në totalin e kredisë për individët. Sidoqoftë, pozicioni kreditor i individëve ndaj sistemit financiar zbut efektin e këtyre rreziqeve. Për bizneset, ekspozimi ndaj rrezikut të lëvizjeve të pafavorshme në kursin e këmbimit është rritur në gjysmën e dytë të vitit 2011, si rezultat i rritjes së peshës së kredisë në valutë të pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, në kredinë totale në valutë. Megjithatë, rënia e cilësisë për këtë kategori kredish ka qenë më e ulët se rënia në vlerën e përgjithshme të kredisë për bizneset. Bizneset paraqiten me një ekspozim më të lartë edhe ndaj rrezikut të luhatjeve të pafavorshme në normën e interesit, për rastin e rritjes së tyre. Aftësia e bizneseve për të përballuar këto rreziqe, ndikohet edhe prej pozicionit të tyre debitor ndaj sistemit financiar.

Në lidhje me veprimtarinë e sistemit financiar, rreziku i drejtpërdrejtë dhe ai i tërthortë i kreditit përfaqësojnë rrezikun kryesor, veçanërisht për sektorin

bankar. Ndonëse me ritme të ndryshme, cilësia e kredisë ka rënë për kredinë në lekë, për kredinë në valutë, për kredinë për sektorin e biznesit dhe për individët. Me përjashtim të sektorit të bujqësisë, sektorët e tjerë kanë shënuar rënie të cilësisë së kredisë, ku veçohet sektori i ndërtimit. Në përgjigje të kësaj situate, bankat kanë rritur nivelin e fondeve rezervë dhe kanë përforcuar procedurat standarde për dhënien dhe monitorimin e kredisë. Në këtë kuadër, konstatohet një përshpejtim i veprimeve të bankave për të kërkuar një zgjidhje të kredisë me probleme, duke përfshirë edhe rritjen e numrit të praktikave të kredisë që përcillen në gjykatë për ekzekutim të detyrimit. Këto veprime vlerësohen të nevojshme dhe ato duhet të jenë konsistente e të vazhdojnë në të ardhmen. Trajtimi i kredive me probleme në sektorin bankar, është i rëndësishëm për ritmin e dhënies së kredisë dhe kontributin e ardhshëm që mund të japë sektori bankar dhe sistemi financiar në zhvillimin ekonomik të vendit. Për këtë qëllim, kjo çështje u diskutua në mbledhjen e fundit të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF), ku u theksua se ajo duhet trajtuar me përparësi dhe në mënyrë të zgjeruar e të plotë. Ulja e nivelit të kredive me probleme është një hap i nevojshëm për të çliruar potencialin e konsiderueshëm që ka sektori bankar për financimin e projekteve të vlefshme të investimit që vijnë nga familjet dhe bizneset. Në këtë kuadër GKSF-ja vlerësoi rezultatet paraprake të punës së nisur nga një grup i posaçëm ndërinstitucional për identifikimin e zgjidhjeve ligjore dhe operacionale, të cilat lehtësojnë procesin e ekzekutimit të kolateraleve si dhe nxiti konkretizimin e tyre. Gjithashtu, GKSF vlerësoi që duhet të identifikohen dhe të zbatohen përmirësime të tjera rregullative dhe operacionale që lehtësojnë dhe përshpejtojnë procesin e trajtimit të kredive me probleme. Përmirësimi i gjendjes së likuiditetit të bizneseve do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së kredisë të sektorit bankar. Për këtë arsye, GKSF-ja i sugjeroi Qeverisë që të ndikojë për kryerjen në kohë të pagesave ndaj kontraktorëve të sektorit privat, të cilët zbatojnë projekte të ndryshme të saj, në përputhje me përcaktimet ligjore për ruajtjen e treguesve fiskalë.

Sektori bankar paraqitet relativisht i mbrojtur nga rreziku i drejtpërdrejtë prej lëvizjeve të pafavorshme në kursin e këmbimit dhe në normën e interesit. Një gjë e tillë diktohet prej pranisë në bilancin e sektorit bankar të nivelit të ulët të pozicionit të hapur në valutë dhe madhësisë së krahasueshme të aktiveve dhe të detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit. Megjithatë, sektori bankar paraqitet i ndjeshëm ndaj ndikimit që japin mbi klientët e tij lëvizjet në kursin e këmbimit dhe në normën e interesit. Një nënçmim i ndjeshëm i kursit të këmbimit ose një rritje e tillë e normës së interesit, mund të dëmtojë aftësinë paguese të klientëve të sektorit bankar, veçanërisht të bizneseve. Një vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet kredisë në valutë dhe rreziqeve të saj, sidomos në rastet kur burimi kryesor i shlyerjes së saj është në monedhën vendase. Në një transaksion afatgjatë kredie, bankat dhe klientët e tyre duhet të arrijnë një vendimmarrje të arsyetuar në lidhje me ecurinë e normës së interesit në të ardhmen dhe zbutjen reciproke të rrezikut nëpërmjet përcaktimit të formës më të përshtatshme të kredisë.

Rreziku i likuiditetit për sektorin bankar, vlerësohet gjithashtu në nivele të moderuara. Depozitat përbëjnë burimin kryesor të financimit për sektorin

bankar dhe ato janë rritur me ritme të mira. Kohëzgjatja mesatare e depozitave është rritur. Huamarrja nga jorezidentët mbetet në nivele të kontrolluara. Aktivet likuide të sektorit, në lekë dhe në valutat kryesore, janë rritur si rezultat i kërkesave më të larta rregullative. Raporti kredi ndaj depozitave, mbetet në nivele të mira dhe ofron hapësirën e nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë. Bankat mund të plotësojnë nevojat për likuiditet afatshkurtër në tregun ndërbankar, si edhe duke marrë pjesë në operacionet e injektimit të likuiditetit që kryhen rregullisht nga Banka e Shqipërisë. Sidoqoftë, në këtë drejtim bankat duhet të tregojnë kujdes në administrimin e kolateraleve të përshtatshme për huamarrje në tregun ndërbankar.

Treguesit e kapitalizimit të veprimtarisë, janë përgjithësisht në nivele më të mira se në gjashtëmujorin e parë të vitit. Kontributin kryesor në këtë përmirësim e ka dhënë rritja e ndjeshme e kapitalit nga disa banka, në vijim të kërkesave mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, aftësia e sektorit bankar për të gjeneruar të ardhura të mjaftueshme, për të mbështetur rritjen e kapitalit dhe zhvillimin e veprimtarisë me burime të brendshme, ka nevojë të forcohet. Për këtë arsye, në kushtet e rritjes së shpenzimeve për rrezikun e kreditit, bankat duhet të mbajnë nën kontroll ecurinë e kostove operative.

Për të vlerësuar ndjeshmërinë e treguesve kryesorë të kapitalizimit të sektorit bankar ndaj lëvizjeve në treguesit makroekonomikë, Banka e Shqipërisë realizon rregullisht ushtrimet e provës së rezistencës. Ushtrimi përmban skenarin bazë dhe një ose më shumë skenarë të rrezikut. Skenarët përfshijnë supozime lidhur me lëvizjet në normën e rritjes së PBB-së, në nivelin e kursit të këmbimit dhe të normës së interesit, si edhe në nivelin e kreditimit, dhe shtrihen për një periudhë dyvjeçare, deri në fund të vitit 2013. Rezultatet e ushtrimit tregojnë që në tërësi, sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm në rast të realizimit të supozimeve për treguesit përkatës. Niveli i kapitalizimit për të gjithë sektorin mbetet mbi nivelin minimal të kërkuar në rastin e skenarit bazë. Në rastin e skenarit më të rënduar që përfshin supozimin e ngadalësimit të kreditimit dhe uljen e normës së rritjes të PBB-së, sektori bankar mund të ketë nevojë për kapital shtesë. Banka të veçanta, paraqesin nevoja për kapital shtesë në skenarët e rënduar dhe në skenarin bazë. Në përgjithësi, veprimtaria bankare zhvillohet në një mjedis ekonomik të brendshëm dhe të jashtëm sfidues, ndaj bankat duhet të ndjekin me kujdes ecurinë e veprimtarisë së tyre për të identifikuar në kohë dhe për të përmbushur nevojat për kapital.

Infrastruktura teknike që mbështet veprimtarinë e sektorit bankar, vlerësohet të ketë funksionuar sipas parametrave të pritshëm. Kjo infrastrukturë përfaqësohet kryesisht nga sistemet e pagesave, ku procesohen të gjitha transaksionet që bankat tregtare kryejnë mes tyre, me klientët ose me Bankën e Shqipërisë, për vete ose në emër të klientëve të tyre. Për vitin 2011, në krahasim me vitin 2010 vihet re rritja e numrit dhe vlerës së transaksioneve në sistemin e pagesave me vlerë të vogël (AECH), ndërsa ka një rënie të tyre në sistemin e pagesave me vlerë të madhe (AIPS). Rritja e kufirit të vlerës së klerimit të transaksioneve në sistemin AECH si dhe përdorimi më i ulët i instrumenteve financiare të Bankës së Shqipërisë nga ana e bankave, janë arsyet kryesore për rënien e transaksioneve në sistemin AIPS. Përdorimi i

kartave të kreditit dhe të debitit ka shënuar gjithashtu rritje. Ritmi i rritjes së përdorimit ka qenë më i lartë për kartat e kreditit, për shkak të bazës më të ulët. Megjithatë, kartat e debitit zënë rreth 95% të kartave në qarkullim. Gjatë periudhës, bankat kanë shtuar më tej numrin e makinave elektronike të arkës (ATM) si edhe të pikave të pakicës ku mund të kryhen transaksione blerjeje me karta (POS). Në fund të vitit, 11 banka ofronin shërbimet e tyre për klientët nëpërmjet internetit. Numri i transaksioneve të kryera përmes kësaj teknologjie dhe vëllimi i tyre, ka shënuar rritje.

I. ZHVILLIMET NË MJEDISIN MAKROEKONOMIK BOTËROR

Rigjallërimi i ekonomisë globale u ngadalësua gjatë gjysmës së dytë të vitit 2011, kryesisht si pasojë e thellimit të krizës së borxhit publik në Eurozonë me një ndikim të ndjeshëm në vendet e zhvilluara. Pasiguria rreth masës së ekspozimit të bankave evropiane ndaj borxhit sovran dhe aftësisë për të përballuar goditje të mundshme, u pasqyrua në shtrëngimin e kushteve të financimit të tyre nga tregjet. Rritja ekonomike në vendet e Eurozonës pritet të jetë e dobët dhe kjo ka të ngjarë të mbajë të ulët kontributin e kërkesës së huaj në zhvillimin e ekonomisë së vendit.

1.1 ZHVILLIMET E PËRGJITHSHME EKONOMIKE NË BOTË

Gjatë vitit 2011, rritja në terma vjetorë e aktivitetit ekonomik botëror[3] u zvogëlua në 3.8% krahasuar me 5.2% në vitin 2010. Vendet e zhvilluara u rritën me 1.6% ndërsa rritja ekonomike për vitin 2012 parashikohet në 1.2%, kryesisht si rezultat i dobësimit ekonomik të Eurozonës, ngadalësimit të kreditimit të ekonomisë reale nga bankat dhe efektit frenues mbi rritjen ekonomike të procesit të konsolidimit fiskal. Rritja ekonomike e vendeve në zhvillim vlerësohet 6.2% për vitin 2011 dhe parashikohet të ngadalësohet në 5.4% gjatë vitit në vazhdim.

Pas një rritjeje të ngadaltë në gjysmën e parë të vitit 2011, ekonomia e SHBA-së u rigjallërua në gjysmën e dytë duke u mbështetur më shumë nga rritja e investimeve private, e shpenzimeve konsumatore dhe e eksporteve neto. Në terma vjetorë, rritja është ngadalësuar në 1.7% në 2011, nga 3% në vitin 2010. Norma e inflacionit që shënoi pikun e vet në shtator, erdhi duke rënë gjatë muajve të fundit të vitit 2011. Ecuria e tregut të pasurive të paluajtshme ka vazhduar të jetë e dobët, ndërsa norma e papunësisë shënoi rënie në tre muajt e fundit të vitit, duke u stabilizuar në vlerën 8.5% në dhjetor 2011. Deficiti buxhetor (9.7% e PBB-së) dhe borxhi sovran (84.9% e PBB-së) vijojnë të mbeten në nivele të larta (Tabela 1.1). Debatet e tejzgjatura mbi zvogëlimin e nivelit të borxhit shtetëror rritën pasigurinë mbi menaxhimin e problemeve fiskale të vendit, çka çoi në uljen e vlerësimit të borxhit nga S&P nga "AAA" në "AA+", në gusht 2011. Duke u nisur nga kushtet ekzistuese makroekonomike, Rezerva Federale e SHBA-së (FED) vendosi të mbajë të pandryshuar normën e fondeve federale në 0%-0.25%, duke shprehur publikisht pritjet e saj për një nivel të ngjashëm për periudhën deri në mes të vitit 2013.

Aktiviteti ekonomik në Eurozonë, në gjysmën e dytë të vitit 2011, u ngadalësua si rezultat i rënies së shpenzimeve të konsumatorëve dhe dobësimit të kërkesës

[3] *FMN, Parashikimi Ekonomik Botëror, Janar 2012.*

së brendshme në vendet e mëdha të Eurozonës. Eksportet dhe importet u rritën në mënyrë të moderuar gjatë tremujorit të tretë 2011 dhe u ngadalësuan më tej në tremujorin e katërt. Në dhjetor 2011, norma e papunësisë për Eurozonën është rritur në nivelin 10.4%. Në kushtet e dobësimit të rritjes ekonomike, presionet inflacioniste janë zbehur në muajt e fundit të vitit dhe vlerësohen në rënie gjatë muajve në vazhdim. Konsolidimi fiskal vazhdon të mbetet sfida kryesore e vendeve të Eurozonës, ndaj shumë prej tyre si Italia, Spanja, Franca etj., kanë deklaruar masa të tjera për të pakësuar më tej borxhet e larta të akumuluara.

Tabelë 1.1. Disa tregues kryesorë makroekonomikë për SHBA-në dhe Eurozonën.

	Rritja e PBB-së (vjetore)			Inflacioni (normë vjetore)			Papunësia (në %)			Borxhi sovran (% ndaj PBB-së)		
	2011[1]	T2'11	T3 '11	2011	Nën'11	Dhj.'11	2011	T3'11	T4'11	2010	T2'11	T3'11
SHBA	1.7	1.8	2.8	3.2	3.4	3.0	9.0	9.1	8.7	82.4	83.0	84.9:
Eurozonë	1.6	1.6	1.3	2.7	3.0	2.7	10.1	10.2	10.4	85.3	87.2	86.8
Gjermani	2.7	2.9	2.6	2.5	2.8	2.4	5.9	5.8	5.5	83.2	82.0	81.8
Francë	1.7	1.7	1.5	2.3	2.7	2.7	9.7	9.7	9.9	82.3	86.0	85.2
Itali	0.6	0.7	0.2	2.9	3.7	3.7	8.4	8.6	8.9	118.1	121.2	119.6
Greqi	-5.0	-7.4	-5.0	3.1	2.8	2.2	-	18.8	19.2[2]	144.9	154.7	159.1

Burimi: Bureau of Economic Analysis, baza e të dhënave të Eurostat-it, ECB- Monthly Bulletin, baza e të dhënave e FMN-së .

[1] *Të dhënat e PBB-së për vendet e Eurozonës për vitin 2011, janë vlerësime të FMN-së (Shtator 2011). Për SHBA-në janë vlerësime të BEA-s (Bureau of Economic Analysis).*

[2] *Muaji tetor 2011.*

Aktiviteti ekonomik në rajonin e Evropës Qendrore e Lindore është gjallëruar gjatë gjysmës së dytë të vitit por me ritme të ndryshme midis vendeve. Në vende si Bullgaria, Republika Çeke dhe Sllovakia, ritmi i rritjes ekonomike u ngadalësua në tremujorin e tretë krahasuar me periudhat e mëparshme, kryesisht për shkak të rënies së kërkesës së jashtme dhe dobësimit të investimeve. Nga ana tjetër, vende si Polonia dhe Rumania vazhduan të kenë rritje të mirë ekonomike të mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme. Në rajonin e Ballkanit, Turqia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë kanë regjistruar ritme më të larta të rritjes ekonomike. Inflacioni vjetor ka qenë në rënie ose i pandryshuar në pjesën më të madhe të vendeve të rajonit, me përjashtim të Turqisë. Efektet e krizës së borxhit në Eurozonë, pritet të ndihen në masë të konsiderueshme në vendet e Evropës Qendrore e Lindore, për shkak të lidhjeve të forta tregtare e financiare të këtyre vendeve me vendet e Eurozonës. FMN vlerëson në 4.25% rritjen ekonomike të këtij rajoni gjatë vitit 2011 dhe parashikon ngadalësim të rritjes ekonomike në 2.75% gjatë vitit 2012.

Tabelë 1.2. Disa tregues kryesorë makroekonomikë për Evropën Qendrore dhe Juglindore.

	Rritja reale e PBB-së (në %)			Inflacioni mujor (% vjetore)			Papunësia mujore* (në %)			
Evropa Qendrore e Juglindore	2011[1]	T2[2]	T3	2011[3]	Nën-11	Dhj.-11	2011[4]	T2	T3	T4
Hungari	1.8	1.7	1.5	3.9	4.3	4.1	10.9	11.0	10.8	10.9
Bullgari	2.5	2.0	1.6	3.4	2.6	2.0	11.1	11.2	10.9	11.2
Rumani	1.5	1.9	4.4	5.8	3.5	3.2	7.3	7.3	7.7	7.0
Rajoni										
Serbi	2.0	2.5	0.5	11.26	8.1	7.0	20.5	22.2	-	23.7
IRJM	3.0	5.0	2.3:	4.4	3.5	2.8	32.2	31.3	31.3	:
Kosovë	5.3	5.5	:	8.3		3.6	-	-	-	-
Turqi	6.6	8.8	8.3	6.0	9.5	10.4	10.5	8.3	8.3	:

Burimi: Baza e të dhënave e Eurostat-it, baza e të dhënave e FMN-së, bankat qendrore përkatëse, institutet statistikore përkatëse.

1 *Të dhënat e PBB-së për vitin 2011 janë vlerësime të FMN-së.*

2 *Të dhënat tremujore (me bazë vjetore) të PBB-së janë nga Eurostat, bankat qendrore dhe institucionet statistikore përkatëse.*

3 *Të dhënat e inflacionit të vitit 2011 për vendet e rajonit janë vlerësime të FMN-së.*

4 *Të dhënat e papunësisë për Hungarinë, Bullgarinë, Rumaninë janë nga Eurostat. Të dhënat e papunësisë për vitin 2011, për vendet e rajonit janë nga FMN, të dhënat e papunësisë sipas tremujorëve janë nga bankat qendrore përkatëse.*

Disa prej zhvillimeve ekonomike në Eurozonë dhe në rajon, mund të kenë ndikim mbi ekonominë e vendit tonë. Kështu, rënia e kërkesës agregate në këto vende do të ndikojë negativisht në termat e tregtimit të eksporteve shqiptare. Gjithashtu, përkeqësimi i kushteve të tregut të punës në Eurozonë dhe veçanërisht në Itali e Greqi[4], kombinuar dhe me masat e mëtejshme të shtrëngimit fiskal në këto vende, mund të kenë ndikim negativ në situatën financiare të emigrantëve shqiptarë, duke ulur më tej aftësinë e tyre për akumulimin e rezervave financiare dhe për dërgimin e tyre në atdhe. Ulja e mundshme e eksporteve dhe e dërgesave të emigrantëve, pakësojnë burimet e valutës në vend dhe nëse nuk kompensohen me një rënie të ngjashme të kërkesës për valutë, mund të rrisin presionin për nënçmimin e monedhës së vendit. Nga ana tjetër, dobësimi i presioneve inflacioniste në nivel botëror dhe në Evropë, mund të ndikojë në uljen e çmimeve të importit në vend. Faktor rreziku në këtë rast, mbetet ecuria e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare.

4 *Shiko hapësirën informuese 1.*

HAPËSIRË INFORMUESE 1. MARRËVESHJA PËR ZGJIDHJEN E BORXHIT SOVRAN TË GREQISË.

Në 21 shkurt 2012, ministrat e financave të Eurozonës miratuan një paketë të dytë shpëtimi prej 130 miliardë eurosh për Greqinë për të zgjidhur nevojat e menjëhershme të shlyerjes së borxhit kombëtar. Kjo marrëveshje synon të sjellë uljen e borxhit kombëtar në nivelin e 120.5% të PBB-së deri në vitin 2020. Marrëveshja do t`i mundësojë Greqisë një këmbim të obligacioneve me investitorët privatë për të ndihmuar në uljen dhe ristrukturimin e borxhit si dhe stabilizimin e gjendjes financiare të Greqisë.

Greqia do të ketë një fshirje të borxhit me rreth 100 miliardë euro, duke qenë se bankat dhe kompanitë e sigurimeve do të këmbejnë obligacionet aktuale me letra me vlerë me maturim më afatgjatë dhe me vlerë më të ulët të kuponit. Kreditorët privatë të borxhit grek pritet të pësojnë një humbje prej 53.5% ose më shumë, të vlerës nominale të obligacioneve si pasojë e këtij shkëmbimi. Arritja e kësaj marrëveshjeje ndihmon Greqinë në shlyerjen e pagesës së borxhit ndaj kreditorëve privatë prej 14.5 miliardë eurosh, e nevojshme për t`u paguar në datën 20 mars 2012.

Pjesa më e madhe e fondit prej 130 miliardë eurosh do të përdoret për të financuar këmbimin e obligacioneve dhe për të siguruar stabilitetin e sistemit bankar grek: rreth 30 miliardë euro do t`i shkojnë sektorit privat për të lehtësuar nënshkrimin e marrëveshjes, 35 miliardë euro të tjera do t`i lejojnë Greqisë financimin dhe riblerjen e obligacioneve, ndërsa 5.7 miliardë do të shkojnë për të paguar interesin e akumuluar të obligacioneve të tregtuara. Rreth 23 miliardë euro do të ndihmojnë në rikapitalizimin e bankave greke.

Në këtë proces, Banka e Greqisë do të kryejë vlerësimin e nevojave për kapital të bankave dhe planet e tyre për rikapitalizim brenda tremujorit të parë të vitit 2012. Më tej, pritet që Banka e Greqisë t'i komunikojë bankave afate specifike për të siguruar kapital në treg deri në shtator 2012. Bankat që do të paraqesin plane të arsyeshme kapitalizimi, do të mund të aplikojnë për ndihmë nga fondi grek i stabilitetit (Hellenic Financial Stability Fund), i cili disponon rreth 40 miliardë euro për këtë qëllim.

Vlen të theksohet fakti se ky ristrukturim ka sjellë një ekspozim më të ulët të bankave greke ndaj borxhit kombëtar grek, duke rënë nga 15% në 8% të borxhit të pashlyer. Në këtë mënyrë, vërehet një rritje e ekspozimit (transferim i borxhit) në vendet e Eurozonës, sipas grafikëve të mëposhtëm.

Grafik 1.1. Struktura e borxhit kombëtar grek para dhe pas ristrukturimit.



Burimi: Banka e Greqisë.

1.2 ZHVILLIMET KRYESORE NË TREGJET FINANCIARE

Rritja e rrezikut të borxhit sovran në Eurozonë dhe shqetësimet lidhur me ngadalësimin e rritjes ekonomike botërore, patën efekt frenues në tregjet financiare gjatë gjysmës së dytë të vitit 2011. Tensionet prekën kryesisht tregjet evropiane dhe më pak ato amerikane apo të vendeve në zhvillim.

Tregjet e parasë në Eurozonë u karakterizuan nga luhatshmëri e lartë dhe norma interesi në rritje. Për të zbutur tensionet, Banka Qendrore Evropiane vuri në përdorim instrumente të ndryshme financimi për të rritur likuiditetin në treg, si dhe realizoi dy ulje të normës bazë të interesit me nga 25 pikë bazë, respektivisht në nëntor dhe në dhjetor, duke zbritur nivelin e saj në 1%. Gjithsesi, në tremujorin e fundit të vitit 2011, pavarësisht sasisë së lartë të likuiditetit, vëllimet e tregtimit në tregun ndërbankar mbetën përgjithësisht të ulëta dhe primet e rrezikut u rritën më shumë se në tregjet e tjera, duke reflektuar edhe perceptimin më të lartë të rrezikut të kreditit për veprimet ndërbankare.

Zhvillimet në tregjet e obligacioneve shtetërore në Eurozonë u karakterizuan nga një frymë e lartë pasigurie dhe një heterogjenitet i theksuar midis vendeve. Presionet për rritjen e *yield*-eve të titujve shtetërorë u rritën veçanërisht për vendet me nivele të larta të borxhit publik, si Italia dhe Franca. Mosbesimi për një zgjidhje të shpejtë të krizës së borxhit në Eurozonë, u përforcua nga një ecuri e ngadaltë ekonomike dhe nxiti lëvizjen e kapitalit drejt tregjeve më të sigurta. Si rezultat, *yield*-et e titujve shtetërorë të Gjermanisë dhe SHBA-së pësuan një rënie të shpejtë dhe *spread*-et e tyre me disa vende të Eurozonës u zgjeruan. Për të zbutur luhatshmërinë e çmimeve dhe përhapjen e pasigurisë në segmente të tjera të tregut, qeveritë e vendeve me të ekspozuara ndaj niveleve të larta të borxhit publik kanë vazhduar të zbatojnë një sërë masash shtrënguese fiskale[5].

Aktiviteti në tregjet e kapitalit ra ndjeshëm gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2011, për shkak të hezitimit të investitorëve për investime në aksione dhe obligacione të korporatave. Kjo ka ruajtur presionin për rritje të normave të kthimit nga titujt privatë të borxhit, si edhe ka shkaktuar dobësi të tregjeve kryesore të aksioneve në botë. Në tregjet e monedhave, investitorët u drejtuan drejt monedhave të konsideruara si më të qëndrueshme, siç ishin jeni japonez dhe franga zvicerane. Në këto kushte, monedha euro ka qenë përgjithësisht e paqëndrueshme në tregtimin me monedhat kryesore gjatë gjysmës së dytë të vitit.

Në tregjet e lëndëve të para, çmimet kanë patur një prirje rënëse gjatë vitit 2011, si rezultat i dobësimit të kërkesës globale. Gjithsesi, çmimet e naftës kanë pësuar rritje gjatë fundit të vitit, kryesisht për shkak të zhvillimeve në kahun e ofertës dhe të rritjes së rrezikut gjeopolitik në vendet prodhuese. Për llojet e tjera të lëndëve të para (pa naftën) përmirësimi i kushteve të prodhimit dhe dobësimi i kërkesës globale, pritet të ndikojnë në rënien e çmimeve të tyre. Sipas FMN-së, çmimet për lëndët e para jonaftë pritet të ulen me 14% gjatë vitit 2012.

[5] *Shiko hapësirën informuese 2.*

Grafik 1.2. Normat e interesit dhe ecuria e monedhës euro në tregjet ndërkombëtare.



Burimi: Banka Qendrore Evropiane (majtas), Banka Qendrore Evropiane, Eurostat (djathtas).

HAPËSIRË INFORMUESE 2. MASAT KRYESORE TË QEVERIVE NË ITALI DHE SPANJË, PËR KONSOLIDIMIN FISKAL DHE RIGJALLËRIMIN E RRITJES EKONOMIKE.

ITALI: Thellimi i krizës së borxhit sovran në Eurozonë u reflektua në një sërë masash urgjente të konsolidimit fiskal në Itali, një vend i cili ka nivelin e dytë më të lartë të borxhit publik në Bashkimin Evropian dhe prej vitesh gjendet në fund të listës së këtyre vendeve përsa i takon ritmit të rritjes ekonomike. Këto masa synuan të rrisnin konsolidimin fiskal në kushtet e mungesës së besimit të tregjeve financiare të cilat ushtruan presion në normat e interesit të borxhit të Italisë. Gjatë vitit 2011, Qeveria Italiane prezantoi tri paketa kryesore fiskale si më poshtë:

- *Dekretligji nr. 98, i datës 6 korrik 2011 përmbante masa urgjente të stabilizimit fiskal të tilla si ndërprerja e transfertave ndaj autoriteteve lokale dhe ndaj shpenzimeve për shëndetin. Me hyrjen në fuqi të ligjit të korrikut 2011, paketa fiskale e vitit, e cila shënonte fillimisht vlerën 40 miliardë euro, u rrit në 48 miliardë euro. Kjo rritje reflektoi kryesisht rritjen e të ardhurave të qeverisë për shkak të rritjes së akcizës mbi naftën dhe rritjes së pagesës për shpenzimet mjekësore dhe të kontributeve të pensioneve.*

- *Pavarësisht këtyre masave, spekulimet e tregjeve financiare ndaj Italisë nuk u lehtësuan. Si rrjedhim, në muajin gusht 2011 Qeveria Italiane prezantoi masa të reja të konsolidimit fiskal. Këto masa përfshinin dispozita mbi arritjen e një deficiti primar të qeverisë prej 0% në vitin 2011 duke arritur në 6% në vitin 2014, ku rreth 50% e korrigjimit të nevojshëm të këtij deficiti do të ndodhë gjatë vitit 2012. Ky korrigjim bazohej në një rritje të taksave ndërkohë që nuk parashikohej ulje e shpenzimeve buxhetore.*

- *Në 6 dhjetor 2011, Qeveria e re Italiane miratoi dekretin nr. 201 i cili u konvertua në ligj në 22 dhjetor. Paketa e tretë ekonomike për vitin 2011 synonte rritjen e besimit të tregjeve financiare në ekonominë italiane për të shmangur një krizë të borxhit sovran. Një ndër masat kryesore të paketës ishte rivendosja e taksës së shtëpisë (prima casa tax) e cila vlerësohet të ketë një ndikim të konsiderueshëm në Itali ku individët investojnë ndjeshëm në blerjen e banesave. Gjithashtu u përshpejtua edhe reforma e pensioneve e cila nënkupton se duke filluar nga 1 janari 2012, do të përfshihen në një sistem të bazuar në kontribute edhe të punësuarit e klasave deri në*

atë moment të përjashtuara nga ky detyrim. Paketa pezulloi edhe skemën e pensioneve të veçanta sipas klasave duke i zëvendësuar me pensionet e parakohshme, të cilat mund të tërhiqen brenda vitit 2012, (pavarësisht moshës) nga individë të cilët kanë më shumë se 42 vite dhe 1 muaj kontribute për meshkujt dhe 41 vite dhe 1 muaj kontribute për femrat. Në paketë parashikohej rritja e normës së kontributit për të vetëpunësuarit dhe për të punësuarit me kontratë të përkohshme, ndërkohë që mosha e pensionit për meshkujt e punësuar, të vetëpunësuar dhe në sektorin publik u rrit në 66 vjeç duke nisur nga 1 janari 2012. Nga ana tjetër, mosha e pensionit për femrat u rrit në 62 vjeç gjatë vitit 2012, duke synuar nivelin më të lartë prej 66 vjeç në vitin 2018. Gjithashtu, paketa pezullonte indeksimin e pensioneve duke përjashtuar ato me nivel të ulët. Së fundi, paketa e dhjetorit përmbante edhe klauzolën e përfshirë në paketat e mëparshme: në rast se masat ndërmarra nuk arrijnë të sigurojnë një nivel kursimi prej të paktën 4 miliardë eurosh brenda vitit 2012, në tetor 2012, do të prezantohet një rritje e mëtejshme e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.

SPANJË: Masat mbi reduktimin e deficitit fiskal në Spanjë janë prezantuar që prej vitit 2010, me një fokus kryesor në uljen e shpenzimeve të autoriteteve të ndryshme publike. Edhe Spanja vuan tkurrjen e ekonomisë, papunësinë në nivele mjaft të larta dhe një situatë të brishtë të sektorit bankar.

Sipas Dekretit Mbretëror nr.8/2010, u paraqitën një sërë veprimesh që kishin si synim kontrollin e deficitit publik të krijuar prej krizës ekonomike dhe financiare. Masat kryesore rregullative ishin:

- *Pezullim i indeksimit të pensioneve për vitin 2011, përveçse për pensionet minimale dhe ato jokontribuese.*
- *Reduktim të pagave të punonjësve publikë me një mesatare prej 5%, prej fillimit të qershorit 2010 deri në dhjetor 2011.*
- *Ndryshim i afateve kohore për dhënien e përfitimit të kujdesit shëndetësor në gjashtë muaj nga paraqitja e kërkesës.*
- *Heqje e të drejtës për tatim më të ulët nga tatimi mbi të ardhurat personale në rast lindjeje apo adoptimi.*
- *Heqje e pagesës së vetme të përfituar nga sigurimet shoqërore në rast lindjeje apo adoptimi.*
- *Vonesë në veprimet ekonomike dhe financiare të autoriteteve lokale.*

Sipas Dekretit Mbretëror nr. 8/2011 u kërkua që shpenzimet e administratës publike dhe të autoriteteve lokale të jenë në përputhje me termat afatmesëm të rritjes së ekonomisë së Spanjës, të përcaktuar si rritje e PBB-së në terma nominalë. Për më tepër, dekreti shqyrtoi çështje të taksimit, si një mënyrë promovimi për aktivitetin privat, duke modifikuar tatimin mbi të ardhurat personale, tatimet e biznesit, tatimet mbi të ardhurat e jorezidentëve dhe ato të pronës.

Edhe pas kësaj, qeveria spanjolle ishte në presion të vazhdueshëm nga autoritetet evropiane për të vazhduar politikën e reformave. Kështu, në shtator të vitit 2011, qeveria ndryshoi nenin 135 të Kushtetutës për të siguruar ekuilibrin e tepricës buxhetore, duke siguruar në këtë mënyrë që autoritetet publike do të sillnin veprimet e tyre në të njëjtën linjë me parimin e stabilitetit buxhetor dhe duke i dhënë prioritet absolut pagesave të interesave dhe principalit të borxhit publik.

Masat më të vonshme të adoptuara për kufizimin e deficitit publik i përkasin Dekretit Mbretëror 20/2011 të muajit dhjetor 2011, mbi masa urgjente fiskale dhe financiare. Ky dekret prezantoi ndryshime të rëndësishme në politiken tatimore dhe synoi rënien e parashikuar të deficitit në 6% për vitin 2011 dhe në 4.4% për vitin 2012.

Reformat u shtrinë edhe mbi sistemin e sigurimeve shoqërore për të ulur kostot e pensioneve. Ndryshimet kryesore lidhur me kontributin për pensione ishin:

- *Rritja e moshës së pensionit nga 65 në 67 vjeç, përveç rastit kur kontribuesi i moshës 65-vjeçare ka kontribuar në këtë skemë për 38.5 vite.*
- *Rritjen e viteve të kontributit të marra për bazë në llogaritjen e viteve të pensionit nga 15 në 25, duke çuar kështu në pensione më të ulëta për shkak të kontributeve më të ulëta të marra në konsideratë për vitet më të hershme të punës.*

Zhvillimet në sistemin bankar – Kushtet e mjedisit operues të Grupeve të Mëdha e Komplekse Globale Bankare (GMKGB) janë vështirësuar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2011[6]. Pas një ecurie të mirë në fillim të vitit, treguesit e përfitueshmërisë (ROE) dhe të ardhurat neto, shënuan rënie në tremujorin e dytë duke u stabilizuar disi në tremujorin e tretë të 2011. Normat e ulëta të interesit dhe rritja e dobët e kredisë, u reflektuan në një rënie të ndjeshme të të ardhurave nga interesat në disa prej bankave. Të ardhurat nga aktiviteti tregtar, gjithashtu u zvogëluan si pasojë e rritjes së tensioneve në tregjet financiare. Norma mesatare e mjaftueshmërisë së kapitalit për GMKGB u stabilizua në vlerat 13.4% dhe 13.3% respektivisht në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit. Përkeqësimi i pritjeve mbi ekonominë globale mund të detyrojë këto banka të rrisin provigjonimin për të përballuar humbjet e mundshme nga kreditë e këqija.

Përsa i përket Grupeve të Mëdha e Komplekse Bankare të Eurozonës, performanca financiare është përkeqësuar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2011, kryesisht për shkak të rritjes së provigjoneve dhe rënies së theksuar të të ardhurave nga aktiviteti tregtar, duke reflektuar rritjen e pasigurisë në tregjet financiare evropiane dhe përkeqësimin e situatës ekonomike në disa prej vendeve të Eurozonës. Nga ana tjetër, tensionet fiskale në Eurozonë kanë dëmtuar aftësinë e bankave evropiane për të rifinancuar detyrimet e tyre, veçanërisht në vendet me ekspozim të lartë ndaj Greqisë dhe institucioneve të saj financiare. Provat e rezistencës të aplikuara nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA) kanë treguar se grupet kryesore bankare të Eurozonës kanë nevojë të rrisin kapitalin e tyre, në vijim të ekspozimeve në borxhin sovran të vendeve të Bashkimit Evropian[7]. Në kuadër të situatës së krijuar, shumë banka evropiane kanë bërë përpjekje për të ulur ekspozimet e drejtpërdrejta ndaj vendeve me probleme fiskale, duke përfshirë edhe regjistrimin e shpejtë në bilanc të humbjeve prej këtyre ekspozimeve. Për periudhën në vazhdim, pasiguria rreth zhvillimeve të ardhshme në tregjet e titujve shtetërorë në Eurozonë, do të vazhdojë të mbetet e lartë, dhe rreziku i përhapjes së krizës në vende të

[6] *ECB- Financial Stability Review, December 2011.*
[7] *Shiko hapësirën informuese 3.*

tjera të Eurozonës me nivele të larta të borxhit publik, mbetet i pranishëm. Nga ana tjetër, sistemi bankar evropian vijon të përballet me rrezikun e financimit, si pasojë e pakësimit të sasisë dhe rritjes së kostos së fondeve për bankat. Gjithashtu, burim i vazhdueshëm rreziku është edhe përkeqësimi i cilësisë së kredisë për sektorin privat (familjet dhe korporatat jofinanciare), ndonëse nivelet e përkeqësimit janë të ndryshme në vende dhe institucione të ndryshme.

HAPËSIRË INFORMUESE 3. REZULTATET E STRESS-TEST-IT PËR GRUPET KRYESORE TË BANKAVE EVROPIANE, SIPAS AUTORITETIT BANKAR EVROPIAN.

Autoriteti Bankar Evropian (EBA), ka publikuar në datën 8 dhjetor 2011 (www.eba.europa.eu), rekomandimet dhe rezultatet e provës së rezistencës për 90 grupe bankare evropiane, pas përfshirjes së rivlerësimit të ekspozimeve në borxhin sovran të vendeve të Bashkimit Evropian, sipas të dhënave të datës 30 shtator 2011. Qëllimi është që të arrihet vlera 9% e raportit "Kapitali bazë i cilësisë së parë/Aktive me rrezik" brenda datës 30 qershor 2012. Për këtë, në total, bankat e përzgjedhura evropiane duhet të shtojnë kapitalin me rreth 114.7 miliardë euro.

Më poshtë jepen nevojat për kapital të bankave në disa nga shtetet evropiane.

Tabelë 1.3. Nevojat për rritjen e kapitalit të grupeve bankare sipas shteteve.

Shteti	Rritja e kapitalit (mld eur)
Spanjë	26.2
Gjermani	13.1
Itali	15.4
Greqi	30.0
Francë	7.30

Burimi: EBA Stress Test.

Pavarësisht rezultateve të stress-test-it, kërkesat konkrete për kapital për bankat greke do të përcaktohen në marrëveshjen me Trojkën (Bashkimi Evropian, Banka Qendrore Evropiane dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar).

Përsa i përket grupeve evropiane bankare që operojnë në Shqipëri, EBA ka rekomanduar rritjen e kapitalit me 2.1 miliardë euro për Raiffeisen Bank dhe Societe Generale, ndërkohë që Intesa San Paolo dhe Credit Agricole nuk kanë nevojë të rrisin kapitalin.

Tabelë 1.4. Nevojat për rritjen e kapitalit të grupeve bankare që operojnë në Shqipëri.

Banka	Rritja e kapitalit (mld eur)
Raiffeisen	2.13
Intesa San Paolo	0
Societe Generale	2.1
Credit Agricole	0

Burimi: EBA Stress Test.

EBA thekson se rritja e kërkuar e kapitalit është një masë e jashtëzakonshme dhe e përkohshme. EBA pranon të rishikojë vendimin e saj në një kohë të mëvonshme (pa specifikuar një datë) nëse kushtet e borxhit sovran përmirësohen.

Sipas rekomandimeve të EBA-s:

1) Nëse autoritetet kombëtare mbikëqyrëse (AKM) bien dakord me rekomandimet dhe rezultatet e bankave (duhet t'i kthejnë një përgjigje EBA-s brenda datës 8 shkurt 2012), të gjitha bankat duhet të dorëzojnë pranë AKM-së planet e tyre të rritjes së kapitalit, brenda datës 20 janar 2012;

2) Çdo autoritet mbikëqyrës kombëtar, përpara se të bjerë dakord me këto plane, duhet t'i diskutojë ato në Kolegjet e Mbikëqyrësve (sipas rëndësisë dhe përshtatshmërisë) dhe me EBA-n;

3) Rritja e kapitalit, duhet të synojë të mos pengojë kredidhënien në sektorin real të ekonomisë së BE-së;

4) Bankat duhet më parë të përdorin burimet private të financimit për të krijuar rezervat e kapitalit, duke përfshirë të ardhurat e krijuara, uljen e pagesave të bonuseve, emetimin e aksioneve të reja të zakonshme dhe të formave të tjera të përshtatshme të kapitalit, dhe forma të tjera të menaxhimit të detyrimeve. Gjithashtu, rritja e kapitalit nëpërmjet uljes së aktiveve me rrezik, në përgjithësi, nuk do të lejohet si një instrument që do të adresojë kërkesat për kapital, me përjashtim të rasteve kur këto janë planifikuar tashmë dhe po merren në konsideratë nga AKM.

ZHVILLIMET PËR GRUPET BANKARE QË OPEROJNË NË SHQIPËRI

Në tabelën e mëposhtme paraqiten në mënyrë të përmbledhur të dhëna të pasqyrave financiare të grupeve bankare të cilat operojnë në Shqipëri. Në krahasim me një vit më parë, treguesit e pasqyrave të të ardhurave paraqesin një tendencë rënëse të nivelit të fitimit, kryesisht prej rënies së të ardhurave për këto grupe bankare, pavarësisht rënies së shpenzimeve. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit paraqitet në nivele të kënaqshme për këto grupe, pa shfaqur nevojën për shtesë të kapitalit ekzistues, në bazë të kritereve rregullative në fuqi. Totali i aktiveve të secilës bankë në vendin tonë ndaj totalit të aktiveve të grupit ekzistues ka mbetur i njëjtë për të gjitha grupet bankare të marra në analizë.

Tabelë 1.5. Të dhëna financiare mbi grupet e huaja bankare të pranishme në Shqipëri.

	Raiffesen Bank International[i]	Intesa San Paolo[ii]	Alpha Bank*[iii]	Piraeus Bank*[iv]	National Bank of Greece*[v]	Societe Generale[vi]	Credit Agricole[vii]
Totali i aktiveve	146.9	639.2	62.7	55.5	115.5	1,181.4	1,879.5
Ndryshimi vjetor	12.1%	-2.7%	-7.4%	0.0%	-6.0%	4.0%	
Vëllimi i kredive të klientëve	81.5	376.7	47.2	35.5	73.2	367.5	799
Ndryshimi vjetor	7.8%	-0.5%	-5.4%	-4.0%	-2.0%	-1.0%	
Vëllimi i depozitave të klientëve	66.7	357.4	31.7	24.5	60.7	340.2	666.7
Ndryshimi vjetor	15.8%	-10.5%	20.5%	15.0%	-13.0%	1.0%	
Norma e kredive me probleme	8.6%		11.6%	11.7%			
Provigjone	1	2	2.7	0.9	1.3		
Fitimi neto	0.9	-8.1	0.1		-1.3	2.4	1.1
Ndryshimi vjetor	-11.0%		-62.9%	12.0%		-39.1%	-72.4%
Të ardhurat operative	5.4	16.7	1.7		3.1	4.27	13.5
Ndryshimi vjetor	1.3%	1.5%	2.4%		-6.0%	-25.3%	1.1%
Të ardhurat neto nga interesi, ndryshim vjetor	2.5%	0.8%	-3.1%	4%	-8%		
Të ardhurat neto nga komisionet, ndryshim vjetor	-0.1%	-3.3%	-15.2%	1.0%	-18.0%		
Shpenzimet operative, ndryshim vjetor		-1.8%	-2.6%	4.4%	-5.0%	3.0%	3.7%
Kosto të stafit, ndryshim vjetor	6.0%	-2%	-2.7%	-4.0%	-6.0%		
Shpenzime të përgjithshme, ndryshim vjetor	4.7%		-3.1%	-7.0%			
Rezultati neto operativ, ndryshim vjetor	-2.8%	5.9%	-45.1%				
Marzhi neto nga interesat	2.61%		2.8%		3.66%		
Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit	9.9%	11.5%	12.3%	8.8%	10.7%	10.7%	10.2%
Totali i aktiveve të bankës në Shqipëri ndaj totalit të grupit	1.57%	0.14%	0.84%	1.16%	0.25%	0.03%	0.01%

**Të dhënat në miliardë euro për nëntëmujorin 2011.*
Burimi: Rezultatet financiare të grupeve bankare.

[i] *Raporti vjetor 2011, URL: http://investor.rbinternational.com/fileadmin/ir/2011_FY/2012-03-29_2011_Annual_Report_RBI.pdf*
[ii] *Rezultatet financiare për vitin 2011, URL: http://www.group.intesasanpaolo.com/scriptIsir0/si09/eng_index.jsp#/investor_relations/eng_comunicati_stampa_price.jsp*
[iii] *Rezultatet financiare për nëntëmujorin 2011, njoftim për shtyp URL: http://www.alpha.gr/files/deltia_typou/Deltio_Typou_20111128EN.pdf*
[iv] *Rezultatet financiare për nëntëmujorin 2011, URL: http://www.piraeusbank.gr/Documents/internet/PressReleases/2011/9m_Results_en.pdf*
[v] *Rezultatet financiare për nëntëmujorin 2011, URL: http://www.nbg.gr/wps/wcm/connect/7425d800493daac4b386f736172d79c7/Press_Release_EN_9M_2011.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=7425d800493daac4b386f736172d79c7*
[vi] *Informacioni financiar për vitin 2011, njoftim për shtyp, URL: http://www.societegenerale.com/sites/default/files/B33AF0101F8ABE99C12579A60020D74F.pdf*
[vii] *Pasqyrat financiare për vitin 2011, URL: http://www.credit-agricole.com/en/Finance-and-Shareholders/Financial-reporting/Credit-Agricole-S.A.-financial-results*

II. ZHVILLIMET NË MJEDISIN MAKROEKONOMIK NË VEND

2.1 SEKTORI I EKONOMISË REALE

Ekonomia shqiptare është rritur mesatarisht me 3.1% gjatë vitit 2011. Pas një ngadalësimi të normës së rritjes në tremujorin e dytë, ekonomia shënoi përmirësim të aktivitetit të saj gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit. Sektorët e tregtisë dhe transportit vijojnë të mbështesin në mënyrë të qëndrueshme zgjerimin e aktivitetit ekonomik. Ecuria e sektorit të industrisë ka shënuar luhatje gjatë vitit 2011 ndërkohë që sektori i ndërtimit ka reflektuar përmirësim të aktivitetit të tij gjatë gjashtëmujorit të dytë 2011. Treguesit e tërthortë sugjerojnë se kontributi i konsumit dhe investimeve private në rritjen ekonomike gjatë vitit 2011 ka qenë i kufizuar. Edhe zhvillimet në përbërësin e shpenzimeve qeveritare dhe të tregtisë me jashtë reflektojnë ngadalësim të kontributit të tyre.

Me konkretisht në fund të vitit 2011, të ardhurat e përgjithshme të qeverisë janë rritur me 1.8% në terma vjetorë, ndërkohë që shpenzimet janë zgjeruar me 3.7%. Si rrjedhim, deficiti fiskal është rritur me 20.2% në terma vjetorë, në një nivel prej 45.7 miliardë lekë, duke përbërë 3.5% të PBB-së vjetore. Financimi i tij është kryer nga burime të brendshme në masën 57%. Stoku i borxhit publik arriti në 772.5 miliardë lekë, duke shënuar rritje të vlerës me 8% në krahasim me fundin e vitit 2010, dhe duke u ngjitur në nivelin 58.5% të PBB-së. Borxhi i emetuar në tregun e brendshëm përfaqëson rreth 57% të stokut dhe borxhi i jashtëm 43% të tij. Struktura e borxhit të jashtëm sipas koncesionalitetit ka vazhduar prirjen rritëse të viteve të fundit të stokut të borxhit me terma tregtarë, i cili përfaqëson rreth 49.5% të stokut, kundrejt 48.3% në fund të vitit 2010. Kohëzgjatja mesatare e borxhit të emetuar në letra me vlerë ka thelluar prirjen rënëse gjatë vitit 2011 duke shënuar mesatarisht 360 ditë deri në maturim në muajin dhjetor 2011.

Grafik 2.1. Kohëzgjatja mesatare e ditëve deri në maturim, për borxhin e emetuar në letra me vlerë.



Burimi: Ministria e Financave

Në fund të vitit 2011, deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në masën 1,145 milionë euro ose 11.98% të PBB-së, një rritje me vetëm 0.08 pikë përqindje në krahasim me fundin e vitit 2010 (11.9%). Për të njëjtën periudhë, deficiti i bilancit tregtar vlerësohet në masën 2,106.96 milionë euro ose 22% e PBB-së, duke u ngushtuar me 1.5 pikë përqindje në krahasim me fundin e vitit 2010. Ky zhvillim reflekton kryesisht rritjen më të shpejtë të importeve me 10.2% në

terma vjetorë, ndërsa eksportet janë rritur me 7.9% në terma vjetorë. Në fund të vitit 2011, eksportet mbulonin 29.6% të importeve, krahasuar me një vlerë mesatare vjetore prej 36%.

Nga ana tjetër, llogaria kapitale dhe financiare është zgjeruar me 5.6% në terma vjetorë, në një vlerë 921.2 milionë euro duke financuar 80% të deficitit të llogarisë korrente. Kontributi kryesor në zgjerimin e llogarisë kapitale dhe financiare është rritja e investimeve të tjera, ndërkohë që investimet e huaja direkte dhe transfertat kapitale janë ngushtuar me përkatësisht 9.7% dhe 0.8% në terma vjetorë.

Grafik 2.2. Ecuria e llogarisë korrente dhe asaj kapitale dhe financiare sipas përbërësve përkatës.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndonëse besimi i konsumatorëve u përmirësua në fund të vitit 2011[8], vlerësohet se kontributi i konsumit në rritjen ekonomike ka qenë i kufizuar. Dërgesat e emigrantëve gjatë vitit 2011 janë zvogëluar me një normë vjetore prej 0.23%, ndërkohë që pjesa e dytë e vitit shënoi një rritje vjetore me 14% kundrejt një rënieje vjetore prej 11.3% në gjashtëmujorin e parë. Nga të dhënat operative vlerësohet se në këtë rritje të dërgesave të emigranteve në gjashtëmujorin e dytë, përfshihen edhe hyrjet e fondeve që kanë shoqëruar kthimin në atdhe për një pjesë të tyre, kushtëzuar prej situatës së vështirë ekonomike në vendet fqinje. Hyrja e fondeve si rezultat i kthimit në atdhe të emigrantëve, përfaqëson një hyrje kapitali në vlerë relativisht më të madhe dhe të njëhershme, por zvogëlon madhësinë e burimit potencial të dërgesave dhe qëndrueshmërinë e vlerës së tyre përgjatë kohës. Sidoqoftë, në afat të shkurtër ato mund të kontribuojnë në përmirësimin e konsumit dhe të investimeve private në vend. Konsumi është mbështetur nga zhvillimet relativisht pozitive në tregun e punës. Në fund të vitit, norma e papunësisë shënoi nivelin 13.29% krahasuar me 13.25% në fund të tremujorit të tretë dhe 13.49% në fund të vitit 2010. Në tremujorin e katërt të vitit 2011, numri i të punësuarve në sektorin privat jobujqësor u rrit 6.7% në terma vjetorë, ndërsa

[8] *Treguesi i besimit të konsumatorëve (TBK), u përmirësua me rreth 3.1 pikë përqindje në fund të vitit 2011 krahasuar me një vit më parë, kryesisht për shkak të përmirësimit të balancës së blerjeve në shuma të mëdha.*

numri i të punësuarve në sektorin shtetëror dhe atë privat bujqësor mbeti i pandryshuar nga tremujori i tretë 2011, duke u zvogëluar me 0.6% në terma vjetorë. Pritshmëritë[9] për tregun e punës në fillim të vitit 2012 vlerësohen pozitive por me një ritëm rritjeje më të ulët.

Inflacioni mesatar vjetor në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011 rezultoi 2.9%, rreth 1.1 pikë përqindje më pak se në gjashtëmujorin e parë të vitit. Në kushtet e presioneve të kontrolluara inflacioniste si dhe me qëllim stimulin monetar dhe nxitjen e aktivitetit ekonomik në vend, politika monetare uli normën bazë të interesit në muajt shtator dhe nëntor, përkatësisht me nga 0.25 pikë përqindje, duke e zbritur në nivelin 4.75%.

2.2 TREGU I BANESAVE

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011, indeksi i çmimeve të banesave shënoi ngadalësim të rritjes, ndërsa indeksi i qirasë vijoi rënien. Kredia për pasuri të paluajtshme ka shfaqur shenja rigjallërimi.

2.2.1 ZHVILLIMET NË TREGUN E BANESAVE

Tremujori i fundit i vitit 2011 shënoi një rënie të indeksit të çmimit të banesave[10] me 1% në terma vjetorë ndërkohë që gjatë gjithë vitit 2011 indeksi shënoi një rritje mesatare prej 2.9%. Një vit më parë, ritmi mesatar i rritjes ka qenë më i lartë, me 5% në terma vjetorë. Indeksi i çmimeve të qirasë ka reflektuar një rënie mesatare prej 2% gjatë vitit 2011, krahasuar me një rritje me 10% gjatë vitit 2010. Si rrjedhim i këtyre zhvillimeve, raporti midis indeksit të çmimeve të banesave dhe të qirasë është rritur në një mesatare prej 2.12 gjatë vitit 2011, krahasuar me 2.01 në vitin 2010.

Pavarësisht ngadalësimit të rritjes së çmimeve të banesave, kreditimi për blerje të pasurive të paluajtshme është gjallëruar gjatë vitit 2011. Në muajin dhjetor 2011, kredia për blerje të pasurive të paluajtshme është zgjeruar me 7.2% në terma vjetorë duke u përmirësuar me 1.4 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kostoja relative e pagesës së kredisë për blerje pasurie të paluajtshme ka shënuar gjithashtu rritje në fund të vitit 2011, kryesisht për shkak të rritjes së normës së interesit të kredisë për pasuri të paluajtshme[11].

---

[9] *Bazuar në Indeksin e Besimit të Bizneseve, gjatë tremujorit të fundit 2011, sektorët e ndërtimit dhe të shërbimeve raportojnë një rënie të pritshmërive për punësim, ndërkohë që sektori i industrisë pret një zgjerim më të ngadaltë të punësimit.*

[10] *Indekset e çmimeve dhe të qirasë së banesave ndërtohen vetëm për qytetin e Tiranës.*

[11] *Kostoja relative e pagesës për blerje pasurie të paluajtshme është matur si diferenca midis normës së interesit të kredisë për pasuri të paluajtshme dhe normës mesatare të rritjes së çmimeve të banesave për katër tremujorët e fundit. Në rast se norma e interesit rritet më shpejt se rritja e çmimeve të banesave, atëherë kostoja relative vlerësohet në rritje dhe anasjelltas.*

Grafik 2.3. Ecuria e indekseve të çmimit të banesave dhe qirasë si dhe kredisë për blerje të pasurive të paluajtshme.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Këto zhvillime sugjerojnë se pavarësisht se kërkesa e individëve për kredi për blerje shtëpie gjatë gjashtëmujorit të fundit të vitit 2011 ka rënë[12], lehtësimi i kërkesave të bankave në dhënien e kredisë ka zbutur këtë efekt. Megjithatë, pritshmëritë e bankave në lidhje me kërkesën e individëve për të marrë kredi për pasuri të paluajtshme në tremujorin e parë të vitit 2012 mbeten pesimiste dhe pse bankat raportojnë standarde më të lehtësuara të miratimit të kredisë për kreditimin total ndaj individëve, krahasuar me fundin e vitit 2011.

Në fakt, një aspekt i rëndësishëm i kredisë për blerje pasurie të paluajtshme është edhe cilësia e saj, e cila është përkeqësuar. Në dhjetor 2011, raporti i kredive me probleme për pasuri të paluajtshme shënoi vlerën 12.55%, krahasuar me 9.01% të një viti më parë. Në krahasim me totalin e portofolit të kredisë ku kredia me probleme përbën 18.76% të tepricës së kredisë, portofoli i kredisë për blerje pasurie të paluajtshme është më cilësor. Ky zhvillim reflekton një disiplinë më të fortë financiare që lidhet me kredinë për blerje banese për shkak të rëndësisë së kolateralit për huamarrësin. Ndonëse rreziku i cilësisë së portofolit të kredive për blerje pasurie të paluajtshme shfaqet në nivele të moderuara, monitorimi i vazhdueshëm i tij është i nevojshëm në kushtet kur kjo kredi përbën rreth 20% të kreditimit total të bankave.

[12] *Sipas Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues për tremujorin e katërt të vitit 2011, kërkesa e individëve për blerje shtëpie ka rënë duke shënuar vlerat negative prej 4.1 dhe 15.2 përkatësisht për tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit 2011. Ndërkohë, bankat raportojnë se standardet e miratimit të kredisë për individë kanë mbetur të pandryshuara në krahasim me tremujorin e mëparshëm, duke treguar një përmirësim të situatës krahasuar me shtrëngimin e standardeve që është reflektuar gjatë vitit 2011.*

HAPËSIRË INFORMUESE 4. LIDHJA MIDIS ÇMIMIT TË BANESAVE DHE KREDISË PËR PASURI TË PALUAJTSHME.

Rritja e çmimeve të banesave të vlerësuara nëpërmjet Indeksit të Çmimit të Banesave pas vitit 2005 ka qenë e ndjeshme. Ky zhvillim ka rritur në mënyrë të ndjeshme kapacitetin huamarrës të agjentëve ekonomikë nëpërmjet efektit kolateral, ndërkohë që zgjerimi i shpejtë i kredisë për blerje pasurie të paluajtshme është reflektuar në rritje të peshës së këtij përbërësi në totalin e detyrimeve të agjentëve ekonomikë. Ndikimet potenciale negative në rast të rritjes së rrezikut të kredisë të agjentëve për shkak të zhvillimeve në normat e interesit apo nivelin e të ardhurave mund të përkeqësohen më shumë në rast se shoqërohen nga një rënie e nivelit të çmimeve të banesave.

Qëllimi i kësaj hapësire informuese është të vlerësojë ndërlidhjen që ekziston midis ecurisë së çmimit të banesave dhe kredisë për pasuri të paluajtshme për të vlerësuar këtë rrezik për stabilitetin financiar në vend. Vlerësimi i lidhjes bazohet në materialin "Ndërlidhja midis çmimit të banesave dhe të kredisë për blerje banese - rasti spanjoll" nga Gimeno dhe Martinez-Carrascal (2006). Modeli i vlerësuar është në formën e Metodës së Zakonshme të Katrorëve më të Vegjël (MZKV) dhe përfshin të dhëna tremujore për periudhën 2005-2011 siç paraqitet më poshtë:

$$\text{DLOG(ICB)} = 0.022 - 0.32*\text{DLOG(ICB(-2))} - 0.025*\text{D(KOST_BTH)} + 0.22*\text{DLOG(KREDI(-4))}$$

Probabiliteti (0.05) (0.04) (0.00) (0.00)

$$+ 0.05*\text{DLOG(INF)} - 0.073*\text{SEAS(1)} + 0.021*\text{D(INTERES(-2))}$$

Probabiliteti (0.07) (0.00) (0.04) R^2 i korrigjuar=0.79

Ku: IÇB-Indeksi i Çmimit të Banesave; KOST_BTH-kostoja e investimit alternativ në bono thesari e matur si diferenca midis normës së bonove të thesarit 12-mujore dhe normës së rritjes së Indeksit të Çmimit të Banesave; KREDI-teprica e kredisë për blerje pasurie të paluajtshme; INF-norma e inflacionit vjetor; SEAS-faktor sezonal për tremujorin e parë të vitit dhe INTERES-norma e interesit për kredinë për pasuri të paluajtshme.

Rezultatet sugjerojnë se rritja e kredisë për pasuri të paluajtshme ka ndikimin më të lartë në rritjen e çmimit të banesave, me një vonesë kohore prej një viti. Ndërkohë, rritja e normës së interesit për kredinë për pasuri të paluajtshme ndikon negativisht, por me një koeficient të ulët në rritjen e çmimit të banesave. Së fundi, vlerësohet se rritja e kostos në një investim alternativ të fondeve përmes blerjes së bonove të thesarit, ka një ndikim negativ por të ulët në ecurinë e çmimit të banesave. Ky zhvillim nënkupton se do të nevojitej një normë mjaft e lartë e kthimit nga një investim alternativ (i cili për momentin përfaqësohet vetëm nga bonot e thesarit për shkak të kufizimeve në investime në Shqipëri), që sjellja e individëve të mund të reflektohej në një ulje të çmimit të banesave në vend.

Me qëllim vlerësimin e ndikimit të drejtpërdrejtë të kredisë për huamarrje për pasuri të paluajtshme në çmimin e banesave, pas periudhës së krizës financiare botërore, ndërtojmë një analizë ndjeshmërie. Kjo analizë bazohet në ekuacionin e prezantuar më sipër dhe ndërton dy skenarë të mundshëm. Skenari i parë paraqet ecurinë e mundshme të Indeksit të Çmimit të Banesave në rast se zgjerimi i kredisë për pasuri të paluajtshme për periudhën 2008 (tremujori i tretë) - 2011 do të ishte i njëjtë me ritmin e periudhës para krizës (në fund të vitit 2007). Në skenarin e dytë, ecuria e rritjes vjetore të kredisë për pasuri të paluajtshme për të njëjtën periudhë supozohet sa gjysma e ritmit të rritjes para krizës, që gjithsesi mbetet më e lartë se ecuria aktuale e kësaj kredie.

Grafik 2.4. Ecuria e kredisë për pasuri të paluajtshme dhe çmimit të banesave sipas dy skenarëve.



Burimi: Llogaritje të Departamentit të Stabilitetit Financiar.

Rezultatet e ushtrimit sugjerojnë se në rast se kredia për pasuri të paluajtshme do të vazhdonte të zgjerohej me ritme të ngjashme me ato të periudhës së parakrizës, çmimet e banesave do të rriteshin me një ritëm më të shpejtë se ecuria aktuale e tyre. Rezultatet e vlerësimit të lidhjes pozitive midis ecurisë së kredisë dhe ecurisë së çmimit të banesave janë të pritshme.

Gjithsesi duhet theksuar se ka mjaft elementë të tjerë të cilët ndikojnë në ecurinë e këtyre treguesve. Kështu, pavarësisht se kredia për pasuri të paluajtshme është zgjeruar me ritme të shpejta, ajo është nisur nga një nivel bazë shumë i ulët. Në fund të vitit 2011, kredia për pasuri të paluajtshme përbën më pak se 10% të PBB-së në vend, ndërkohë që dhe niveli mesatar i kredisë për frymë ose për huamarrës vijon të mbetet më i ulët se në vende të ngjashme. Nga ana tjetër, rritja e vazhdueshme e çmimit të banesave, reflekton edhe një rritje të shpejtë të kërkesës në kushtet e zgjerimit të aktivitetit ekonomik, një mënyrë investimi të dërgesave të emigrantëve, përmirësim të cilësisë së banesave etj. Gjithsesi, ky ushtrim thekson rëndësinë e ndërlidhjes që ekziston midis tregut të banesave dhe financimit në formën e kredisë, monitorimi i të cilës është i nevojshëm në kushtet e ruajtjes së stabilitetit financiar në vend.

2.3 GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E INDIVIDËVE

2.3.1 VROJTIMI MBI SITUATËN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E INDIVIDËVE

- *SITUATA FINANCIARE*

Në periudhën nëntor-dhjetor 2011 u realizua vrojtimi i tretë mbi gjendjen financiare dhe të huamarrjes së familjeve në Shqipëri, duke patur si periudhë referimi gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011. Në këtë vrojtim u intervistuan 1,210 familje të shpërndara relativisht në 27 rrethe të ndryshme të vendit, ku rreth 55% e tyre jetojnë në zonat urbane dhe 45% në zonat rurale. Sipas rezultateve të vrojtimit, në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, burimet kryesore të të ardhurave janë: punësimi në sektorin privat, pensioni dhe vetëpunësimi,

përkatësisht për 27%, 30% dhe 24% të të anketuarve. Pesha e "emigracionit" si burim të ardhurash ka rënë, ndërsa është rritur pesha e të vetëpunësuarve në raport me totalin e të punësuarve.

- *HUAMARRJA*

Në totalin e familjeve të intervistuara, 26.8% (324 familje) pohojnë se kanë aktualisht një borxh për të paguar, një rritje me 2 pikë përqindje krahasuar me 6-mujorin e parë 2011. Burimi kryesor i marrjes së borxhit vijon të mbetet "personi fizik" në 54% të huamarrësve (52% hua në lekë dhe 2% hua në valutë); dhe "bankat" në 42% të huamarrësve (39% në lekë dhe 3% në valutë). Krahasuar me 6-mujorin e kaluar, pesha e huamarrjes nga personat fizikë ka rënë, ndërsa ajo nga bankat ka ardhur duke u rritur. Lidhur me stokun e deklaruar të borxhit (vlera e mbetur e papaguar), 54% e tij është borxh formal[13], i shpërndarë mes 144 familjeve huamarrëse; ndërsa 41% është borxh potencialisht informal[14] i shpërndarë mes 173 familjeve huamarrëse.

Qëllimet kryesore të marrjes së borxhit nga familjet vazhdojnë të mbeten blerja/riparimi i një prone të paluajtshme në 38% të rasteve, konsumi në 23% të rasteve dhe zhvillimi i biznesit në 10.8% të rasteve. Dy zërat e parë kanë shënuar rënie në 6-mujorin e dytë të vitit 2011 krahasuar me 6-mujorin e parë, madje pesha e borxhmarrësve për qëllime "konsumi" ka ardhur duke rënë gradualisht gjatë të tre 6-mujorëve, nga 29% e totalit në 6-mujorin e dytë të vitit 2010, në 24% në 6-mujorin e dytë 2011. Euroizimi i huamarrjes vazhdon të mbetet i ulët (94% e rasteve në lekë), kryesisht për shkak të huamarrjes nga persona fizikë. Koha e mbetur për shlyerjen e këtij stoku në momentin e intervistimit, është kryesisht afatmesme (prej 1-3 vjet) në 44% të rasteve dhe afatshkurtër (prej 12 muajsh) në 28% të rasteve.

Grafik 2.5. Burimi dhe qëllimi i marrjes së borxhit.



Burimi: Llogaritje të Departamentit të Stabilitetit Financiar.

[13] *Si borxh formal është konsideruar borxhi i marrë nga bankat dhe institucione financiare jobankare.*

[14] *Si borxh informal është kategorizuar borxhi i marrë nga persona fizikë.*

- *NGARKESA E BORXHIT PËR FAMILJET*

Në këtë vrojtim, 26% e familjeve huamarrëse deklarojnë përkeqësim të aftësisë së tyre paguese[15], kryesisht për shkak të rënies së të ardhurave familjare dhe rritjes së shpenzimeve. Për të përballuar vështirësitë financiare lidhur me shlyerjen e detyrimeve të borxhit, në 60% të rasteve, familjet ulin shpenzimet e tyre, në 20% të rasteve kërkojnë një punësim të dytë dhe në 15% të rasteve kërkojnë rinegocim të kushteve të borxhit. Për 6-mujorin e parë të vitit 2012, 78% e familjeve huamarrëse nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese, ndërsa 16% e tyre presin përkeqësim, krahasuar me 14% në vrojtimin e kaluar. Përsa i përket mundësisë së marrjes së një borxhi të ri në gjashtëmujorin e ardhshëm[16], për rreth 60% të familjeve që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje mundësia nuk ekziston.

2.3.2 POZICIONI FINANCIAR

Në dhjetor 2011, pozicioni financiar i individëve si kreditorë në sistemin financiar shënoi vlerën 615 miliardë lekë duke u zgjeruar me 96.73 miliardë lekë krahasuar me një vit më parë. Ky zhvillim reflekton rritjen e depozitave të individëve me 96.4 miliardë lekë ndërkohë që kredia është ngushtuar me 380 milionë lekë. Sipas valutës, individët janë kreditorë në sistemin financiar në masën 338.6 miliardë lekë në monedhën vendase dhe 276.8 miliardë lekëve në valutë. Pozicioni kreditor në valutë është zgjeruar më shumë se pozicioni kreditor në lekë, përkatësisht me 56 miliardë lekë kundrejt 39.8 miliardë lekë në valutë. Ky zhvillim reflekton njëkohësisht rritjen më të shpejtë të depozitave të individëve në valutë krahasuar me ato në lekë, si dhe uljen e kreditimit në valutë për individët.

Grafik 2.6. Pozicioni financiar i individëve ndaj sistemit financiar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[15] *69% e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se nuk kanë patur ndryshim të aftësisë paguese në 6-mujorin e kaluar duke iu referuar momentit të intervistimit, 26 % kanë deklaruar përkeqësim dhe rreth 5% kanë deklaruar përmirësim të aftësisë së tyre paguese.*

[16] *Kjo pyetje i është drejtuar të gjithë kampionit të familjeve, por vetëm 27% e tyre (ose 330 familje) janë përgjigjur.*

2.3.3 RREZIKU I KREDISË

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011, teprica e kredisë për individë[17] ka shfaqur ritme rritjeje pozitive. Pavarësisht se në dhjetor 2011, ajo shënoi një rritje të lehtë vjetore me 0.5%, mesatarja e normave të rritjes vjetore për gjashtëmujorin e dytë shënon vlerën 4.91% krahasuar me 3.79% në gjashtëmujorin e parë 2011. Gjatë kësaj periudhe, evidentohet një zgjerim i peshës së kredisë afatgjatë e cila përbën 79.7% të totalit të kredisë për individët kundrejt 14.2% të kredisë afatmesme dhe 6.2% të kredisë afatshkurtër. Një vit më parë, kredia afatgjatë përbënte 77.8% të totalit të kredisë për individë. Individët kanë ulur edhe peshën e huamarrjes në valutë e cila në dhjetor 2011 përbën 56.6% të totalit krahasuar me 58.2% një vit më parë.

Grafik 2.7. Ecuria e kredisë për individët.



Burimi: Banka e Shqipërisë.*
*Teprica e kredisë dhe kredia me probleme paraqiten në formën e rritjes vjetore ndërsa raporti i kredive me probleme prezantohet në përqindje.

Përmirësimi i ecurisë së kreditimit është reflektuar edhe në cilësinë e portofolit të kredisë për individët, e cila ka shënuar një përkeqësim më të ngadaltë se cilësia e portofolit për bizneset. Norma e kredisë me probleme shënoi 15.35% në dhjetor 2011 krahasuar me 13.91% në qershor 2011 dhe 12.74% në dhjetor 2010. Gjithsesi, ritmi i rritjes së këtij raporti me 2.62 pikë përqindje gjatë 12 muajve mbetet shqetësues pavarësisht se vetë stoku i kredive me probleme është zgjeruar me një ritëm më të ngadaltë se një vit më parë. Ndërkohë, ekspozimi i individëve ndaj rrezikut të kredisë për vitin 2012, vlerësohet të mbetet i pranishëm në vijim të një rritjeje ekonomike të ngadaltë, një norme të moderuar të zgjerimit të kredisë dhe shtimit të pasigurisë në lidhje me aktivitetin ekonomik.

2.3.4 RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT PËR SHKAK TË KURSIT TË KËMBIMIT

Në vijim të prirjes për ulje të ekspozimit të individëve ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit për shkak të kursit të këmbimit të nisur në fund të vitit 2009, raporti

[17] *Në llogaritjen e kredisë nuk përfshihen jorezidentët.*

i kredisë së pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit përbën 40.4% të totalit të kredisë për individët (dhjetor 2011). Një vit më parë ky raport shënonte vlerën 41.1%.

Grafik 2.8. Ekspozimi i individëve ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rreth 83.7% e kredisë së pambuluar nga rreziku i tërthortë i kredititi për shkak të kursit të këmbimit për individët përbëhet nga kredi për blerje banese. Mesatarja e këtij raporti gjatë vitit 2011 shënon vlerën 82.5% krahasuar me 85.2% në vitin 2010. Ulja e raportit gjatë vitit 2011 ka reflektuar zvogëlimin e kreditimit për blerje banese[18] më shumë se sa zvogëlimi i vetë kredisë së pambuluar nga ky rrezik. Gjithsesi, edhe pse kredia për blerje banese nga individët paraqitet në një masë të lartë e pambuluar nga rreziku i tërthortë i kredititi për shkak të kursit të këmbimit, mbështetja e saj me kolateral vlerësohet e lartë duke ofruar një mbrojte të mirë ndaj përkeqësimit të cilësisë së portofolit për këtë kategori të kredisë.

Ndikimi i rrezikut të tërthortë të kredititi për shkak të kursit të këmbimit ndaj të cilit ekspozohen individët është reflektuar në cilësinë e portofolit të tyre. Cilësia e këtij portofoli është përkeqësuar më shpejt se cilësia e portofolit të totalit të tepricës së kredisë. Në dhjetor 2011, kreditë e pambuluara nga rreziku i tërthortë i kredititi për shkak të kursit të këmbimit që kishin probleme shlyerjeje, u ngjitën në 17.7% të stokut të kësaj kategorie, kundrejt vlerës prej 16.1% për totalin e kredisë në valutë dhe 15.35% për totalin e kredisë së dhënë individëve. Cilësia e portofolit të kredisë për blerje banese shënon 17.5%, një përkeqësim me 6.2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

Gjatë vitit 2011 evidentohet një rritje e lehtë e ngarkesës me hua për blerje banese për konsumatorët. Në dhjetor 2011, vlera mesatare e kredisë së marrë në valutë për këtë qëllim arrin në 2.4 milionë lekë për kredimarrës, ndërkohë që një vit më parë shënonte vlerën 2.2 milionë lekë.

[18] *Kredi e marrë në valutë kur të ardhurat e individëve janë në lekë.*

Përkeqësimi i cilësisë së portofolit të huamarrjes në valutë reflekton ndikimin e rëndësishëm të lëvizjeve të kursit të këmbimit në aftësinë paguese të individëve sidomos në rastet kur i kanë të ardhurat në monedhën vendase. Pavarësisht se gjatë vitit 2011, nënçmimi në terma vjetorë i kursit të këmbimit lek/euro ka shënuar vlerën mesatare prej 2.2% krahasuar me 4.4% të një viti më parë, ndikimi i lëvizjeve të tij në gjendjen financiare të individëve debitorë vlerësohet të jetë i rëndësishëm.

Grafik 2.9. Cilësia e portofolit të kredisë për individët



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.3.5 RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT PËR SHKAK TË NORMËS SË INTERESIT

Në dhjetor të vitit 2011, ekspozimi i individëve ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit për shkak të normës së interesit është ulur. Raporti i kredisë me normë të ndryshueshme interesi ndaj totalit të tepricës së kredisë për individë shënoi vlerën 23.8% krahasuar me 27.4% një vit më parë. Ritmi i rritjes së kredisë me normë të ndryshueshme interesi është më i ngadaltë se rritja e tepricës së kredisë për individë, duke u reflektuar në uljen e ekspozimit të individëve ndaj këtij rreziku me një raport poshtë nivelit të mesatares afatgjatë. Nëse kjo pririje vijon, ulja e peshës së kredisë me normë interesi të ndryshueshme për individët, duke përjashtuar faktorët që lidhen me llojin e kredisë dhe strukturën e maturimit të saj, mund të reflektojë një pritshmëri të bankave për uljen e normës së interesit në të ardhmen e parashikueshme.

Grafik 2.10. Vlera mesatare e kredisë në valutë për individët.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 2.11. Ekspozimi i individëve ndaj rrezikut të tërthortë të normës së interesit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ulja e ekspozimit ndaj huamarrjes me normë të ndryshueshme interesi shoqëruar nga ulja e normave orientuese të kredisë gjatë vitit 2011[19], ka ndikuar pozitivisht në aftësinë paguese të individëve. Si rrjedhim, rreziku i tërthortë i normës së interesit për individët vlerësohet i moderuar. Në lidhje me zhvillimet e pritshme gjatë vitit 2012, vlerësohet se prirja në rënie e normave të interesit të bonove të thesarit do të mbështetet nga politika akomoduese monetare në vend, në kushtet e presioneve të kontrolluara inflacioniste. Nga ana tjetër, disa ndryshime strukturore që po ndodhin në kërkesën e agjentëve të tregut për blerjen e këtyre instrumenteve mund të nxisin luhatshmëri në ecurinë e normës së interesit, në afat të shkurtër. Në tregjet ndërkombëtare, veprimet lehtësuese të autoriteteve monetare kanë zbritur normat e interesit të euros dhe të dollarit amerikan në nivelet më të ulëta historike, dhe pritjet e pasigurta për ecurinë e rritjes ekonomike, sugjerojnë që këto nivele të ulëta të interesit do të vijojnë edhe për të ardhmen e parashikueshme.

2.4 GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E BIZNESEVE

Ngadalësimi i rritjes ekonomike është reflektuar në ecurinë e situatës financiare të bizneseve të cilët gjithsesi raportojnë një lehtësim gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011. Rreziqet e stabilitetit financiar që lidhen me aktivitetin e bizneseve paraqiten më të larta se në gjashtëmujorin e kaluar dhe kanë nevojë për monitorim. Përkeqësimi i shpejtë i cilësisë së portofolit të kredisë për biznese mbetet rreziku kryesor për aktivitetin e tyre dhe të sektorit bankar. Gjithashtu, bizneset kanë rritur ekspozimin edhe ndaj lëvizjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit dhe të normës së interesit nëpërmjet përfitimit të kredisë me kosto të luhatshme ndaj secilit prej këtyre faktorëve.

2.4.1 VROJTIMI MBI SITUATËN FINANCIARE DHE HUAMARRJA E BIZNESEVE

- *SITUATA FINANCIARE*

Për të vlerësuar ecurinë e situatës financiare dhe barrës së huamarrjes së bizneseve në Shqipëri, analizojmë rezultatet e vrojtimit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011.

Në këtë periudhë, 32.9% e bizneseve të intervistuara (234 biznese) pohojnë se kanë zgjeruar veprimtarinë apo rritur investimet e tyre gjatë 6 muajve të fundit, me një rritje prej 5.5 pikë përqindje krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2011. Përdorimi i monedhës së huaj ka rënë pasi veprimtaria e bizneseve është realizuar kryesisht në lekë për 90.3% të bizneseve, rreth 1.5 pikë përqindje më tepër se një gjashtëmujor më parë. Në terma mesatarë, gjatë gjashtëmujorit të dytë 2011 bizneset kanë deklaruar një fitim mesatar më të lartë krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2011.

[19] *Kryesisht të bonove të thesarit 12-mujore.*

- *HUAMARRJA*

Në totalin e bizneseve të përgjigjura, 49.9% e tyre (ose 43.4% e kampionit total) pohojnë që kanë aktualisht një hua për të paguar. Ky rezultat përbën një rënie me 2.5 pikë përqindje krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2011. Financimi i veprimtarisë së tyre është bërë nga shitjet për 31.7% të bizneseve që janë përgjigjur, ndërkohë që huamarrja si burim financimi më vete apo e kombinuar është përdorur nga 25.7% (183 biznese) e tyre, me një rënie prej 1.9 pikë përqindje nga gjashtëmujori i kaluar. Ndër sektorët e ekonomisë, shërbimet janë sektori me nivelin më të lartë të financimit nga shitjet me 54.1% të përgjigjeve, ndërkohë që sektori i ndërtimit mbetet me varësinë më të lartë nga financimi nëpërmjet huamarrjes në sektorin bankar me 8.3% të përgjigjeve, edhe pse prirja ka qenë rënëse në krahasim me periudhën paraardhëse.

Përgjithësisht, bizneset kanë marrë hua afatshkurtër për 60.8% të të anketuarve, dhe afatmesme për 29.2% të të anketuarve, ndërkohë që huamarrja afatgjatë përbën 10% të përgjigjeve. Qëllimi i përdorimit të huasë është përballimi i shpenzimeve korrente për 38% të bizneseve huamarrëse të përgjigjura, duke u rritur me 7 pikë përqindje në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Përdorimi i huasë për kryerjen e një investimi afatgjatë është shfaqur në 35.7% të të anketuarve, duke mbetur në nivele pothuaj të njëjta me periudhën paraardhëse.

Huaja mesatare e mbetur për t'u paguar në monedhën vendase ka shënuar rënie, duke rritur ekspozimin e bizneseve ndaj lëvizjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit. Si rrjedhim, euroizimi i huasë për të gjithë sektorët është rritur krahasuar me dy gjashtëmujorët paraardhës. Ndërkohë, 74.4% e bizneseve vlerësojnë se kanë vendosur kolateral në formën e pasurisë së paluajtshme, ndërsa huamarrja pa kolateral ka rënë me 1.4 pikë përqindje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar.

Grafik 2.12. Shpërndarja e bizneseve sipas qëllimit të përdorimit të huasë.



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

- *NGARKESA E BORXHIT PËR BIZNESET*

Vlera e përgjithshme e huasë përbën rreth 50% të kapitalit për 73.5% të bizneseve të përgjigjura ose 6.3 pikë përqindje më shumë se në gjashtëmujorin e kaluar. Ndërkohë, shpenzimi mujor për pagesën e huasë përbën mesatarisht 24.6% të të ardhurave. Rreth 70% e bizneseve pohojnë se shpenzimi për pagesën e huasë është rritur gjatë 6 muajve të fundit, kryesisht për shkak të lëvizjeve në normën e interesit dhe të rënies së të ardhurave të veprimtarisë. Në lidhje me pritshmëritë për të ardhmen, 66.3% e bizneseve vlerësojnë se nuk parashikojnë të marrin kredi gjatë gjashtëmujorit të ardhshëm.

2.4.2 POZICIONI FINANCIAR

Në lidhje me ndikimin e aktivitetit të bizneseve në sistemin financiar, analizojmë treguesin e pozicionit financiar të tyre dhe ekspozimin ndaj rreziqeve të kreditit, kursit të këmbimit dhe normës së interesit.

Në dhjetor 2011, pozicioni financiar i bizneseve si debitorë në sistemin financiar shënoi vlerën 281 miliardë lekë, duke u zgjeruar me 53.4 miliardë lekë krahasuar me një vit më parë. Ky zhvillim reflekton rritjen e lartë të kredisë për biznese me 51.6 miliardë lekë ndërkohë që depozitat e bizneseve janë tkurrur me 1.8 miliardë lekë. Sipas valutës, bizneset janë debitorë në sistemin financiar në masën 76.4 miliardë lekë në monedhën vendase dhe 204.7 miliardë lekë në valutë. Pozicioni debitor në valutë është zgjeruar më shumë se pozicioni debitor në lekë, përkatësisht me 29.45 miliardë lekë dhe 23.93 miliardë lekë. Ky zhvillim reflekton njëkohësisht zvogëlimin e depozitave të bizneseve në valutë krahasuar me një vit më parë, si dhe rritjen më të lartë të kreditimit në valutë kundrejt atij në monedhën vendase.

Grafik 2.13. Pozicioni financiar i bizneseve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.4.3 RREZIKU I KREDITIT

Zgjerimi i kredisë për bizneset në dhjetor 2011 shënoi vlerën 22.8%[20] në terma vjetorë. Kredia për biznesin e madh është zgjeruar ndjeshëm duke përbërë 60.3% të totalit të kredisë, ndërkohë që biznesi i vogël dhe i mesëm përbëjnë përkatësisht 19.9% dhe 19.8%. Biznesi i madh ka rritur peshën e kredimarrjes afatgjatë (30% të totalit) edhe pse kredia afatshkurtër vijon të përbëjë 51.7% të totalit të kredisë. Ndërkohë biznesi i vogël dhe i mesëm kanë huazuar kryesisht në kredi afatgjatë, përkatësisht 47% të totalit për biznesin e vogël dhe 40.8% për biznesin e mesëm.

[20] *Në llogaritjen e zgjerimit të kredisë nuk përfshihen jorezidentët.*

Pavarësisht zhvillimeve pozitive të kredisë, cilësia e totalit të portofolit të kredisë për bizneset ka vijuar të përkeqësohet. Norma e kredisë me probleme të bizneseve ndaj tepricës së kredisë shënoi vlerën 20% në dhjetor 2011 krahasuar me 18.5% në qershor 2011 dhe 14.6% në dhjetor 2010. Ritmi i rritjes së këtij raporti me 5.4 pikë përqindje gjatë 12 muajve mbetet shqetësues në kushtet kur stoku i kredive me probleme është zgjeruar me një ritëm më të shpejtë se një vit më parë (68.2% rritje vjetore gjatë vitit 2011) ndërsa teprica e kredisë është zgjeruar më ngadalë.

Grafik 2.12. Ecuria e kredisë dhe cilësisë së portofolit të kredisë për bizneset.



Burimi: Banka e Shqipërisë*
*Teprica e kredisë dhe kredia me probleme paraqiten në formën e rritjes vjetore ndërsa raporti i kredive me probleme prezantohet në përqindje.

Duke krahasuar në total ecurinë e cilësisë së kredisë për bizneset në krahasim me atë për individët, vihet re se përkeqësimi i cilësisë së portofolit të kredisë së bizneseve është më i shpejtë dhe ritmi i rritjes së tij vijon të jetë i lartë. Prirja e bankave për të zgjeruar portofolin e kredisë për bizneset më shumë se për individët, mund të reflektojë nevojën e tyre për kreditim për qëllime ristrukturimi.

2.4.4 RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT PËR SHKAK TË KURSIT TË KËMBIMIT

Pavarësisht se në dhjetor të vitit 2011, huamarrja e bizneseve në valutë përbën 70.4% të totalit krahasuar me 73.7% të një viti më parë, ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit është rritur. Në këtë periudhë, raporti i kredisë së pambuluar nga rreziku i tërthortë i kreditit për shkak të kursit të këmbimit ndaj tepricës së kredisë për bizneset shënon vlerën 37.2%, rreth 4.2 pikë përqindje më shumë se një vit më parë. Rritja e raportit reflekton zgjerimin e kredisë së pambuluar nga rreziku i këmbimit me 39% në terma vjetorë, ndërkohë që teprica e kredisë është zgjeruar me vetëm 22.8%. Pavarësisht se nënçmimi i kursit të këmbimit lek/euro gjatë vitit 2011 ka qenë më i zbutur se një vit më parë, prirja në rritje e bizneseve për huamarrje në valutë të pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit mbetet shqetësuese.

Grafik 2.15. Ekspozimi i bizneseve ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Referuar të njëjtës periudhë, 43% e kredisë së pambuluar nga rreziku i tërthortë i kreditit për shkak të kursit të këmbimit për bizneset përbëhet nga kredia për tregti, duke u zvogëluar me 4 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Gjithsesi, mesatarja e këtij raporti gjatë vitit 2011 qëndron në vlera të përafërta me vitin 2010 (rreth 46%). Kredia për zhvillim biznesi e pambuluar nga rreziku i tërthortë i kreditit për shkak të kursit të këmbimit përbën 27.7% të totalit dhe rreth 4.2 pikë përqindje më pak se një vit më parë. Ndërkohë, ekspozimi ndaj lëvizjeve të kursit të këmbimit është rritur për kredinë e bizneseve për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, e cila përbën 10.4% të totalit krahasuar me 7.5% që shënonte një vit më parë.

Grafik 2.14. Cilësia e portofolit të kredisë për bizneset.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pavarësisht se ekspozimi i bizneseve ndaj kredisë së pambuluar nga rreziku i tërthortë i kreditit për shkak të kursit të këmbimit vlerësohet në rritje, përkeqësimi i cilësisë së këtij portofoli në gjysmën e dytë të vitit 2011 ka qenë më i ngadaltë se në pjesën e parë të vitit. Kështu, në dhjetor 2011, raporti i kredive me probleme në valutë për kredinë e pambuluar nga rreziku i tërthortë i kreditit për shkak të kursit të këmbimit shënoi vlerën 19.4%, kundrejt 20.74% për kredinë në valutë dhe 20.04% për totalin e kredisë së bizneseve. Të gjitha kategoritë e kredisë së bizneseve në valutë kanë shfaqur përkeqësim të cilësisë së tyre.

Me konkretisht, portofoli i kredisë në valutë për qëllime tregtie ka një raport të kredive me probleme prej 15%, ndërsa për kredinë për qëllim biznesi raporti shënon vlerën 27%. Një vit më parë, këto raporte qëndronin në vlerat përkatëse prej 9% dhe 20%. Krahasuar me individët ku në totalin e kredisë në valutë, cilësia e portofolit paraqitet më e kënaqshme për kredinë për blerje banese, situata paraqitet ndryshe për bizneset. Raporti i kredive me probleme shënon vlerën 37% për kredinë për pasuri të paluajtshme krahasuar me 10% një vit më parë. Ky zhvillim reflekton rritjen e stokut të kredisë me probleme për pasuri të paluajtshme me 383% ndërkohë që teprica e kredisë për këtë qëllim është zgjeruar me 32.5% në terma vjetorë. Rritja e lartë e stokut të kredive me probleme për pasuri të paluajtshme pasqyron zhvillimet negative në sektorin e ndërtimit, pasi bizneset e përdorin këtë kredi për zhvillimin e pasurive të paluajtshme.

Grafik 2.15. Vlera mesatare e kredisë në valutë për bizneset.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përkeqësimi i cilësisë së portofolit në valutë është reflektuar në uljen e vlerës mesatare të kësaj kredie për bizneset. Në dhjetor 2011, vlera mesatare e kredisë për zhvillimin e pasurive të paluajtshme shënon 9.56 milionë lekë kundrejt 22 milionë lekëve që shënonte vitin e kaluar[21]. Tendencë në rënie vlerësohet edhe për kredinë për qëllime tregtie, ndërkohë kredia për zhvillim biznesi ka reflektuar rritje me një vlerë mesatare kredie prej 5.6 milionë lekë kundrejt 3.6 milionë lekë që shënonte një vit më parë.

2.4.5 RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT PËR SHKAK TË NORMËS SË INTERESIT

Në dhjetor të vitit 2011, ekspozimi i bizneseve ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit për shkak të normës së interesit është rritur. Raporti i kredisë me normë të ndryshueshme interesi ndaj totalit të tepricës së kredisë shënoi vlerën 63.5% krahasuar me 61.2% të një viti më parë. Duke filluar nga tremujori i fundit i vitit 2010, ky raport ka qëndruar mbi mesataren afatgjatë të tij.

Pavarësisht se kreditimi për bizneset është zgjeruar me një ritëm më të shpejtë se ai për individët, ulja e normave të interesit nuk ka ecur në të njëjtën linjë. Gjatë vitit 2011, norma mesatare e interesit për biznese në lekë është ulur me 0.7 pikë përqindje, kundrejt uljes me 1.14 pikë përqindje për individët. Për kredinë në euro, norma mesatare e interesit për bizneset është ulur me 0.11 pikë përqindje kundrejt uljes me 0.14 pikë përqindje të individëve. Këto zhvillime tregojnë se pavarësisht se bankat kanë kredituar bizneset më shumë se individët, çmimi i kredisë për biznese është zvogëluar më ngadalë. Rritja e peshës së kredisë me normë të ndryshueshme interesi, sjell përfitime për

[21] *Në dhjetor 2011, kredia për pasuri të paluajtshme e bizneseve është rritur me 32.5%, ndërkohë që numri i kredimarrësve është dyfishuar.*

bizneset në afat të shkurtër, për sa kohë normat e interesit janë të ulëta ose në rënie. Megjithatë, në afat më të gjatë, pozicioni debitor i bizneseve sjell rritjen e ekspozimit të tyre ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit për shkak të luhatjeve të pafavorshme në normën e interesit.

2.18. Ekspozimi i bizneseve ndaj rrezikut të tërthortë të normës së interesit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

III. TREGJET FINANCIARE

Tregu financiar shqiptar dominohet nga veprimet e tregut ndërbankar, të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë dhe të këmbimeve valutore.

3.1 TREGU NDËRBANKAR

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011, vëllimi i transaksioneve në tregun ndërbankar është rritur me 28.4% krahasuar me gjashtëmujorin e parë, ndërkohë që mesatarja e ponderuar e interesit ka qëndruar në vlerën 5.12%, pranë nivelit prej 5.07% të gjashtëmujorit të parë 2011. Krahasuar me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2010, vëllimi i tregut ndërbankar ka rënë me 0.7% ndërsa norma mesatare e interesit është rritur me 0.14 pikë përqindje.

Grafik 3.1. Vëllimi dhe normat e interesit në tregun ndërbankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.2 TREGU PRIMAR I TITUJVE

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2011, vëllimi i tregut primar të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë është zvogëluar me 14.7% kundrejt gjashtëmujorit të parë, duke shënuar vlerën 185.6 miliardë lekë. Kjo prirje ka reflektuar uljen e kerkesës për huamarrje nga ana e Qeverisë, në gjysmën e dytë të vitit. Përbërja e borxhit të emetuar në tregun primar është 85.3% bono thesari dhe 14.7% obligacione.

Norma mesatare e interesit të borxhit të emetuar në letra me vlerë gjatë këtij gjashtëmujori ka rezultuar 7.23%. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2011, kjo normë është rritur me 0.05 pikë përqindje ndërsa kundrejt gjashtëmujorit të dytë të vitit 2010 është ulur me 0.01 pikë përqindje.

Grafik 3.2. Ecuria e normës mesatare të interesit të borxhit të emetuar në letra me vlerë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3.3. Vëllimi dhe normat e kthimit të bonove në tregun primar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3.4. Ecuria e ankandeve të obligacioneve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3.5. Kurba e normave të kthimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në të njëjtën periudhë, vëllimi i bonove të thesarit të emetuara ka rënë në nivelin e 158.4 miliardë lekëve nga 182.8 miliardë lekë në gjashtëmujorin e parë. Vlera e bonove të thesarit e emetuar është zvogëluar me 13.4% në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit 2011 dhe ishte 16.1% më e ulët se në gjysmën e dytë të vitit 2010. Përsa i përket përbërjes së bonove të thesarit të emetuara, bonot e thesarit 12-mujore dhe 6-mujore përbëjnë përkatësisht 54.4% dhe 28.0 % të totalit, ndërsa bonot 3-mujore zënë përkatësisht 17.6%. Kostoja mesatare e borxhit të emetuar në formën e bonove të thesarit ka ardhur në rënie gjatë dy viteve të fundit. Norma mesatare e interesit të bonove të thesarit ka pësuar një rënie të lehtë me 0.03 pikë përqindje kundrejt gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 dhe 0.08 pikë përqindje kundrejt gjashtëmujorit të dytë të vitit 2010.

Tregu primar i obligacioneve ka pësuar gjithashtu rënie duke shënuar vlerën e 27.2 miliardë lekëve në gjysmën e dytë të vitit 2011. E shprehur në terma të rritjes, volumi i obligacioneve të tregtuara në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011 është 21.7% më i ulët se në gjysmën e parë të vitit 2011 dhe 3.6% më i ulët se në gjysmën e dytë të vitit 2010. Struktura e obligacioneve përbëhet kryesisht nga obligacionet 2-vjeçare të cilat zënë 63.4% të totalit, obligacionet 3-vjeçare me 6.4% të totalit si dhe obligacionet 5-vjeçare me interes të ndryshueshëm të cilat zënë 30.2% të totalit të tregut primar të obligacioneve për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011. Krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2011, pesha e obligacioneve 5-vjeçare me interes të ndryshueshëm është rritur, ndërsa pesha e obligacioneve 3-vjeçare ka rënë. Norma mesatare e interesit të obligacioneve është rritur me 0.61 pikë përqindje kundrejt gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 dhe me 0.22 pikë përqindje kundrejt gjashtëmujorit të dytë të vitit 2010.

Në grafikun 3.5 jepen normat e interesit gjatë tre gjashtëmujorëve të fundit sipas strukturës së maturimit të letrave me vlerë.

3.3 TREGU SEKONDAR I TITUJVE

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011 vihet re një rritje e vëllimit në tregun sekondar të letrave me vlerë me 20.8% kundrejt gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 dhe një rënie me 2.5% kundrejt gjashtëmujorit të dytë të vitit 2010. Peshën më të madhe në stokun e letrave me vlerë të tregtuara në tregun sekondar e zënë bonot e thesarit 12-mujore të cilat zënë 96.2% të totalit.

Grafik 3.6. Vëllimi i tregtimit të bonove në tregun sekondar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.4 TREGU I KËMBIMEVE VALUTORE

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, ecuria e lekut ka reflektuar përgjithësisht zhvillimet në tregjet ndërkombëtare të këmbimit valutor. Gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2011, leku është mbiçmuar ndaj monedhës euro duke reflektuar përveç efektit sezonal të fundvitit, edhe paqëndrueshmërinë e euros në tregjet ndërkombëtare për shkak të vështirësive të Eurozonës. Në dhjetor 2011, monedha vendase është mbiçmuar me 0.4% ndaj euros, ndërkohë që mesatarisht për vitin 2011 leku është nënçmuar me 2.2% në terma vjetorë ndaj euros. Leku ka reflektuar një ecuri të kundërt në lidhje me dollarin amerikan. Në muajin dhjetor 2011, monedha vendase është nënçmuar me 0.1% ndaj dollarit amerikan, ndërsa mesatarja për vitin 2011 shënon një mbiçmim me 2.8%.

Treguesit e kursit nominal efektiv (NEER) dhe ai i kursit real efektiv (REER) të lekut, të ndërtuar mbështetur në peshat e tregtisë me Greqinë, Italinë, Turqinë, Kinën dhe Gjermaninë, janë luhatur lehtë duke reflektuar ndryshimet në raportin kërkesë/ofertë të tregut vendas dhe efektin sezonal sidomos në fundin e vitit.

Grafik 3.7. Ecuria e kursit të këmbimit për tre monedhat kryesore.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3.8. Treguesit e kursit nominal efektiv (NEER) dhe të kursit real efektiv (REER).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.5 NDRYSHIMI MIDIS NORMAVE TË INTERESIT TË KREDIVE DHE DEPOZITAVE TË REJA

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011, diferenca midis normës mesatare të kredive dhe normës mesatare të depozitave, është ngushtuar për të tre monedhat kryesore, përkatësisht me 0.8 pikë

Grafik 3.9. Ecuria e ndryshimit të normave të kredivë dhe depozitave me afat, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

përqindje për veprimet në lekë, 2.7 pikë përqindje për veprimet në dollarë amerikanë dhe 0.24 pikë përqindje për veprimet në euro. Shkak kryesor për këtë ndryshim është ulja e normave të interesit për kreditë në të tre monedhat e lartpërmendura.

IV. ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE GJATË GJASHTËMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2011[23]

4.1 ECURIA DHE EFICIENCA E SISTEMEVE TË PAGESAVE

Gjatë vitit 2011, dy sistemet e pagesave, të cilat operohen nga Banka e Shqipërisë, AIPS[23] dhe AECH[24], kanë reflektuar ecuri të qëndrueshme. Ato kanë operuar pa devijime të rëndësishme nga oraret e parashikuara për shlyerje dhe klerim, si rrjedhojë e mungesës së situatave të jashtëzakonshme, duke reflektuar kështu qëndrueshmëri të infrastrukturës bazë të pagesave kombëtare në lekë.

Tabelë 4.1. Numri dhe vlera totale e pagesave të procesuara në sistemet AIPS/AECH.

	Janar-Dhjetor '10		Janar-Dhjetor '11	
Sistemi	AIPS	AECH	AIPS	AECH
Numri i transaksioneve	80,356	332,777	75,269	388,208
Vlera e transaksioneve (milionë lekë)	4,436,661.54	43,976.43	4,085,059.24	64,097.88
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	55.21	0.13	54.28	0.17

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për vitin 2011, në krahasim me vitin 2010 vihet re rritja e numrit dhe e vlerës së transaksioneve në sistemin AECH, ndërsa ka një rënie të tyre në sistemin AIPS. Prirja rritëse e numrit dhe e vlerës së transaksioneve të kleruara në sistemin AECH reflekton në një masë të konsiderueshme masat e marra nga ana e Bankës së Shqipërisë për zgjerimin e funksionimit të këtij sistemi[25] në muajin mars 2011. Nga ana tjetër, pakësimi me 7.92% i vlerës së transaksioneve të shlyera në sistemin AIPS është shkaktuar nga rënia e pothuaj të gjitha llojeve të transaksioneve të procesuara dhe të shlyera në këtë sistem, ku kontributin kryesor vlerësohet ta ketë dhënë zëri "instrumente financiare të BSH-së". Rritja e kufirit të vlerës së klerimit të transaksioneve në sistemin AECH, si dhe përdorimi më i ulët i instrumenteve financiare të Bankës së Shqipërisë janë arsyet kryesore për rënien e transaksioneve në sistemin AIPS.

[22] *Ky material është bazuar në të dhënat e përpunuara dhe në materialet e përgatitura nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Banka e Shqipërisë.*

[23] *AIPS - Sistemi i shlyerjes së pagesave ndërbankare me vlerë të madhe.*

[24] *AECH - Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël.*

[25] *Përsa i përket sistemit AECH, këto masa konsistojnë në: rritjen e kufirit të vlerës së transaksioneve të procesuara dhe kleruara në sistemin AECH nga 1 në 1.5 milionë lekë, shtimin e një seance klerimi duke e çuar në 3 numrin total të seancave të klerimit të shoqëruara me masa të orientuara drejt reduktimit të kostove në muajin mars të vitit 2011.*

4.2 ZHVILLIMET NË INSTRUMENTET E PAGESAVE

Për fundin e vitit 2011, statistikat e përftuara nga raportimet e bankave tregojnë një rritje të pagesave të klientëve si në numër ashtu edhe në vlerë. Pagesat në monedhën kombëtare zënë një peshë prej 86% në vëllim dhe 53.3% në vlerë, kundrejt totalit të pagesave të klientëve. Gjithashtu, vihet re se transfertat e kreditimit vazhdojnë të dominojnë (rreth 79%), ndërsa pagesat me karta dhe debitimet direkte (brenda për brenda të njëjtës bankë) zënë një peshë prej 10% ndaj totalit të pagesave. Transfertat e kreditit në formë letër kanë një peshë prej 97% në vëllim dhe në vlerë, ndërkohë që pagesat në formë elektronike mbeten edhe për këtë periudhë në nivele të ulëta, në rreth 2.94% ndaj totalit.

Ecuria e kartave në qarkullim për vitin 2011 ka qenë në rritje krahasuar me vitin e kaluar megjithatë vihet re një rënie e ritmit të rritjes në 5.3% nga 23% që ishte vitin e kaluar. Rritja e numrit të kartave ka qenë më e lartë për kartat e kreditit (38%) se për kartat e debitit (4%), megjithatë kartat e debitit përbëjnë 95% të totalit të kartave të emetuara.

Përsa i përket infrastrukturës së ofruar nga bankat e licencuara si emetuese kartash si dhe ato të licencuara si pranuese kartash, vihet re se numri i terminaleve ATM dhe POS në fund të vitit 2011 është rritur përkatësisht me 4.4% dhe 4.5% krahasuar me fundin e vitit 2010. Në kontekst rajonal, pavarësisht ritmeve të përshpejtuara të rritjes së terminaleve ATM dhe POS në Shqipëri, kjo infrastrukturë paraqitet ndjeshëm më e kufizuar se në shumicën e vendeve të rajonit.

Kohët e fundit, edhe në Shqipëri po merr shtrirje gjithnjë e më të madhe përdorimi i instrumenteve të pagesave elektronike dhe në veçanti shërbimi *home banking*. Deri në fund të vitit 2011, 11 banka ofrojnë shërbime *home banking*, në formën e produkteve të cilat mundësojnë përdorimin e llogarisë bankare në distancë.

Pasqyrimi i ecurisë së vlerës dhe të numrit të transaksioneve *home banking* për periudhën 2005-2011 tregojnë për një rritje më të përshpejtuar të numrit të transaksioneve krahasuar me vlerën. Zhvillimi i lartpërmendur mund të reflektojë një shtrirje të përdorimit të këtij instrumenti në një gamë më të gjerë përdoruesish.

V. ZHVILLIME TË SISTEMIT FINANCIAR

Pavarësisht ngadalësimit të rritjes ekonomike në vend, zhvillimet financiare gjatë vitit 2011 janë përgjithësisht pozitive. Sektori bankar paraqitet i mirëkapitalizuar dhe likuid. Institucionet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit dhe shoqëritë e sigurimit kanë zgjeruar më tej aktivitetin e tyre. Tregu i pensioneve private vullnetare paraqet rritje të të ardhurave dhe kontributeve. Rreziku i kreditit vijon të mbetet rreziku kryesor për institucionet që kryejnë aktivitet kreditues në vend, duke ndikuar edhe në rënien e rezultatit financiar.

Niveli i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, i vlerësuar si raport i aktiveve të sistemit financiar[26] ndaj PBB-së llogaritet 89.4% në gjysmën e dytë të vitit 2011, nga 86.9% në gjysmën e parë të vitit dhe 85.9% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vëllimi i aktiveve të institucioneve financiare u rrit me rreth 12.5% krahasuar me një vit më parë.

Sektori bankar vijon të mbetet segmenti kryesor i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, aktivet e të cilit përfaqësojnë rreth 94.7% të totalit të aktiveve të sistemit financiar dhe rreth 84.7% të PBB-së.

Grafik 5.1. Ndryshimi vjetor i aktiveve të segmenteve individuale të sistemit financiar, në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 5.1. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në përqindje).

Autoriteti licencues dhe mbikëqyrës	Sistemi financiar	Vitet					
		2006	2007	2008	2009	2010	2011
Banka e Shqipërisë	Sektori bankar	69.6	75.9	76.7	77.5	80.9	84.7
	Institucione jobanka	1.52	1.48	1.66	2.2	2.7	2.6
	SHKK-të dhe Unionet e tyre	0.52	0.63	0.7	0.77	0.78	0.74
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Shoqëri sigurimi	1.29	1.36	1.45	1.5	1.4	1.4
	Fondet e pensionit	-	-	-	0.01	0.01	0.01

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Sektori financiar jobankar, vijon të pasqyrojë peshë totale relativisht të vogël ndaj tërësisë së sistemit financiar. Kështu, totali i aktiveve të sektorit financiar jobankar[27] përfaqëson rreth 5.3% të sistemit financiar, peshë në rënie me

[26] *Sistemi financiar përbëhet nga bankat,institucionet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit, shoqëritë e sigurimit si dhe fondet e pensionit private suplementare.*

[27] *Baza e të dhënave për institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit i përket tremujorit të fundit të vitit 2011, ndërsa të dhënat për shoqëritë e sigurimit dhe për fondet e pensionit i përkasin tremujorit të tretë të vitit 2011. Informacioni për totalin e aktiveve të fondeve të pensionit është marrë nga publikimi më i fundit i AMF, dhjetor 2011.*

fundin e vitit 2010, prej 5.7%. Aktiviteti i sektorit jobankar përfaqëson rreth 4.7% të PBB-së së vendit, nga 4.9% që llogaritej në fund të vitit 2010.

Grafik 5.2. Pesha e subjekteve të sistemit financiar në totalin e aktivit.



Burimi:Banka e Shqipërisë, AMF.

HAPËSIRË INFORMUESE 5. SEKTORI FINANCIAR JOBANKAR.

- *Aktiviteti i institucioneve financiare jobanka*

Institucionet financiare jobanka licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë. Në tremujorin e katërt[i] të vitit 2011, aktivet e institucioneve financiare jobanka rezultuan 34.4 miliardë lekë, rreth 1.6 miliardë lekë (ose 4.8%) më shumë se në gjysmën e parë të vitit, dhe rreth 924 milionë lekë (ose 2.77%) më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Peshën kryesore në aktivitetin e jobankave e zë aktiviteti kreditues me një peshë prej 58.3% të totalit të aktiveve.

Grafik 5.3. Ecuria e aktiveve dhe portofolit të kredisë për institucionet financiare jobanka.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Niveli i kapitalizimit, i matur si raport i llogarisë së kapitalit me totalin e aktiveve, në tremujorin e fundit të vitit 2011 u ngjit në 36.5%, shumë pranë nivelit të llogaritur në qershor 2011 dhe mbi normën e të njëjtës periudhë të një viti më parë e llogaritur

në nivelin 33.7%. Cilësia e portofolit të kredisë për institucionet financiare jobanka ka vijuar rënien referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë, megjithatë në përmirësim krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2011. Në këtë mënyrë, raporti hua me probleme ndaj totalit të kredisë për institucionet jobanka arriti në 7.6% në dhjetor 2011, nga 8.1% në qershor 2011 dhe 5.9% në fund të vitit 2010. Njëkohësisht, ky tregues është rritur ndjeshëm mbi mesataren historike[ii] të tij prej 4.6%.

Grafik 5.4. Ecuria e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe raportit të huave me probleme, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Institucionet financiare jobanka kanë shënuar rritje të rezultatit financiar në tremujorin e katërt të vitit 2011, ku fitimi neto rezultoi rreth 1.1 miliardë lekë, nga rreth 978.9 milionë lekë referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Për sa i përket nivelit të të ardhurave për të njëjtën periudhë, ato rezultuan 7.1 miliardë lekë, nga 6.7 miliardë lekë që shënonin një vit më parë. Kontributin kryesor në rritjen e tyre e dhanë kryesisht të ardhurat nga komisionet, të cilat u ngjitën në nivelin 1.2 miliardë lekë nga 790.3 milionë lekë në fund të vitit 2010.

- *Aktiviteti i shoqërive të kursim-kreditit (SHKK-të)*

Veprimtaria e shoqërive të kursim-kreditit në tremujorin e katërt të vitit 2011, paraqet zhvillime pozitive për sa i përket rritjes së aktiveve dhe portofolit të kredisë krahasuar me një vit më parë. Njëkohësisht, ato kanë rezultuar me një rezultat financiar pozitiv dhe pse më të ulët se një vit më parë dhe me përmirësim të cilësisë së portofolit të kredisë.

Tabelë 5.1. Ecuria e disa treguesve të aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre.

	TI-10	TII-10	TIII-10	TIV-10	TI-11	TII-11	TIII-11	TIV-11
Totali i aktiveve (mln lek)	8,825	9,378	9,581	9,705	9,605	9,649.57	9,602.84	9,808.68
Teprica e kredisë (mln lek)	7,003	7,125	7,124	7,072	7,026	6,946.58	6,909.23	7,118.68
Teprica e kredisë/totalit të aktiveve (%)	79.4	75.9	74.4	72.8	73.2	71.99	71.95	72.58
Kredi me probleme (mln lek)	198.8	237.1	262.6	357.9	270.2	315.11	392.10	315.65
Kredi me probleme/tepricës së kredisë (%)	2.84	3.3	3.69	5.06	3.85	4.54	5.68	4.40

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Aktiviteti i shoqërive të kursim-kreditit bashkë me unionet e tyre ka rezultuar me fitim gjatë vitit 2011 në nivelin 82.6 milionë lekë, nga 232.2 milionë lekë që llogaritej rezultati financiar i një viti më parë.

- *Aktiviteti i shoqërive të sigurimit dhe shoqërive të pensioneve private suplementare*

Tregu i sigurimeve[iii] gjatë vitit 2011 është zgjeruar gradualisht në termat e aktiveve, të ardhurave nga primet, shtimit të kontratave të reja si dhe ruajtjes së një niveli të kënaqshëm kapitalizimi, megjithatë me një nivel përfitueshmërie më të ulët krahasuar me vitin 2010, çka ka bërë që shoqëritë të paguajnë më pak dëme. Ky treg vijon të mbetet i orientuar tek sigurimet e jojetës.

Në vitin 2011, të ardhurat nga primet e sigurimit, arritën në rreth 8,356 milionë lekë ose 1.8% më shumë se vitin e kaluar. Pagesat e dëmeve gjatë vitit 2011 u ulën me 4.3% krahasuar me vitin 2010, ku peshën kryesore prej 78.1% e zënë pagesat e dëmeve për sigurimet motorike. Si rezultat, raporti dëme/ prime, i cili mat dhe depërtimin e tregut të sigurimeve në sistemin financiar, në nivel kombëtar llogaritet 26%, nga 28% vitin e kaluar. Nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, sigurimi vullnetar zë 55.3%, ndërsa ai i detyrueshëm zë 44.7% të totalit të tregut.

Aktivet e sektorit të sigurimeve për tremujorin e tretë të vitit 2011[iv], rezultuan rreth 18.2 miliardë lekë, në rritje të lehtë prej 207 milionë lekësh (ose 1.1%) referuar fundit të vitit 2010, dhe me rreth 1.5 miliardë lekë (ose 9.4%) krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Peshën kryesore në totalin e aktiveve të shoqërive të sigurimit e përbën zëri "depozita, certifikata depozitash dhe llogari në banka" me rreth 46.7%.

Grafik 5.5. Pesha e zërave të aktiveve të shoqërive të sigurimit.

Peshat e zërave të aktiveve të shoqërive të sigurimit ndaj totalit të aktiveve në % TIII-2011



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesi matës i aftësisë për të përballuar humbjet si rezultat i ekspozimit ndaj rreziqeve të mundshme, është raporti "kapital/rezerva teknike", i cili për tremujorin e tretë të vitit 2011 rezultoi afërsisht 158.4% nga 168.7% në fund të vitit 2010, megjithatë më lart se e njëjta periudhë e një viti më parë që llogaritej 140.4%. Tendenca në rritje e këtij treguesi sinjalizon përvetësim më të lartë të humbjeve, që mund të vijnë nga aktiviteti i sigurimit.

Fitimi i shoqërive të sigurimit për tremujorin e tretë të vitit 2011 rezultoi 540.4 milionë lekë, nga 843 milionë lekë për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ngadalësimi i rezultatit financiar është reflektuar edhe në dy treguesit e kthimit RoA dhe RoE, të cilët për tremujorin e tretë të vitit 2011 janë llogaritur përkatësisht 3.1% dhe 5.6%, nga 5% dhe 9.7% referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë.

Zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit 2011 në tregun e pensioneve private vullnetare[v], ka qenë licencimi i dy operatorëve të cilët do ta zhvillojnë më tej këtë segment. Ky treg gjatë vitit 2011 paraqet një nivel aktivesh prej 142 milionë lekësh dhe një total të ardhurash nga kontributet prej 177 milionë lekësh, prej të cilëve rreth 44% paguhet nga anëtarët, ndërsa pjesa tjetër nga punëdhënësit.

[i] *Posta Shqiptare nuk ka raportuar bilancin e saj për tremujorin e katërt të vitit 2011, si rrjedhojë në llogaritjet tona kemi marrë parasysh bilancin e tremujorit të tretë 2011 të saj.*
[ii] *Mesatarja historike e NPL-ve për jobankat është llogaritur për periudhën dhjetor 2005-dhjetor 2011.*
[iii] *Mbështetur në publikimin statistikor mbi "Tregun e Sigurimeve-Viti 2011", Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).*
[iv] *Sipas raportimeve në Bankën e Shqipërisë.*
[v] *Mbështetur në publikimin e AMF "Mbi zhvillimet në tregun e pensioneve private suplementare për vitin 2011".*

VI. SEKTORI BANKAR

6.1 ECURIA E AKTIV-PASIVEVE DHE PËRBËRJA E TYRE

Në fund të vitit 2011, aktivet e sektorit bankar përbëjnë 84.8% të PBB-së kundrejt 82.2% në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 dhe 80.9% në fund të vitit 2010. Aktivet e sektorit bankar u ngjitën në nivelin 1,120.2 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 7.3% kundrejt gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 dhe 13.1% kundrejt një viti më parë.

Tabelë 6.1. Pesha e zërave të aktiveve (dhjetor '05 – dhjetor '11).

Pesha ndaj totalit të aktiveve (në përqindje)	Dhjetor '05	Dhjetor '06	Dhjetor '07	Dhjetor '08	Dhjetor '09	Dhjetor '10	Dhjetor '11	Vlerat në mld lekë (dhjetor'11)
1. Veprime me thesarin dhe ato ndërbankare. Nga këto:	58.8	50.6	39.5	30.1	28.7	29.9	29.8	333.3
- Marrëdhënie me Bankën Qendrore	9.3	8.9	9	8.3	7.8	8.3	8.1	91.2
- Bono thesari	35.3	26.3	17.1	12.8	12	10.4	9.3	104.6
- Marrëdhënie me bankat e tjera	12.2	13.2	11.2	6.6	6.5	9.3	10.5	117.6
2. Veprime me klientët (bruto)	25.7	31.7	39.4	47.6	50.8	49.1	50.1	561.7
Fonde rezervë të krijuara[1]	-0.36	-5.45	-6.24	-1.51	-2.83	-3.77	-5.2	-58.8
3. Veprime me letrat me vlerë	12.2	14.7	18	20	20.1	21.27	21.8	244.2
4. Mjete të tjera	0.7	0.9	1.3	1	0.9	0.92	1.2	13.8
5. Mjete të qëndrueshme	1.5	1.5	1.5	1.8	1.7	1.4	1.2	13.9
Interesa të përllogaritura (total)	1.6	1.27	1.32	1.3	1.18	1.19	1.1	12.2
Totali i aktiveve	100	100	100	100	100	100	100	1120.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në përbërjen e aktiveve të sektorit bankar, veçojmë:

- Portofoli i kredive (pa përfshirë interesat e llogaritura[28]) u ngjit në vlerën 561.7 miliardë lekë, duke u rritur me 8.3% kundrejt gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 dhe me 15.5% ndaj një viti më parë. Rritja e stokut të kredisë për vitin 2011 ka rezultuar më e lartë sesa rritja me 9.1% në vitin 2010. Kredia në valutë zë 67.9% të totalit të kredisë, rreth 0.8 pikë përqindje më pak se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011. Pesha e kredive të grupit 3 përbën 67.7 % të totalit të tyre.

- Veprimet me thesarin dhe ato ndërbankare (pa përfshirë interesat e llogaritura), shënuan vlerën 333.2 miliardë lekë, një rritje me 8.9% ndaj muajit qershor 2011 dhe me 12.5% ndaj një viti më parë. Ritmi i rritjes së këtij grupi në periudhën dhjetor '09 - dhjetor '10 ishte 11.8%, pothuajse në të njëjtat nivele me fundin e vitit 2011. Grupi 3 përbën 74.1 % të totalit të veprimeve me thesarin dhe ndërbankare.

- Investimet e sektorit bankar në letrat me vlerë të borxhit publik dhe privat,

[28] *Vlerësohen në rreth 4.5 miliardë lekë.*

Grafik 6.1. Ecuria e zërave të aktivit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

vendas dhe të huaj, kapën vlerën 244.2 miliardë lekë, duke qenë 6.1% më shumë se gjashtëmujori i kaluar dhe 15.9% më shumë se një vit më parë. Grupi 3 zë 84.6% të totalit të investimeve në letra me vlerë.

Përbërja dhe ecuria e zërave të aktivit, paraqitet në grafikun 6.1.

Përbërja e detyrimeve të sektorit bankar sipas peshave, ka ndryshuar në vite si në tabelën 6.2.

Tabelë 6.2. Pesha e zërave të detyrimeve/pasiveve (dhjetor '06 – dhjetor '11).

Pesha ndaj totalit të pasiveve (në përqindje)	Dhjetor '06	Dhjetor '07	Dhjetor '08	Dhjetor '09	Dhjetor '10	Qershor '11	Dhjetor '11	Vlerat në mld lekë (dhjetor '11)
1. Veprime me thesarin dhe ato ndërbankare. Nga këto:	7.6	5.7	11.8	4.5	6.18	6.75	6.4	72.1
Marrëdhënie me Bankën Qendrore	0.2	0	0.1	0.2	0.05	0.06	0.2	1.8
- Bono thesari	1.4	0.2	2.4	3.6	1.31	2.28	2.3	25.4
Marrëdhënie ndërbankare	4	5.3	9	4.3	4.7	4.3	1.45	16.3
2. Veprime me klientët (bruto)	84.2	84.9	77.3	88.1	81.27	80.7	81.4	911.2
3. Detyrime të tjera	0.8	1	1.1	1	0.76	1	0.9	10.2
4. Interesa të përllogaritura	0.86	1.14	1.4	1.22	1.21	1.4	1.2	13.3
5. Burimet e përhershme, nga këto:	7.4	8.4	9.6	10.8	10.58	10.1	10.1	113.4
- Kapitali i aksionerëve	6.8	7.5	8.6	9.6	9.4	8.6	8.7	97.3
Totali i pasiveve	100	100	100	100	100	100	100	1120.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në përbërjen e detyrimeve të sektorit bankar, veçojmë:

- Depozitat (pa përfshirë interesat[29] e llogaritura) arritën vlerën rreth 911.2 miliardë lekë, duke shënuar një rritje 8.2% kundrejt gjashtëmujorit të parë dhe 13.2% në krahasim me një vit më parë. Bankat e Grupit 3, përfaqësojnë 74.1% të vlerës së përgjithshme të depozitave;

- Veprimet me thesarin dhe ndërbankare[30] kapën vlerën 72.1 miliardë lekë. Në fund të periudhës, vëllimi tyre u rrit me 1.7 miliardë lekë ose 2.4% në krahasim me muajin qershor 2011 dhe me rreth 17.8% kundrejt një viti më parë.

[29] *Llogariten në vlerën 12.8 miliardë lekë.*

[30] *"Veprimet me thesarin dhe ndërbankare" përfshijnë: veprimet me Bankën Qendrore dhe bonot e thesarit të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes, si edhe marrëdhëniet (huamarrjet nga) me bankat e huaja (kryesisht nga grupi bankar të cilit i përkasin).*

6.2 POZICIONI I SEKTORIT BANKAR NDAJ JOREZIDENTËVE

Aktivet e sektorit bankar ndaj jorezidentëve ose investimet e sektorit bankar në mjete të subjekteve jorezidente, u ngjitën në nivelin 183.3 miliardë lekë, duke u rritur me 41.7% ndaj gjashtëmujorit të kaluar dhe me 50.2% ndaj një viti më parë. Ndërkohë, vendosjet e sektorit bankar pranë institucioneve jorezidente vlerësohen në masën 98.2 miliardë lekë, prej të cilave 86.7 miliardë lekë në formën e llogarive rrjedhëse e të depozitave dhe 11.5 miliardë lekë në formën e kredive. Aktivet jorezidente në raport me totalin e aktiveve janë rritur në nivelin 16.4%, nga niveli 12.4% në fund të gjashtëmujorit të kaluar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ky raport është rritur me 4.1 pikë përqindje.

Detyrimet e sektorit bankar ndaj jorezidentëve u vlerësuan në masën 76.3 miliardë lekë, duke shënuar rritje me 15.1% krahasuar me muajin qershor 2011 dhe 57.6% në krahasim me një vit më parë. Vlera e linjave të kreditit të përfituara nga grupet bankare zotëruese dhe të përdorura, vlerësohet në rreth 16.9 miliardë lekë. Pjesa e angazhuar por e papërdorur[31] e linjave të kreditit nga grupet bankare zotëruese, vlerësohet në rreth 46.5 miliardë lekë. Detyrimet ndaj jorezidentëve në raport me totalin e detyrimeve, shënuan vlerën 6.8%, nga 6.3% që shënonin në fund të muajit qershor 2011 dhe 4.9% një vit më parë. Ndikimi kryesor në raportin e "Detyrimeve ndaj jorezidentëve" ndaj "Totalit të detyrimeve" i përket bankave të grupeve 2 dhe 3, të cilat paraqiten më të ekspozuara ndaj institucioneve jorezidente. Ndonëse vërehet rritje e këtij raporti gjatë gjashtëmujorit të parë 2011, situata shfaqet e normalizuar, duke pasqyruar qëndrueshmëri të gjendjes financiare.

Në fund të vitit 2011, raporti "detyrime jorezidente ndaj totalit të detyrimeve në valutë" ishte në nivelin 13.1%, krahasuar me 12.6% në fund të muajit qershor 2011 dhe 9.6% një vit më parë. Nga analiza e mësipërme vlerësohet se rreziku nga ekspozimi i sektorit bankar ndaj jorezidentëve është në vlera të moderuara.

Grafik 6.2. Pesha e grupeve të bankave në totalin e aktiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6.3. Pozicioni i sektorit bankar ndaj jorezidentëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6.4. Detyrimet ndaj jorezidentëve ndaj totalit të detyrimeve sipas grupeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[31] E regjistruar si zë jashtë bilancit.

6.3 TEPRICA E KREDISË

Kredia e sektorit bankar ka shënuar një rritje më të lartë gjatë vitit 2011 krahasuar me një vit më parë. Rritja e kredisë për individët ka qenë tepër e ulët, ndërkohë që kredia për sektorin e biznesit ka ruajtur ritme të mira rritëse gjatë vitit 2011. Kërkesa e bizneseve për kredi është orientuar më shumë drejt financimit të kapitalit qarkullues, ndërsa kërkesa e individëve është orientuar drejt financimit të konsumit të mallrave jo të qëndrueshme dhe investimeve në pasuri të paluajtshme. Sektori i bujqësisë dhe ai i prodhimit të energjisë elektrike kanë shënuar rritjen vjetore më të madhe të kredisë, ndërkohë që sektori i ndërtimit ka shfaqur një sjellje prociklike, duke u tkurrur më tej. Pritshmëritë e bankave për të ardhmen tregojnë për një kërkesë më të ulët për kredi, kryesisht në drejtim të financimit të sektorit të biznesit dhe atij të pasurive të paluajtshme[32]. Rritja e portofolit të kredive me probleme dhe pasiguritë për të ardhmen e ekonomisë kanë forcuar kujdesin e bankave në kredidhënie.

Grafik 6.5. Totali i pasiveve jorezidente ndaj totalit të pasiveve në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6.6. Shpërndarja e normës së rritjes së kredisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, teprica e kredisë shënoi një rritje prej 42.7 miliardë lekë (ose 8.2%) krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe rreth 75.3 miliardë lekë (ose 15.3%) referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë, duke u ngjitur në nivelin 566.2 miliardë lekë. Portofoli i kredisë së sektorit bankar zë rreth 42.8% të PBB-së së vendit. Shpërndarja e normës së rritjes së kredisë tregon për ritme më të ulëta të rritjes së kredisë (mesatarisht 22%) pas vitit 2008 krahasuar me periudhën e mëparshme.

Në fund të vitit 2011, rritja vjetore e kredisë për sektorin e bizneseve rezultoi 20.3%[33], duke u ngjitur në nivelin 397 miliardë lekë, ndërkohë që kredia për sektorin e individëve ka shënuar rritjen më të ulët historike prej 0.76% duke përfituar rreth 148.8 miliardë lekë. Kontributin kryesor në rritjen e tepricës së kredisë vijon ta japë kredia e akorduar në valutë, megjithatë rritjen më të lartë vjetore e ka shënuar kredia në lekë me rreth 22.8%, kundrejt 12.1% në valutë. Në kushtet e nevojës për likuiditet nga bizneset, kredia afatshkurtër ka shënuar një rritje vjetore prej 19.1%, më e lartë se rritja vjetore e një viti më parë me 6.3%.

[32] *Mbështetur në vrojtimin e realizuar nga Departamenti i Kërkimeve mbi "Analizën e aktivitetit dhe pritshmërive të sektorit bankar shqiptar", Shkurt 2012.*

[33] *Llogaritjet për ecurinë e kredisë përfshijnë rezidentët (kredia totale ndaj të cilëve zë një peshë të lartë, rreth 94.3%) dhe jorezidentët (me një peshë 5.7%) në Shqipëri.*

Grafik 6.7. Ecuria e rritjes vjetore të kredisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e kredisë sipas qëllimit të përdorimit për sektorin e biznesit në një periudhë prej 5 vitesh është përqendruar në formën "overdraft" dhe "investime në pasuri të paluajtshme", ndërkohë që evidentohet rënie e peshës së kredisë për "investime në blerje pajisjesh". Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas qëllimit të përdorimit për sektorin e individëve ajo paraqet zhvendosje drejt "konsumit të mallrave jo të qëndrueshme" dhe "investimeve për pasuri të paluajtshme".

Grafik 6.8. Shpërndarja e tepricës së kredisë për biznesin dhe individët sipas qëllimit të përdorimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sektori bankar ka mbështetur më shumë financimin e sektorit të prodhimit të energjisë elektrike, bujqësisë dhe industrisë, ku kredia akorduar këtyre tre sektorëve ka shënuar rritje vjetore përkatësisht me 57.3%, 40.3% dhe 19.5%. Në një hark kohor prej 3 vitesh, dhe pse me një peshë relativisht të ulët, sektori i bujqësisë ka zbutur ngadalësimin e kreditimit në ekonomi si rezultat i rritjes së kredisë me ritme më të shpejta, duke kaluar me rreth 16.2 pikë përqindje mesataren 3-vjeçare të llogaritur në nivelin 24.1 % (grafik 6.9).

Në vitet e fundit, sektori i ndërtimit mbetet më pak i preferuar për t'u kredituar nga sektori bankar, si reflektim i ecurisë së dobët të tij. Rritja vjetore e kredisë për këtë sektor ka vijuar prirjen rënëse, duke shënuar një tkurrje me rreth 7.7% në muajin dhjetor 2011. Kreditimi i sektorit të ndërtimit ka shfaqur një sjellje prociklike në një hark kohor 3-vjeçar, ku ulja e kredisë për këtë sektor krahasuar me sektorët e tjerë të ekonomisë ka qenë më e shpejtë (grafik 6.9).

Grafik 6.9. Ecuria e rritjes vjetore të kredisë për sektorin e bujqësisë dhe ndërtimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 6. KREDIA E RE.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, sektori bankar dha kredi të re në masën 151.5 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej rreth 13.7 miliardë lekësh ose 9.9% referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Për të njëjtën periudhë, sektori bankar mblodhi kredi në masën 116.6 miliardë lekë, nga rreth 112.7 miliardë lekë të mbledhura gjatë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Raporti i kredisë së mbledhur me kredinë e dhënë përfaqëson treguesin e përdorimit të kredisë. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, ky raport u llogarit në nivelin 77% nga 81.8% referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë, si rezultat i ritmit më të lartë të rritjes së kredisë së re krahasuar me kredinë e mbledhur.

Sipas grupeve të përdoruesve, gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011, sektori i biznesit ka përfituar rreth 128.5 miliardë lekë ose rreth 85% të kredisë së re, ndërkohë që sektori i individëve përfitoi rreth 23 miliardë lekë ose rreth 15% të totalit të kredisë së re. Grafiku 6.10 paraqet ecurinë e kredisë së re dhe treguesin e përdorimit të kredisë me bazë gjashtëmujore.

Grafik 6.10. Kredia e re dhe përdorimi i kredisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e kredisë së re sipas qëllimit të përdorimit për sektorin e biznesit evidenton se në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, kredia e re është zhvendosur drejt "investimeve në blerje pajisjesh". Për sektorin e individëve evidentohet një ritëm më i lartë i zgjerimit të kredisë së re overdraft, ndërkohë që kredia e re për "pasuri të paluajtshme" është zgjeruar më ngadalë.

Grafik 6.11. Shpërdarja e peshave të kredisë së re për sektorin e biznesit dhe individëve sipas qëllimit të përdorimit, në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në lidhje me përbërjen sipas monedhave, në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, evidentohet rritje e kredisë së re në monedhën vendase dhe në dollarë amerikanë me 15.4% dhe 116.6%, në nivelet 58.4 miliardë lekë dhe 15.5 miliardë lekë. Ndërkohë, shënohet rënie e kredisë së re akorduar në monedhën evropiane me 3%, duke zbritur në 77.6 miliardë lekë.

Analiza e shpërndarjes së kredisë së re sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë evidenton tre zhvillime kryesore. Së pari, është rritur pesha e kredisë së re dhënë sektorit të "tregtisë, riparimit të automjeteve dhe artikujve shtëpiakë" në rreth 35.9%, nga 31% në fund të vitit 2010. Së dyti, ka rënë pesha e kredisë së re për sektorin e "industrisë përpunuese" në 9.9% nga 13.2% një vit më parë. Së fundmi, sektori i ndërtimit mbetet sektori më pak i krediduar nga sektori bankar.

Grafik 6.12. Shpërndarja e kredisë së re sipas sektorëve të ekonomisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

- *Ecuria e normave të interesit për kreditë e reja*

Gjashtëmujori i dytë i vitit 2011 paraqet prirje lehtësuese në çmimet e kredidhënies në lekë nga sektori bankar. Interesat për kreditë e reja në lekë kanë shfaqur luhatje minimale pranë niveleve të ulëta në këtë periudhë. Ndërkohë, kreditimi në euro dhe në dollarë ka shënuar rritje të mesatares së normave të interesit.

Në gjysmën e dytë të vitit 2011, norma mesatare e interesit për kreditë në lekë rezultoi me një ulje prej 0.9 pikë përqindje krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit. Ajo shënoi mesatarisht vlerën 11.5%. Sektori i biznesit ka përfituar kushte lehtësuese për kredinë e re në lekë në formën "overdraft", pasi norma e interesit mesatar për këtë kategori ka rënë me rreth 2.3 pikë përqindje në nivelin 10.4%.

Norma mesatare e interesit për kreditë në euro për të njëjtën periudhë është rritur, duke regjistruar një vlerë mesatare rreth 7.5%, nga 7.4% në gjashtëmujorin e kaluar. Kjo prirje ka ardhur si rezultat i nivelit më të lartë të normave referencë si dhe nga aplikimi i çmimeve më të larta kryesisht për kreditë për "investime në blerje pajisjesh" në euro për sektorin e biznesit. Interesi për këto të fundit është rritur me rreth 0.29 pikë përqindje, në nivelin 7.4%. Në afatin e gjatë mbi 5 vjet (i referohemi kryesisht kredisë për pasuri të paluajtshme) për sektorin e individëve, bankat vijojnë të aplikojnë interesa relativisht të larta si për lekun dhe për euron. Të njëjtën ecuri në rritje e kanë shfaqur dhe normat mesatare të interesit për kredinë e re në dollarë.

Grafik 6.13. Ecuria e normës së interesave për kreditë e reja në lekë dhe valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

6.4 DEPOZITAT DHE ECURIA E TYRE

Niveli dhe ecuria e depozitave të sektorit bankar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, kanë shënuar rritje. Depozitat vazhdojnë të mbeten të përqendruara në bankat më të mëdha të sektorit bankar dhe shkalla e përqendrimit të tyre shënon rritje në krahasim me muajin qershor 2011. Totali i depozitave, në gjysmën e dytë të vitit 2011, ka shënuar rritje me 7.8% në krahasim me muajin qershor 2010 dhe me 13.1% krahasuar me një vit më parë.

Tabelë 6.3. Norma e rritjes së depozitave.

Periudha	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	6m I-2011	6m II-2011
Rritja e totalit të depozitave (ne %)	13.4	16.4	20.1	19.9	2.4	7.6	17.7	4.9	7.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket strukturës së depozitave, vlen të përmendet një "zhvendosje" e depozitave nga një maturim 1-3 mujor (në rënie me 38%) në depozita me afat maturimi 6-12 muaj dhe 1-5 vjet (në rritje me përkatësisht 68% dhe 23%) kundrejt gjysmës së parë të vitit 2011. Kjo ecuri reflekton qëndrueshmëri të besimit të publikut ndaj sektorit bankar por edhe vijimin e prirjes për të kursyer kundrejt prirjes për konsum. Informacionet që vijnë nga operatorët e tregut, tregojnë edhe për hyrjen e kursimeve nga ana e shqiptarëve që punojnë si emigrantë në vende të tjera, kryesisht nga Greqia.

Grafik 6.14. Struktura e depozitave të sektorit bankar sipas maturimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lidhur me strukturën e depozitave sipas monedhës, vërehet se në dhjetor të vitit 2011, depozitat në lekë përbëjnë 50.1% të totalit të depozitave në vlerën 462.6 miliardë lekë, ndërsa ato në valutë përbëjnë 49.9% të totalit të depozitave në vlerën 461,4 miliardë lekë. Pesha e depozitave në lekë është ulur me 1.9 pikë përqindje kundrejt muajit qershor 2011 dhe me 1.1 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit 2010.

HAPËSIRË INFORMUESE 7. DEPOZITAT E REJA.

Ecuria e depozitave të reja me afat në monedhën vendase ka treguar rënie gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011. Gjatë kësaj periudhe u pranuan 333 miliardë lekë depozita të reja me afat në lekë ose rreth 9.8% më pak se në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2010. Kjo rënie ka ardhur në një kohë kur normat e interesit për depozitat në lekë kanë pësuar ulje shumë të lehtë, nga 5.16% në 5.1%. Për sa i takon strukturës së maturimit të depozitave të reja në lekë, në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011 vërehet një rënie vjetore me rreth 5.6 pikë përqindje në peshën e depozitave të reja me maturim 1-mujor në nivelin 36.3% dhe rritje e peshës së depozitave të reja me maturim 1-vjeçar me rreth 7 pikë përqindje, në nivelin 32%.

Depozitat e reja me afat në usd të pranuara nga sektori bankar, në 6 muajt e fundit të vitit 2011 ishin 487.1 milionë usd, rreth 24.3% më pak se një vit më parë. Struktura e depozitave me afat ka ndryshuar kryesisht në ato me afat maturimi 1-vjeçar, pesha e të cilave ka pësuar rritje me 4.8 pikë përqindje, si dhe në ato me afat maturimi 1 muaj pesha e të cilave ka rënë me 8.9 pikë përqindje. Norma mesatare mujore e interesit për depozitat e reja në usd, ka qenë 1.5% në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, krahasuar me 1.36% në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Depozitat e reja me afat të pranuara nga sektori bankar në euro ishin 2.1 miliardë euro, duke rënë me 50.7% në krahasim me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2010. Kjo normë rënieje është reflektuar pavarësisht rritjes me rreth 0.5 pikë përqindje të normës mesatare të interesit për depozitat me afat në euro në krahasim me një vit më parë. Në lidhje me strukturën e maturimit të depozitave të reja në monedhën

evropiane, vërehet rënie e peshës me 33.5 pikë përqindje të depozitave me maturim 1-mujor, në nivelin 34.4%, ndërsa pesha e depozitave me maturim 3 dhe 12-mujor është rritur përkatësisht me 11 dhe 17.8 pikë përqindje në terma vjetorë, duke arritur nivelet prej 22.2% dhe 29.9%.

Grafik 6.15. Ecuria e depozitave të reja dhe e normave të interesit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

6.5 KAPITALI

Në gjysmën e dytë të vitit 2011, "Burimet e përhershme" shënuan vlerën 113.4 miliardë lekë, duke vijuar ecurinë e tyre rritëse. Elementi kryesor i tyre, "Kapitali i aksionerëve", në fund të periudhës është 97.3 miliardë lekë, në rritje me rreth 7.1 miliardë lekë ose 7.9% kundrejt muajit qershor 2011 dhe 4.5% në krahasim me një vit më parë. Kapitali i aksionerëve përfaqëson 8.7% të totalit të aktiveve, krahasuar me 8.6% në fund të muajit qershor 2011 dhe 9.4% një vit më parë. Bankat e Grupit 3 përfaqësojnë 71.8% të vlerës së kapitalit aksioner të sektorit, nga 69.6% në muajin qershor 2011. Kapitali i paguar shënon vlerën 82.8 miliardë lekë, me rritje rreth 9.7 miliardë lekë ose 13.3%, nga muaji qershor 2011. Ky tregues përfaqëson 7.4% të totalit të aktiveve, në rritje me 0.4 pikë përqindje nga muaji qershor 2011 dhe 0.25 pikë përqindje nga fundi i vitit 2010.

6.6 REZULTATI FINANCIAR DHE EFICIENCA E BURIMEVE

Në gjysmën e dytë të vitit 2011, aktivet mesatare që sjellin të ardhura u ngjitën në nivelin 943 miliardë lekë, duke përfaqësuar rreth 89.7% të vlerës së përgjithshme të aktiveve mesatare të sektorit bankar. Ky tregues shënoi rritje me 23.8 miliardë lekë ose 2.6% kundrejt muajit qershor 2011 dhe me 87.6 miliardë lekë ose 10.2% kundrejt një viti më parë. Raporti "pasive mesatare që shkaktojnë shpenzime/aktive mesatare që sjellin të ardhura" është në nivelin 94.4%, rreth 1 pikë përqindje më i lartë se në fund të muajit qershor 2011 dhe 1.4 pikë përqindje më i lartë se një vit më parë.

Të ardhurat neto të veprimtarisë[34] së sektorit bankar, rezultojnë 39.6 miliardë lekë ose 10.3% më të ulëta se në të njëjtën periudhë të një viti më parë, dhe përfaqësohen totalisht nga të ardhurat neto nga interesat. Kostot operative[35] të veprimtarisë shënojnë vlerën 24.5 miliardë lekë ose 4.3% më të larta se një vit më parë. Si rezultat, raporti i kostove operative ndaj të ardhurave neto rezulton në nivelin 61.8% nga 53.1% për të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Raporti i shpenzimeve të përgjithshme të veprimtarisë[36] ndaj të ardhurave arriti në 94.1%, krahasuar me 82.7% në muajin dhjetor 2010, rrjedhojë e rënies së të ardhurave neto nga veprimtari të tjera në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe rritjes së fondeve rezervë për rrezikun e kreditit (provigjoneve).

Në gjysmën e dytë të vitit 2011, rezultati neto është pozitiv në masën 706 milionë lekë, duke qenë rreth 89.5% më i ulët se për të njëjtën periudhë një vit më parë. Pavarësisht rritjes së rezultatit neto nga interesat prej 2.65 miliardë lekësh në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënia e rezultatit neto nga veprimtaritë e tjera (me 7.2 miliardë lekë ose pothuaj 100%) dhe rritja e shpenzimeve për provigjone për kreditë në nivelin 20.6 miliardë ose rreth 6.8 miliardë lekë më shumë se një vit më parë, janë reflektuar në rënien e ndjeshme të rezultatit neto. Gjithashtu, fitimi i sektorit bankar mbetet i përqendruar në bankat më të mëdha.

Kthimi mbi aktivet (RoA), i kthyer në bazë vjetore, ka rezultuar 0.07% nga 0.72% për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kthimi mbi kapitalin (RoE), i kthyer në bazë vjetore, ka rezultuar 0.76%. Në fund të vitit 2010, ky tregues ishte 7.6%.

Grafik 6.16. Komponentët kryesorë të të ardhurave operative.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6.17. Ecuria e kthimit nga aktivet (RoA) dhe kthimit nga kapitali (RoE) për sektorin bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[34] Të ardhurat neto nga interesat plus të ardhurat e tjera neto.
[35] Pa përfshirë shpenzimet për provigjone.
[36] Kosto operative plus shpenzime për provigjone dhe rezerva të tjera.

Grafik 6.18. Ecuria e kthimit nga aktivet (RoA) dhe kthimit nga kapitali (RoE) për grupet sipas madhësisë së kapitalit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

6.7 PËRMIRËSIME LIGJORE DHE RREGULLATIVE

Në muajin nëntor 2011, u finalizuan me miratimin në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, disa ndryshime dhe plotësime në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" të përgatitura nga Banka e Shqipërisë.

Krahas disa plotësimeve në kuadër të një përcaktimi më të qartë të veprimtarisë me paranë elektronike dhe të institucioneve financiare përkatëse, në kuadër të një përafrimi më të mirë me direktivën përkatëse evropiane, ndryshimet në ligj përfshinin edhe:

1) përkufizimin e rrezikut sistemik, si rreziku i lidhur me faktorë që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë, vlerën e aktiveve dhe/ose besimin në sistemin apo tregun bankar dhe financiar në tërësi, si edhe pajisjen e Bankës së Shqipërisë me disa kompetenca për të parashikuar me akt nënligjor mënyrat dhe rregullat për parandalimin dhe/ose administrimin e këtij rreziku;

2) parashikimin e mundësisë për shndërrimin në filial vendas të degëve të bankave të huaja që veprojnë në Shqipëri. Kjo mënyrë e veçantë e krijimit të një banke/filiali shqiptar nga një bankë e huaj, parashikohet në ligj si e detyrueshme për zbatim kur gjykohet e nevojshme nga Banka e Shqipërisë për arsye të administrimit të rrezikut sistemik. Në praktikë, ky proces nuk sjell ndryshime thelbësore në funksionimin e përditshëm të degëve të bankave të huaja, pasi prej kohësh ato janë licencuar dhe mbikëqyrur në të njëjtën mënyrë si filialet e bankave. Por ky ndryshim ofron një bazë më të mirë ligjore për praktikën ekzistuese të mbikëqyrjes;

3) përcaktimin e "bankës urë", si një instrument i përdorur nga autoritetet mbikëqyrëse ndërkombëtare për trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve më të vështira në banka. Përmes këtij instrumenti, mundësohet transferimi i pjesës së shëndoshë të aktiveve dhe detyrimeve të një banke me probleme te banka urë, ndërkohë që aktivet dhe detyrimet e tjera i nënshtrohen likuidimit në rast nevoje. Në këtë mënyrë krijimi i "bankës urë" është një teknikë në dispozicion të autoriteteve mbikëqyrëse, e cila nga njëra anë mundëson vazhdimin e pandërprerë të operacioneve dhe shërbimeve të bankës me probleme për klientët e saj, dhe nga ana tjetër ofron kohën e nevojshme për gjetjen e një zgjidhjeje tregu përfundimtare që minimizon kostot publike që mund të shkaktohen nga kalimi i një banke në likuidim të menjëhershëm. Në ligj përcaktohen kompetencat e Bankës së Shqipërisë, që me akt nënligjor të parashikojë kushtet e krijimit të saj dhe të rregullojë mënyrën e organizimit e të funksionimit të kësaj banke, duke pasur parasysh natyrën e përkohshme të funksioneve të saj.

Ndryshimet e miratuara në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" përfshijnë dhe disa ndryshime dhe saktësime të tjera të cilat vijnë si reflektim i eksperiencës së derisotme në zbatimin e tij.

VII. MONITORIMI I RREZIQEVE NDAJ TË CILËVE EKSPOZOHET SEKTORI BANKAR

7.1 RREZIQET E TREGUT

Grafik 7.1. Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar, në përqindje (dhjetor '05 – dhjetor '11).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 7.2. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për sektorin bankar dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

7.1.1 RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT

Në fund të vitit 2011, aktivet e sektorit bankar në valutë shënojnë vlerën 616.4 miliardë lekë, një rritje me 12.5% në krahasim me gjysmën e parë të vitit 2011 dhe 17.3% në raport me një vit më parë. Detyrimet (pasivet) në valutë arritën në nivelin 581.4 miliardë lekë, një zgjerim me 10.7% në krahasim me muajin qershor 2011 dhe 15.1% në krahasim me një vit më parë. Pesha e aktiveve dhe e detyrimeve në valutë kundrejt totalit të aktiveve në fund të vitit 2011 është përkatësisht 55% dhe 51.9%. Krahasuar me një vit më parë, është rritur pesha e aktiveve dhe e detyrimeve në valutë kundrejt totalit, përkatësisht me 2 dhe 0.9 pikë përqindje. Pavarësisht rritjes së diferencës ndërmjet aktiveve dhe pasiveve në valutë, ajo mbetet brenda intervalit historik 0-10%.

Madhësia e pozicionit të hapur konsiderohet e kufizuar dhe si rezultat, rreziku i drejtpërdrejtë i kursit të këmbimit për bankat, vlerësohet i moderuar. Sipas grupeve të bankave, bankat e grupeve 1 dhe 2 janë zhvendosur në një pozicion "në shitje" gjatë muajve të fundit të vitit, ndërsa bankat e grupit 3 kanë thelluar pozicionin e tyre "në blerje".

HAPËSIRË INFORMUESE 8. INDEKSI I MODIFIKUAR I MOSPËRPUTHJEVE VALUTORE.

Indeksi i modifikuar i mospërputhjeve valutore paraqet ecurinë e ekspozimit të bankave ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të kursit të këmbimit. Gjatë gjashtëmujorit të dytë 2011 evidentohet një përmirësim i indeksit nga -16.7%, që shënonte në fund të qershorit 2010, në -16.1%. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, indeksi ka pësuar rënie me 0.7 pikë përqindje. Treguesit kryesorë, që kanë ndikuar në këtë përmirësim janë totali i aktiveve të jorezidentëve në valutë i cili gjatë gjashtëmujorit të dytë u rrit ndjeshëm me rreth 43.1% kundrejt gjashtëmujorit të parë, si dhe rënia e huave të pambuluara me kolateral për individët me -6.4%. Pavarësisht këtyre ndryshimeve, indeksi i mospërputhjeve valutore mbetet në bandën e -10% deri në -20% duke patur një luhatshmëri të pranueshme.

Grafik 7.3. Indeksi i mospërputhjes valutore.



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të Departamentit të Stabilitetit Financiar.

7.1.2 RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT

Aktivet dhe detyrimet (pasivet) e ndjeshme ndaj normës së interesit vijojnë të paraqiten në vlera të përafërta edhe në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011. Diferenca mes tyre për periudhën deri në 1 muaj dhe 3 muaj paraqitet pozitive, përkatësisht me 26.3 dhe 51.2 miliardë lekë ndërsa diferenca e aktiveve dhe pasiveve deri në 12 muaj paraqitet negative në vlerën 79.2 miliardë lekë. Diferenca pozitive ndërmjet aktiveve dhe pasiveve afatshkurtra deri në 1 dhe 3 muaj tregon se sektori bankar ka një ekspozim ndaj rrezikut të uljes së normës së interesit. Ndërsa zhvillimet në aktivet dhe pasivet deri në 12 muaj reflektojnë një ekspozim ndaj rritjes së normës së interesit. Gjithsesi, ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit në nivel sektori është në nivele të moderuara në raport me totalin e aktiveve të sektorit bankar, i cili në dhjetor 2011 rezulton -7.1%. Ndërkohë, për disa banka të cilat kanë nivele të larta të këtij raporti, ekziston mundësia e goditjes së përfitueshmërisë së tyre si rezultat i rrezikut të normës së interesit.

Grafik 7.4. Diferenca midis aktiveve-pasiveve sipas periudhave të riçmimit (mln, lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

7.2 RREZIKU I KREDITIT

Pasiguria për zhvillimet ekonomike ndërkombëtare dhe ndikimi i tyre mbi zhvillimet ekonomike në vend është shoqëruar me hezitim të ndërmarrjes së investimeve e të konsumit nga ana e agjentëve ekonomikë dhe të një politike më të kujdesshme të kreditimit nga bankat. Si rezultat, zhvillimet në krahun e kërkesës dhe të ofertës, kanë sjellë rritjen e mëtejshme të vlerës së kredive me probleme në sektorin bankar. Paralelisht me këto zhvillime evidentohet një ekspozim më i madh ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit për shkak të kursit të këmbimit, në krahasim me një vit më parë.

Për të vlerësuar nivelin e rrezikut të kreditit në veprimtarinë bankare, fillimisht analizojmë ecurinë e aktiveve me rrezik paralelisht me ecurinë e totalit të aktiveve[37]. Në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011, aktivet me rrezik[38] të sektorit bankar rezultuan rreth 632.7 miliardë lekë, rreth 14 miliardë lekë ose 2.3% më shumë se një gjashtëmujor më parë dhe 46.7 miliardë lekë ose 7.9% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Ato përbëjnë aktualisht rreth 56.5% të totalit të aktiveve të sektorit bankar. Aktivet pa rrezik (me koeficient rreziku 0%) rezultuan 450.3 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 40.6 miliardë lekësh ose 9.9%. Tendenca rritëse e treguesve të rrezikut të kredisë, ka bërë që bankat të ndërmarrin më pak investime drejt aktiveve me rrezik të lartë. Konkretisht, në gjysmën e dytë të vitit 2011, aktivet me normë ponderimi 150% shënuan një rënie me rreth 45 miliardë lekë ose 22.8% krahasuar me një gjashtëmujor më parë, duke zbritur në nivelin e 152.2 miliardë lekëve. Kjo ka ardhur për shkak të zhvendosjes drejt aktiveve me një normë ponderimi 20% dhe 100%, të cilat u rritën me rreth 36.5% dhe 29.2% referuar një gjashtëmujori më parë. Një ndër arsyet e zhvendosjes drejt aktiveve me një normë ponderimi 20% të sektorit bankar është zbatimi i rregullores së re të likuiditetit që përcakton edhe norma minimale të ruajtjes së raportit aktive likuide/pasive afatshkurtra në valutë për bankat në vend.

Grafik 7.5. Ecuria e aktiveve me rrezik.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit, raporti i aktiveve të ponderuara me koeficientët e rrezikut kundrejt totalit të aktiveve ka shënuar rënie për të gjitha grupet, si rezultat i ritmit më të lartë të rritjes së aktiveve. Peshën më të lartë të aktiveve me rrezik vijojnë ta kenë bankat e Grupit 2 me rreth 67.5%.

Në gjysmën e dytë të vitit 2011, vëllimi i huave me probleme të sektorit bankar ka vijuar prirjen rritëse duke u ngjitur në nivelin 106.3 miliardë lekë, nga

[37] *Ecurinë e totalit të aktiveve dhe totalit të aktiveve me rrezik e kemi paraqitur në formën e raportit ndaj një periudhe bazë (në rastin tonë, dhjetor 2005=100).*

[38] *Për qëllim të llogaritjes së normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, ponderohen me një koeficient të caktuar rreziku (20%, 50%, 100% ose 150%). Në përgjithësi, aktivet me rrezik mbizotërohen nga portofoli i kredisë dhe përfshijnë edhe investimet në letrat me vlerë të borxhit e vendosjet pranë institucioneve financiare.*

88.9 miliardë lekë në gjysmën e parë të vitit 2011 dhe 68.5 miliardë lekë në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Raporti i huave me probleme ndaj totalit të huave u ngjit në nivelin 18.8% nga 17% në gjysmën e parë të vitit 2011 dhe 13.9% në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Totali i provigjoneve ka ndjekur të njëjtën prirje rritëse si huatë me probleme, duke zënë rreth 9.7% të totalit të kredisë. Në harkun kohor prej një viti, rritja e provigjoneve me një ritëm më të ulët (rreth 52.4%) se rritja e huave me probleme (55%), u reflektua me një rënie jomateriale të raportit të mbulimit, në nivelin 51.8%.

Grafik 7.6. Ecuria e aktiveve me rrezik sipas grupeve të bankave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Aftësia e sektorit bankar për të mbuluar me kapital kreditë me probleme ka rënë, pasi "hua me probleme neto ndaj kapitalit rregullator" u ngjit në fund të vitit në nivelin 52% nga 47.4% në gjysmën e parë të vitit 2011 dhe 35.9% në fund të vitit 2010. Rritja e këtij treguesi dëshmon se bankat do të duhet të shtojnë më shumë njësi kapitali për mbulimin e huave me probleme, për të ruajtur në vijimësi treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Grafik 7.7. Ecuria e huave me probleme.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 7.8. Ecuria e provigjoneve (majtas) dhe raportit të mbulimit të huave me probleme (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bankat kanë shfaqur një sjellje më të kujdesshme në klasifikimin e huave sipas klasave. Shpërndarja sipas kategorive vijon të paraqesë një peshë të lartë dhe pse në rënie të huave të klasifikuara në klasën "standard", e cila përbën rreth 72.3% të totalit të huave në muajin dhjetor 2011. Në gjysmën e dytë të vitit 2011, konstatohet një zhvendosje e kredive "standard" dhe

"në ndjekje"[39] drejt kategorisë "hua nënstandard", pesha e së cilës u rrit në 9.2%, nga 7.8% në muajin qershor 2011 dhe 6.1% në muajin dhjetor 2010. Zhvendosja e kredisë në klasat me cilësi më të ulët si "të dyshimta" dhe "të humbura" ka qenë më e ngadaltë.

Sektori bankar paraqitet më i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë për portofolin në valutë dhe atë për bizneset. Huatë me probleme bruto ndaj totalit të huave për të dyja këto kategori u rritën përkatësisht në nivelet 19.6% dhe 20.8%, nga 13.8% dhe 15.5% të llogaritura një vit më parë. Ndërkohë kredia akorduar sektorit publik përfaqëson rreth 3.6% të tepricës së kredisë, nga 2.6% që llogaritej në fund të vitit 2010.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, sektori bankar paraqitet më pak i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë për sektorin e bujqësisë, ku treguesi i cilësisë ka rënë në nivelin 13.6% nga 15.4% në gjashtëmujorin e kaluar dhe 23.4% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kredia me probleme për sektorin e bujqësisë ka rënë me rreth 18.6%, megjithatë përmirësimi i treguesit të cilësisë është rrjedhojë e rritjes më të madhe të tepricës për këtë sektor me rreth 40% referuar një viti më parë. Cilësia e portofolit të kredisë ka shënuar rënie kryesisht për sektorët e ndërtimit dhe të tregtisë, duke u shoqëruar me rritjen e raportit të kredive me probleme, përkatësisht në nivelet 29.6% dhe 21.3%.

Grafik 7.9. Cilësia e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Teprica e kredisë në valutë kur të ardhurat e huamarrësit janë në lekë, rezultoi rreth 214.8 miliardë lekë, duke përbërë 37.9% të tepricës së kredisë në total dhe rreth 55.9% të tepricës së kredisë në valutë. Sipas monedhave, rreth 87% e kësaj kredie është në euro dhe rreth 13.1% është në dollarë amerikanë.

Në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011, raporti "hua me probleme në valutë, ku kredimarrësi është i pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit/teprica e kredisë në valutë, ku kredimarrësi është i pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit" rezultoi rreth 18.9% kundrejt 17.1% në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011 dhe 12.5% në të njëjtën periudhë të një viti më parë.[40] Rritja e këtyre treguesve e ekspozon sektorin bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit për shkak të kursit të këmbimit, pasi luhatjet e pafavorshme të tij, do të preknin aftësinë paguese të kredimarrësve.

[39] *Pesha e huasë e klasifikuar në ndjekje në gjashtëmujorin e dytë të vitit ka rënë me rreth 2.5 pikë përqindje referuar gjysmës së parë të vitit 2011, duke zbritur në nivelin 7.4%, në vlerën 41.7 miliardë lekë.*

[40] *Më konkretisht, sipas monedhave i njëjti tregues në euro, në dhjetor 2011 rezultoi 20.3% nga 17.6% në qershor 2011 dhe 13.3% në dhjetor 2010. Ndërsa në monedhën amerikane (usd) referuar të njëjtës periudhë, rezultoi 9.9% nga 13% në qershor 2011 dhe 6.5% në dhjetor 2010.*

Në fund të vitit 2011, mbulimi me kolateral[41] i portofolit të kredisë me probleme ka shënuar rënie në nivelin 76.4% të portofolit të kredisë, nga 77.6% në gjysmën e parë të vitit 2011 dhe 79.3% që llogaritej një vit më parë.

Grafik 7.10. Kategoritë e kredisë të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

7.3 RREZIKU I LIKUIDITETIT

Në gjysmën e dytë të vitit 2011, diferenca në maturim midis aktiveve dhe detyrimeve është ngushtuar krahasuar me një gjashtëmujor më parë dhe një vit më parë, duke ulur ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të likuiditetit.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011, afati mesatar i mbetur i maturimit të aktiveve të sektorit bankar është 28.7 muaj, nga 30.1 muaj në gjashtëmujorin e kaluar dhe 29.5 muaj një vit më parë. Në të njëjtën periudhë, afati mesatar i mbetur i maturimit të detyrimeve të sektorit bankar shënon 12.3 muaj, nga 11.5 muaj një gjashtëmujor më parë dhe 12.1 muaj në fund të vitit 2010. Diferenca në maturim midis aktiveve dhe detyrimeve është ngushtuar në nivelin 16.4 muaj, nga 18.6 muaj një gjashtëmujor më parë dhe 17.3 muaj një vit më parë (grafik 7.11). Ngushtimi i diferencës midis aktiveve dhe detyrimeve paraqet një ekspozim më të ulët të sektorit bankar ndaj rrezikut të likuiditetit.

Grafik 7.11. Maturimi mesatar i mbetur i aktiveve dhe detyrimeve, në muaj.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në lidhje me vlerësimin e kohëzgjatjes së zërave të veçantë të bilancit, përqendrohemi tek zhvillimet e depozitave dhe kredisë, si produktet të cilat ndikojnë më tepër diferencën (*gap*-in) e maturimit të bilancit.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, rezulton se depozitat kanë një afat maturimi të mbetur prej 5.5 muajsh, nga 4.5 muaj një gjashtëmujor më parë dhe 4.9 muaj në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa, kreditë rezultojnë se kanë një afat maturimi të mbetur prej 42.3 muajsh nga 43.7 muaj një gjashtëmujor më parë dhe 44.5 muaj në të njëjtën periudhë të një viti më parë (grafik 7.11). Rënia 6-mujore e maturimit të mbetur për kreditë me rreth 1.4 muaj, ka ndikuar në ngushtimin e hendekut midis aktiveve dhe detyrimeve.

Situata e likuiditetit në sektorin bankar, në pjesën e dytë të vitit 2011, paraqitet e qëndrueshme dhe në përmirësim. Të dy treguesit kryesorë, "aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra" dhe "aktive likuide ndaj totalit të aktiveve"

[41] *Kolaterali në formën e pasurive të paluajtshme (rezidenciale, tregtare ose tokë), cash etj.*

Grafik 7.12. Maturimi mesatar i mbetur i depozitave dhe kredive, në muaj.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

shfaqen të përmirësuar kundrejt fundit të vitit 2010, duke treguar nivel të kënaqshëm likuiditeti të sektorit bankar.

Në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011, raporti i aktiveve likuide me pasivet afatshkurtra (me maturim deri në një vit) rezultoi 33.15%, kundrejt 30.2% në fund të muajit qershor 2011 dhe 30.6% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sipas monedhave, vlera e raportit paraqitet më e lartë për lekun dhe euron, dhe më e ulët për dollarin. Konkretisht, për lekun rezulton 43.1%, për euron 22.7% dhe për dollarin 18.9%. Raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve ka shënuar rritje (1 pikë përqindje) në nivelin 26.5% kundrejt së njëjtës periudhë të një viti më parë. Sipas madhësisë së aktivitetit, të tre grupet e bankave paraqesin rritje në të dy treguesit, por bankat e grupeve 1 dhe 2 tregojnë ndryshime të qenësishme, sidomos në raportin e aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra. Kështu, kundrejt muajit qershor 2011 bankat e grupeve 1 dhe 2 shënojnë përkatësisht rritje me 3.7 dhe 3.5 pikë përqindje në këtë tregues.

Grafik 7.13. Ecuria e aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

7.4 KAPITALIZIMI I VEPRIMTARISË

Në fund të muajit dhjetor 2011, kapitali rregullator u ngjit në nivelin 98.5 miliardë lekë, duke shënuar rritje me 8.7% dhe 9.2% respektivisht kundrejt muajit qershor 2011 dhe një viti më parë. Kapitali bazë shënoi rritje në nivelin 90.5 miliardë lekë, rreth 6.7 miliardë lekë ose 8% më shumë se vlera e muajit qershor 2011, dhe 5.4 miliardë lekë ose 6.3% më shumë se në

të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kapitali bazë zë 91.9% të kapitalit rregullator duke reflektuar qëndrueshmëri të kapitalit të sektorit bankar dhe cilësi të kënaqshme të tij. Në fund të vitit 2011, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, i cili vlerëson mbulimin me kapital të veprimtarive me rrezik të sektorit bankar, rezultoi në nivelin 15.6%. Ky tregues është rritur me 0.9 pikë përqindje në krahasim me muajin qershor 2011 dhe 0.2 pikë përqindje në krahasim me një vit më parë. Niveli minimal i këtij treguesi i përcaktuar nga kuadri rregullativ është 12%. Në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit 2011, ky tregues shfaq përmirësim të ndjeshëm, kryesisht për shkak të rritjes së kapitalit nga disa banka.

Sipas grupeve të bankave, bankat e Grupit 2 paraqesin nivelin më të ulët të treguesit me 14.1%, gjithsesi në rritje të lehtë në krahasim me gjysmën e parë të vitit 2011. Megjithëse, niveli i kapitalizimit të veprimtarisë së sektorit bankar vlerësohet i mirë, nevojat për rritje kapitali të bankave të veçanta duhet të monitorohen me kujdes të vazhdueshëm, për shkak të paqëndrueshmërisë së cilësisë së aktiveve dhe ritmeve të ngadalta të zgjerimit të veprimtarisë.

Grafik 7.14. Ecuria e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar dhe grupet e bankave, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 9. INDEKSI I RREZIKUT SISTEMIK FINANCIAR PËR SHQIPËRINË.

Kriza e fundit financiare ka diktuar rëndësinë e matjeve efektive të rrezikut sistemik, vlerësimi i të cilit mbetet një faktor kyç në politikat makroprudenciale dhe rregullatore. Për këtë arsye, matja e rrezikut sistemik[i] mund të ndihmojë në identifikimin dhe vlerësimin e kërcënimeve të stabilitetit financiar.

Në këtë hapësirë informuese paraqitet një indeks i ri[ii], i cili ka si qëllim matjen e nivelit të stresit sistemik financiar për ekonominë e vendit tonë. Ky indeks përmban informacion mbi nivelin e stresit të ardhur nga segmente të ndryshme të sistemit financiar, të agreguar në një tregues të vetëm. Treguesit e grupuar në 4 nënindekse përfaqësojnë segmentet më të rëndësishme të sistemit financiar të ekonomisë: sektorin bankar, tregun e parasë, kursin e këmbimit dhe tregun e banesave. Për të identifikuar karakteristikat e nivelit të stresit sistemik për secilin segment janë përdorur luhatshmëritë, devijimet e treguesve ndaj prirjes afatgjatë si dhe diferencat midis normave kryesore të interesit në tregun e parasë. Treguesit e marrë në konsideratë për nënindekset, janë standardizuar dhe më pas logaritmuar në mënyrë që të jenë të krahasueshëm me vlera ndërmjet 0 dhe 1.

Çdo nënindeks llogaritet nëpërmjet analizës së përqasjes së përbërësit kryesor, e cila synon të bashkojë informacionin e ofruar nga variabla të ndryshëm të një tregu në një tregues të vetëm. Më pas, katër nënindekset agregohen nëpërmjet teorisë standarde të portofolit, sipas të cilës rreziku i portofolit total rritet kur aktivet e korreluara që mbartin rrezik bashkohen në një portofol të vetëm, krahasimisht me rastin kur këto aktive nuk janë të korreluara. Pra, korrelacioni i lartë midis aktiveve të ndryshme paraqet rritje të rrezikut sistemik. Së fundi, një element kryesor i ndërtimit të Indeksit të Rrezikut Sistemik Financiar (IRSF) është pesha e nënindekseve e cila reflekton rëndësinë relative të secilit segment në ndikimin e sistemit financiar në aktivitetin ekonomik. Pas përllogaritjes së këtyre peshave për ekonominë tonë ato rezultojnë si në vijim: sektori bankar 26.8%, tregu i parasë 3.1%, tregu i kursit të këmbimit 36% dhe tregu i banesave 34%.

Grafik 7.15. Indeksi i rrezikut sistemik financiar.



Burimi: Llogaritje të Departamentit të Stabilitetit Financiar.

Grafiku 7.14 paraqet zhvillimet e Indeksit të Rrezikut Sistemik Financiar dhe kontributet e secilit nënsegment tregu në nivelin e përgjithshëm të stresit sistemik. Sipas këtij indeksi dallohen dy periudha kryesore me një nivel më të lartë stresi: fillimi i vitit 2002, periudhë e cila përkon me tërheqjen e depozitave, si edhe fundi i vitit 2008, kriza financiare e viteve të fundit. Përsa i përket kontributit të segmenteve të tregut, sektori bankar paraqet kontributin më të lartë në periudha të stresuara për

sistemin financiar. Sidoqoftë, gjatë krizës së fundit, edhe kursi i këmbimit, nëpërmjet nënçmimit të monedhës vendase veçanërisht ndaj monedhës evropiane, si edhe ecuria në tregun e banesave kanë ushtruar presion në nivelin e stresit. Kontribut më të moderuar japin luhatjet në tregun e parasë për shkak të zhvillimit të kufizuar të tij, i cili reflektohet në peshën e tij në indeks.

Përfshirja në këtë indeks e tregut të banesave, edhe pse jo pjesë e sistemit financiar, synon vlerësimin e ekspozimit të drejtpërdrejtë që ka ky treg për tregjet e tjera në sistem. Sidoqoftë, në rast të mospërfshirjes së tij, vlera e peshave të nënindekseve të tjera në indeksin e stresit është: 38.2% për sektorin bankar, 14.5% për tregun e parasë dhe 47.3% për atë të kursit të këmbimit. Sipas kësaj përqasjeje, evidentohet një ndikim më i lartë i zhvillimeve në tregun valutor ndaj rrezikut sistemik dhe aktivitetit ekonomik.

Grafik 7.16. Indeksi i Rrezikut Sistemik Financiar pa përfshirjen e nënindeksit të tregut të banesave.



Burimi: Llogaritje të Departamentit të Stabilitetit Financiar.

Gjithsesi, të dyja përqasjet sugjerojnë se pas nivelit më të lartë të rrezikut sistemik të shënuar në mars 2009, ekspozimi ndaj tij është ulur gradualisht deri në muajin gusht 2010. Duke filluar nga kjo periudhë dhe përgjatë vitit 2011, rreziku sistemik ka shënuar rritje për shkak të nënçmimit të vazhdueshëm të monedhës vendase dhe përkeqësimit të bilancit të sektorit bankar.

[i] *Rrezik sistemik është quajtur materializimi i goditjeve kur mungesa e stabilitetit financiar merr përmasa të tilla të cilat dëmtojnë funksionimin e sistemit financiar deri në masën që mirëqenia dhe rritja ekonomike preken në mënyrë materiale (Hollo et al, 2011).*

[ii] *Një prezantim i detajuar i ndërtimit të Indeksit të Rrezikut Sistemik paraqitet në materialin "Një Indeks për rrezikun sistemik financiar në Shqipëri", Vasilika Kota dhe Arisa Saqe, Departamenti i Stabilitetit Financiar, Banka e Shqipërisë, prezantuar në Workshop-in e pestë të Kërkimeve në Evropën Juglindore, Tiranë, 10-11 nëntor 2011.*

7.5 PROVA E REZISTENCËS

Nëpërmjet analizës së provës së rezistencës "*stress*-test" me vështrim nga e ardhmja vlerësohet stabiliteti i sistemit financiar dhe mjaftueshmëria e kapitalit për sektorin bankar për një hark kohor deri në fund të vitit 2013. Ushtrimi i provës së rezistencës vlerëson ndikimin e situatave makroekonomike në gjendjen financiare të sektorit bankar, duke përjashtuar mundësinë e rritjes së kapitalit të paguar gjatë periudhës së marrë në konsideratë. Në praktikë,

situata zakonisht përkeqësohet gradualisht dhe bankat kanë kohë të marrin masat e nevojshme, duke injektuar kapital.

Ky ushtrim përmban tre skenarë: Skenari bazë ndërtohet mbi parashikimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë mbështetur kryesisht në ecurinë e tyre historike, ndërsa dy skenarët e rënduar supozojnë një situatë "të stresuar" me një probabilitet të ulët ndodhjeje, duke u mbështetur në dy goditje të mundshme në ekonominë shqiptare: a) ngadalësim i mëtejshëm i kreditimit; c) nënçmim i monedhës vendase.

Tabelë 7.1. Supozimet për ndërtimin e provës së rezistencës.

	Skenari bazë		Skenari i kursit të këmbimit		Skenari i kredisë	
Vlera në terma mesatarë	2012	2013	2012	2013	2012	2013
Rritja vjetore e PBB-së, në %	2.62	3.0	2.57	2.38	1.33	0.86
Rritja vjetore e normave të interesit të tregut	0.2 pp	0.25 pp	0.35 pp	0.5 pp	0.35 pp	0.5 pp
Nënçmimi i lekut kundrejt dy monedhave kryesore (EUR dhe USD), në %	-1.6	-1.5	5.1	10.07	-1.6	-1.5
Rritja e parashikuar për tepricën e kredisë, në %	14	12.5	14	12.5	9	5

Burimi: Vlerësime të Departamentit të Kërkimeve, Banka e Shqipërisë.

Grafik 7.17. Shpërndarja e dendurive të vlerave të raportit të kredive me probleme për tremujorin e fundit të vitit 2012 dhe vitit 2013 të simuluara me metodën Monte Carlo sipas skenarit bazë dhe skenarëve të rënduar.



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar

Vlerësimet për treguesin e cilësisë së portofolit të kredisë deri në fund të vitit 2013 sipas skenarit bazë dhe skenarëve të goditjes pasqyrohen në grafikun 7.17. Shpërndarja e vlerave të cilësisë së portofolit paraqitet më e gjerë për skenarin e kredisë duke evidentuar ndikimin e fortë të një ecurie të ngadaltë të kreditimit në terma të cilësisë së portofolit, dhe më pas edhe në nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Në tabelën në vijim, është pasqyruar ndjeshmëria e sektorit bankar ndaj goditjeve në cilësinë e kredisë, e vlerësuar në terma të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të nevojës për kapital shtesë për fundin e vitit 2012 dhe 2013.

Tabelë 7.2. Rezultatet e stress-test-it në terma të kapitalizimit të sektorit bankar për vitin 2012.

Rezultatet për fundin e vitit 2012						
	Skenari bazë		Skenari i kursit të këmbimit		Skenari i kredisë	
	Banka	Sektori	Banka	Sektori	Banka	Sektori
Kapitali rregullator/Totali i aktiveve me rrezik		I kapitalizuar		I kapitalizuar		I kapitalizuar
Nënkapitalizim modest /1	Po		Po		Po	
Nënkapitalizim i rëndë /2	Jo		Po		Po	
Kapitali bazë/Totali i aktiveve me rrezik		I kapitalizuar		I kapitalizuar		I kapitalizuar
Nënkapitalizim modest /3	Po		Po		Po	
Nënkapitalizim i rëndë /4	Po		Po		Po	

/1 = Nën raportin prej 12%;
/2 = Nën raportin prej 6%;
/3 = Nën raportin prej 6%;
/4 = Nën raportin prej 3%.
Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Tabelë 7.3. Rezultatet e stress-test-it në terma të kapitalizimit të sektorit bankar për vitin 2013.

Rezultatet për fundin e vitit 2013						
	Skenari bazë		Skenari i kursit të këmbimit		Skenari i kredisë	
	Banka	Sektori	Banka	Sektori	Banka	Sektori
Kapitali rregullator/Totali i aktiveve me rrezik		I kapitalizuar				I kapitalizuar
Nënkapitalizim modest /1	Po		Po		Po	
Nënkapitalizim i rëndë /2	Jo		Po		Po	
Kapitali bazë/Totali i aktiveve me rrezik		I kapitalizuar				I nënkapitalizuar
Nënkapitalizim modest /3	Po		Po		Jo	
Nënkapitalizim i rëndë /4	Jo		Po		Jo	

/1 = Nën raportin prej 12%;
/2 = Nën raportin prej 6%;
/3 = Nën raportin prej 6%;
/4 = Nën raportin prej 3%.
Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Rezultatet e ushtrimit tregojnë që në tërësi, sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm në rast të realizimit të supozimeve për treguesit përkatës. Niveli i kapitalizimit për të gjithë sektorin mbetet mbi nivelin minimal të kërkuar në rastin e skenarit bazë. Në rastin e skenarit më të rënduar që përfshin supozimin e ngadalësimit të kreditimit dhe uljen e normës së rritjes të PBB-së, sektori bankar mund të ketë nevojë për kapital shtesë. Banka të veçanta, paraqesin nevoja për kapital shtesë në skenarët e rënduar dhe në skenarin bazë. Në përgjithësi, veprimtaria bankare zhvillohet në një mjedis ekonomik të brendshëm dhe të jashtëm sfidues, ndaj bankat duhet të ndjekin me kujdes ecurinë e veprimtarisë së tyre për të identifikuar në kohë dhe për të përmbushur nevojat për kapital.

ANEKS

SHTOJCË 1. INDEKSI I FORTËSISË FINANCIARE[42]

Ecuria e sektorit bankar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, e vlerësuar nëpërmjet zhvillimeve në Indeksin e Fortësisë Financiare paraqitet në përmirësim krahasuar me një gjashtëmujor më parë, por në ngadalësim referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Këto zhvillime kanë ardhur si rezultat i efektit të kombinuar të ecurisë së nënindekseve përbërëse të indeksit të fortësisë financiare.

Vlerësimi i nënindekseve, që formojnë Indeksin e Fortësisë Financiare (IFF), për sistemin në fund të gjashtëmujorit të dytë 2011, jepet si më poshtë:

Nënindeksi i cilësisë së aktiveve[43]. *Ecuria në rënie e tij sinjalizon ndikim negativ mbi gjendjen e sektorit bankar dhe anasjelltas. Nënindeksi i cilësisë së aktiveve ka shënuar vazhdimisht tendencë rënëse sipas vlerave historike të tij.* Në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011, vlera e nënindeksit ra në 66.2 nga 68.6 që llogaritej një gjashtëmujor më parë dhe 74.2 në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vlerat e nënindeksit të cilësisë së aktiveve janë luhatur ndjeshëm dhe nga mesatarja e periudhës e llogaritur në nivelin 85.7. Raportet bazë që shfrytëzohen për ndërtimin e këtij nënindeksi në një hark kohor prej 6 vjetësh kanë shfaqur vetëm rritje, gjë e cila tregon cilësinë në rënie të aktiveve të sektorit bankar.

Nënindeksi i rrezikut të likuiditetit. Ecuria në rënie e tij sinjalizon ndikim negativ mbi gjendjen e sektorit bankar dhe anasjelltas. Nënindeksi i likuiditetit ka shënuar vlerën më të lartë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, 89.5 nga 67.2 një gjashtëmujor më parë dhe 79.8 referuar një viti më parë. Përmirësimi i treguesit ka ardhur si rezultat i rritjes së raportit "aktive me maturim deri në 3 muaj/pasive me maturim deri në 3 muaj" i cili në një vit u rrit me rreth 7.7 pikë përqindje.

Nënindeksi i rrezikut të kursit të këmbimit[44]. Ecuria në rënie e tij sinjalizon ndikim negativ në gjendjen e sektorit bankar. Sektori bankar gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011 paraqitet më pak i ekspozuar ndaj rrezikut të luhatjeve në kursin e këmbimit. Kjo konkretizohet nga vlera prej 123.6 krahasuar me 116 një gjashtëmujor më parë dhe 111.1 e llogaritur për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Përmirësimi i treguesit të rrezikut ndaj kursit të këmbimit u

[42] *Metodologjia e ndërtimit të Indeksit të Fortësisë Financiare është prezantuar në Raportin e Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2010.*

[43] *Për llogaritjen e këtij nënindeksi është përdorur përpjesëtimi indirekt.*

[44] *Janë përdorur përpjesëtime indirekte në llogaritjen e këtij nënindeksi, duke qenë se shenja (drejtimi i efektit) e përcaktuar në tabelë është negative.*

shkaktua kryesisht nga rënia e raportit "pozicione të hapura valutore (zërat e bilancit) ndaj kapitalit rregullator"[45].

Nënindeksi i përfitueshmërisë. Ecuria në rritje e tij sinjalizon ndikim pozitiv mbi gjendjen e sektorit bankar dhe anasjelltas. Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, nënindeksi i përfitueshmërisë ka shënuar vlerën më të ulët historike që prej dhjetorit 2005, në nivelin 71.6 nga 75.1 që llogaritej një gjashtëmujor më parë dhe 85 në fund të vitit 2010. Rënia e nënindeksit është shkaktuar nga një rënie e njëkohshme e të dy raporteve përbërës të tij, duke ndikuar negativisht mbi gjendjen e sektorit bankar.

Nënindeksi i mjaftueshmërisë së kapitalit. Ecuria në rënie e tij sinjalizon ndikim negativ në gjendjen e sektorit bankar dhe anasjelltas. Ky nënindeks përbëhet në pesha të barabarta nga raporti i kapitalit të lirë me totalin e aktiveve dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit. Në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011, nënindeksi i mjaftueshmërisë së kapitalit i është rikthyer ritmeve rritëse krahasuar me një gjashtëmujor më parë duke u ngjitur në nivelin 63.8, nga 62, megjithatë ai vijon të mbetet shumë poshtë vlerës së mesatares historike prej 86.5.

Nënindeksi i rrezikut të normës së interesit[46]. Ecuria në rënie e këtij nënindeksi sinjalizon ndikim negativ në gjendjen e sektorit bankar. Ecuria e nënindeksit të rrezikut të normës së interesit, paraqet rritje të ekspozimit të sektorit bankar ndaj luhatjeve të normave të interesit në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011 krahasuar me një gjashtëmujor më parë njëkohësisht dhe me një vit më parë. Ky ekspozim ka ardhur si rezultat i vlerave në rritje kryesisht të raportit "diferenca aktive/pasive të ndjeshme ndaj normave të interesit deri në një muaj (në monedhë të huaj)/Kapitalit aksioner" i cili në dhjetor 2011 rezultoi rreth 71 %, nga 57 % referuar një viti më parë.

Indeksi i Fortësisë Financiare (IFF) llogaritet si mesatarja aritmetike e të gjithë nënindekseve të sipëranalizuar. Efekti i kombinuar i tyre, ka sjellë që në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011, indeksi i fortësisë financiare të sektorit bankar të rritet në nivelin 84.7 nga rreth 82.1 që u llogarit një gjashtëmujor më parë, megjithatë poshtë nivelit të një viti më parë prej 87.6.

Rritja prej rreth 3.2 njësi e indeksit të fortësisë u shkaktua nga rritja e likuiditetit, mjaftueshmërisë së kapitalit dhe një ekspozimi më të ulët ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, ndërkohë që kontributi negativ në sektorin bankar i shkon cilësisë më të ulët të aktiveve, nivelit më të ulët të përfitueshmërisë dhe një ekspozimi më të lartë ndaj luhatjeve të normave të interesit.

Në vijim, paraqitet ecuria grafike e Indeksit të Fortësisë Financiare dhe e nënindekseve të tij për sektorin bankar.

---

[45] *Në dhjetor 2011, ky raport rezultoi 3.7%, nga 5.7% në qershor 2011 dhe 5.9% në dhjetor 2010.*

[46] *Rreziku i normës së interesit vlerësohet nëpërmjet mospërputhjes kohore të aktiveve dhe detyrimeve, e cila ekspozon sistemin bankar ndaj luhatjeve të normave të interesit. Është përdorur përpjesëtimi indirekt edhe për llogaritjen e këtij indeksi.*

Grafik 8.1. Ecuria e Indeksit të Fortësisë Financiare (IFF).



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të Departamentit të Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.2. Ecuria e nënindekseve të fortësisë financiare.



Burimi:Banka e Shqipërisë, llogaritje DSF.

Grafik 8.3. Harta e fortësisë financiare të sektorit bankar.



Burimi:Banka e Shqipërisë, llogaritje DSF.

SHTOJCË 2. TREGUESIT E SHËNDETIT FINANCIAR PËR SEKTORIN BANKAR

Tabelë 8.1. Treguesit e shëndetit financiar për sektorin bankar.

(%)	Dhjetor '08	Dhjetor'09	Dhjetor '10	Qershor '11	Dhjetor '11
TREGUESIT ME BAZË KAPITALIN					
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me risk	17.2	16.2	15.4	14.6	15.6
Kapitali bazë ndaj aktiveve të peshuara me risk	16.3	15.3	14.5	13.5	14.3
Kapitali bazë ndaj totalit të aktiveve	7.8	8.7	8.6	8.0	8.1
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve	8.3	9.2	9.1	8.7	8.8
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	8.6	9.6	9.4	8.6	8.7
HUATË ME PROBLEME NETO NDAJ KAPITALIT					
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit bazë	23.0	29.9	38.1	51.3	56.6
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	21.7	28.2	35.9	47.4	52.0
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit aksioner	21.1	27.1	34.8	47.6	52.6
HUATË ME PROBLEME BRUTO NDAJ TOTALIT TË HUAVE	6.64	10.48	13.96	17.00	18.77
KTHIMI NGA KAPITALI, ROE (bazë vjetore)	11.4	4.6	7.6	2.4	0.8
KTHIMI NGA AKTIVET, ROA (bazë vjetore)	0.9	0.4	0.7	0.2	0.1
TREGUES TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE					
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	106.5	119.6	118.9	146.6	147.7
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	81.4	231.4	227.5	289.7	353.2
LIKUIDITETI					
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	42.8	27.6	25.9	25.5	26.5
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	64.9	32.6	30.6	30.2	33.1
Raporti "depozita/kredi"	162.6	154.3	166.4	163.7	163.2
POZICIONI I HAPUR NETO NË VALUTË NDAJ KAPITALIT					
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit bazë	4.5	4.1	5.3	4.0	4.3
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit rregullator	4.3	3.9	5.0	3.7	3.9
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit aksioner	4.0	4.3	5.4	4.1	4.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 8.2. Treguesit e shëndetit financiar sipas grupeve bankare.

	Dhjetor'08			Dhjetor'09			Dhjetor'10			Qershor'11			Dhjetor'11		
(%)	G1	G2	G3	G1	G2	G3	G1	G2	G3	G1	G2	G3	G1	G2	G3
TREGUESIT ME BAZË KAPITALIN															
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me risk	30.8	15.3	16.6	32.7	13.6	16.1	23.4	13.8	15.6	30.0	13.5	14.3	28.0	14.1	15.5
Kapitali bazë ndaj aktiveve të peshuara me risk	29.1	12.5	16.5	32.7	10.9	15.9	23.4	11.6	15.5	30.0	10.7	13.8	28.0	11.1	14.8
Kapitali bazë ndaj totalit të aktiveve	20.3	8.1	7.0	19.1	8.0	8.2	13.9	8.1	8.4	18.7	7.6	7.7	17.0	7.5	7.8
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve	21.5	10.0	7.1	19.1	10.0	8.3	13.9	9.6	8.5	18.7	9.6	7.9	17.0	9.5	8.2
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	21.3	7.7	8.2	20.0	8.4	9.3	14.8	8.6	9.3	19.8	8.2	8.3	17.9	7.9	8.5
HUATË ME PROBLEME NETO NDAJ KAPITALIT															
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit bazë	3.62	33.07	23.42	4.9	51.9	27.0	15.1	46.9	37.2	14.4	61.1	52.4	15.8	81.5	53.4
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	3.42	26.91	23.24	4.9	41.5	26.7	15.1	39.5	36.8	14.4	48.7	50.6	15.8	64.1	51.2
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit aksioner	3.45	32.07	20.31	4.7	49.3	23.8	14.2	44.5	33.3	13.6	56.8	48.5	14.9	77.3	49.3
HUATË ME PROBLEME BRUTO NDAJ TOTALIT TË HUAVE	3.50	7.67	6.37	4.9	13.1	9.6	9.7	13.6	14.6	11.2	17.4	17.1	11.8	22.5	17.6
KTHIMI NGA KAPITALI, ROE (bazë vjetore)	(4.48)	(4.83)	18.52	(6.54)	(22.48)	14.07	(8.78)	(8.29)	17.00	0.59	(21)	10.24	(3.03)	(27.75)	10.29
KTHIMI NGA AKTIVET, ROA (bazë vjetore)	(1.02)	(0.37)	1.39	(1.36)	(1.85)	1.22	(1.53)	(0.73)	1.55	0.05	(0.90)	0.45	(0.55)	(2.33)	0.89
TREGUES TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE															
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	79	121	105	90	210	108	103	152	111	74	300	132	88	386	127
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	145	122	67	168	256	232	178	831	62	121	1,997	85	146	2,938	111
LIKUIDITETI															
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	40.1	31.1	46.6	29.7	18.4	30.4	27.5	23.2	27.1	25.9	24.1	26.0	28.7	26.6	26.4
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	63.6	49.5	69.3	38.6	23.2	34.9	34.3	29.1	31.0	36.5	30.9	29.8	40.2	34.3	32.5
Raporti "depozita/kredi"	149.5	100.77	190.32	147	103.72	178.63	157.3	120	200.71	136.1	116.6	187.96	137.63	124.85	180.82
POZICIONI I HAPUR NETO NË VALUTË NDAJ KAPITALIT															
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit bazë	2.4	12.8	2.6	(1.32)	7.97	3.77	-1.8	0.1	8.5	(5.91)	(2.02)	8.74	(4.32)	(2.61)	8.84
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit rregullator	2.3	10.4	2.6	(1.32)	6.38	3.73	-1.8	0.1	8.5	(5.91)	(1.61)	8.45	(4.32)	(2.05)	8.48
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit aksioner	2.3	11.8	2.2	(1.26)	9.89	3.80	-1.7	0.1	7.7	(5.57)	(2.91)	8.10	(4.09)	(3.77)	8.16

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 8.3. Treguesit e shëndetit financiar të bankave sipas origjinës.

	Dhjetor'08				Dhjetor'09				Dhjetor'10				Qershor'11				Dhjetor'11			
(%)	Ital.	Fr.	Gr.	Al.	Ital.	Fr.	Gr.	Al	Ital.	Fr.	Gr.	Al	Ital.	Fr.	Gr.	Al	Ital.	Fr.	Gr.	Al
TREGUESIT ME BAZË KAPITALIN																				
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me risk	16.9	15.5	16.5	14.7	18.8	14.2	14.1	14.2	17.6	13.2	14.8	13.6	18.7	13.3	13.3	12.7	20.2	12.5	16.6	13.9
Kapitali bazë ndaj aktiveve të peshuara me risk	16.3	13.2	16.5	10.4	17.9	11.3	14.1	11.2	16.9	12.8	12.0	11.1	18.0	11.3	11.5	10.4	19.4	10.7	14.3	11.0
Kapitali bazë ndaj totalit të aktiveve	7.9	8.3	10.8	7.5	8.5	8.6	11.2	7.8	9.4	8.4	10.2	6.8	10.2	8.3	9.0	6.7	9.8	7.6	10.0	7.6
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve	8.2	9.7	10.8	10.6	9.0	10.8	11.2	9.9	9.8	10.3	10.5	8.4	10.6	9.8	10.4	8.2	10.2	8.9	11.6	9.7
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	9.3	9.1	9.1	8.3	10.5	9.5	11.6	8.1	10.3	9.3	10.9	7.3	11.1	9.6	8.8	7.1	10.4	8.4	9.9	8.2
HUATË ME PROBLEME NETO NDAJ KAPITALIT																				
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit bazë	12.5	47.6	10.5	16.4	25.0	70.0	22.8	42.4	47.1	50.7	35.5	41.0	53.6	44.0	96.8	32.1	50.2	60.4	115.2	40.4
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	12.1	40.7	10.5	11.6	23.8	55.4	22.8	33.4	45.1	41.2	34.3	33.5	51.6	37.1	84.1	26.5	48.3	51.9	99.0	31.9
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit aksioner	10.7	43.3	17.3	14.8	20.3	63.4	21.9	40.6	42.6	45.9	33.0	38.2	49.3	38.0	98.7	30.4	47.6	55.1	116.0	37.7
HUATË ME PROBLEME BRUTO NDAJ TOTALIT TË HUAVE	4.3	12.7	4.5	3.1	8.8	18.6	8.1	8.1	17.8	18.2	12.1	9.1	21.1	17.3	23.5	8.1	22.7	18.4	33.3	9.6
KTHIMI NGA KAPITALI, ROE (bazë vjetore)	11.8	(18.9)	8.2	19.1	15.7	(30.8)	(5.7)	4.5	5.1	(3.2)	(3.8)	5.2	11.9	(7.6)	(38.2)	15.9	2.3	(14.2)	(38.5)	18.7
KTHIMI NGA AKTIVET, ROA (bazë vjetore)	1.0	(1.7)	0.7	1.4	1.5	(2.8)	(0.6)	0.4	0.5	(0.3)	(0.4)	0.4	0.6	(0.4)	(1.9)	0.6	0.2	(1.3)	(3.7)	1.4
TREGUES TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE																				
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	83.9	206.3	116.7	0.9	73.3	381.8	171.7	110.8	100.9	127.5	161.2	116.0	87.2	202.9	(197.8)	107.5	126.2	167.8	(222.3)	106.0
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	95.7	205.9	94.1	0.7	74.8	537.3	1,125	91.0	97.1	321.3	988.2	89.6	77.2	569.2	(1,423.0)	68.7	117.3	553.8	(1,892.6)	64.0
LIKUIDITETI																				
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	47.6	34.0	24.9	29.9	34.0	26.7	18.6	21.7	29.8	30.5	22.2	23.0	31.2	26.8	24.6	20.2	31.1	25.5	26.6	20.9
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	72.3	68.4	33.0	48.6	40.1	37.6	22.4	25.7	35.7	44.3	26.1	26.8	38.1	39.4	29.4	23.7	40.0	39.1	33.6	26.1
Raporti "depozita/kredi"	197	107	91	140	190	94	91	134	202	114	107	149	189	105	114	136	187	110	125	124
POZICIONI I HAPUR NETO NË VALUTË NDAJ KAPITALIT																				
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit bazë	-2.1	21.1	-2.9	1.5	0.6	15.6	-1.7	6.8	-3.2	-1.1	-0.5	14.9	-3.3	-1.5	-2.4	7.2	-2.2	-3.6	-0.4	5.1
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit rregullator	-2.1	18.0	-2.9	1.1	0.6	12.4	-1.7	5.3	-3.1	-0.9	-0.4	12.1	-3.2	-1.3	-2.1	5.9	-2.1	-3.1	-0.4	4.0
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit aksioner	-1.8	19.1	-2.6	1.4	0.5	14.2	-3.3	6.5	-2.9	-1.0	-0.8	13.8	-3.1	-1.3	-4.1	6.8	-2.1	-3.3	-0.7	4.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.